



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA			
18.02.2021			
Numri i Prokurimit	Numri i Prokurimit	Numri i Prokurimit	Numri i Prokurimit
01-060/01-76			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -I-, të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **26.02.2021, (e Premte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit, në Shtëpinë e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e KK-së.
2. Informatë (Raport) e zyrës së kryetarit të Komunës së Vitisë janë-dhjetor 2020.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Viti
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik (parkingjet publike).
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim (parkingjet publike).

Viti, më 18.02.2021

Kryesuesi i Kuvendit
Naim Pira





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA			
Nr. Organi		19-02-2021	
Org. Shtet	Org. Qytet	Org. Qytet	Vlera
02-052/01-78		Madnos	



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

***Informatë (Raport) e Punës së Kryetarit të Komunës për Periudhën
Janar – Dhjetor 2020***

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I

- Hyrje	3
---------------	---

KAPITULLI II

Raportet e Zyrave të Kryetarit

- Njësia e Auditimit të Brendshëm	5
- Njësia e Personelit.....	5
- Zyra për Barazi Gjinore	7
- Zyra e Prokurimit	8
- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun	9
- Lektori	10
- Zyra e Avokatit Publik të Komunës	11
- Zyra për Integritet Evropian.....	11
- Zyra për Riatdhesim	11
- Zyra për Projekte	12

KAPITULLI III

Raportet e Drejtorive

- Drejtoria e Administratës	13
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	17
- Drejtoria e Inspeksionit	21
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	26
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	32
- Drejtoria për Arsimit	41
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	53
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	55
- Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi	61
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	64

KAPITULLI I

Hyrje

I nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës!

Të nderuar Këshilltarë!

Kam kënaqësinë që me ju sot të ndajë punën tonë gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2020. Me respektin më të madh për ju, sot do t'i prezantoj të arriturat e komunës për periudhën njëvjeçare, sfidat me të cilat jemi përballë me gjendjen pandemike Covid 19, e cila e përfshiu tërë globin. Po ashtu, më lejoni që me sinjeritetin më të madh institucional dhe qytetar t'iu falënderoj për mbështetjen tuaj gjatë punës tonë të përbashkët gjatë tërë kohës.

Një qeverisje e suksesshme është e pamundur pa bashkëpunimin e ngushtë me ju të nderuar këshilltarë si dhe me qytetarët e komunës sonë, për të cilët jemi këtu. Qeverisja jonë përbën thelbin e një qeverisje të mirë, demokratike, transparente dhe llogaridhënëse. Më gëzon fakti se, çdo vendim dhe punë e jona deri më tani ka marrë legjitimitetin dhe konfirmimin nga qytetarët. Unë sinjerisht, falënderoj secilin nga ju dhe çdo qytetarë të komunës sonë për mbështetjen dhe bashkëpunimin e ofruar. Mbetemi të angazhuar që ky bashkëpunim të rritet edhe më tepër, në mënyrë që puna jonë të jetë direkt e lidhur me interesat e qytetarëve dhe çdo banorë i komunës sonë të përfitoj nga puna dhe angazhimi jonë.

Puna jonë gjatë kësaj periudhe do të ishte e mangët pa kontributin e donatorëve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare, si përmes investimeve në projekte të ndryshme, ashtu edhe përmes ngritjes së kapaciteteve tona.

Të nderuar këshilltarë!

Viti 2020 na sfidoi me përhapjen e virusit Sars Cov 2, gjendje kjo që Organizata Botërore e Shëndetësisë e shpalli si Pandemi globale Covid 19, pasi që ky virus e përfshiu tërë globin, duke mos e përjashtuar edhe vendin tonë.

Rasti i parë me Sars Cov 2, pikërisht u paraqitë në Komunën tonë me datë 13 Mars 2020, ku edhe prej këtij rasti virusi filloi të përhapet me shpejtësi mjaftë të madhe. Pas rasteve të paraqitura, me vendim të Ministrisë së Shëndetësisë, Vitia ishte zonë e karantinuar, ku nga kjo situatë puna jonë në Administratën Komunale ishte mjaftë voluminoze, pasi që menjëherë formuan Komitetin Emergjent për Mbrojtje dhe Shpëtim, i cili përbëhej nga të gjithë akterët relavant të institucioneve komunale. Detyrë parësore e këtij komiteti ishte shqyrtimi i gjendjes së përditshme, dhe ndërmarrja e masave për parandalimin e përhapjes së virusit në Komunën tonë, ndihma e qytetarëve në nevojë, pasi që me mbylljen e bizneseve gjatë kohës së karantinimit, shumë qytetarë humbën vendet e tyre të punës dhe gjendja ekonomike e familjeve u përkeqësua dukshëm. Për t'ju dalë në ndihmë atyre, falënderojmë edhe donatorët e ndryshëm që ndihmuan me pako ushqimore e gjësende tjera higjienike, si: dezinfektues, maska, etj. Gjithashtu ju falënderojmë edhe

juve këshilltarë të nderuar, që shprehët vullnetin për ndarjen e mjeteve financiare për t'ju dalë në ndihmë familjeve në nevojë.

Falënderojmë edhe personelin shëndetësor, i cili ishte në gjendje gatishmërie që në çdo kohë t'ju dilte në ndihmë personave që ishin të prekur nga ky virus.

Të nderuar Këshilltarë dhe ju të pranishëm!

Edhe pse ishte një gjendje mjaftë e vështirësuar për kryerjen e aktiviteteve që janë në fushëveprimtarinë e Komunës, ne nuk u ndalëm asnjëherë që të kryejmë aktivitetet që i kishim të planifikuara për vitin 2020, thuaja se në të gjitha fushat.

Në vazhdim të raportit nga drejtoratet respektive, sektorëve dhe zyrave të kryetarit, mund të lexohen edhe shumë aktivitete të zhvilluara përgjatë periudhës raportuese. Unë jam i kënaqur me angazhimin dhe performancën e ekzekutivit, stafit dhe menaxherëve, ndonëse jam i përkushtuar për të vazhduar me dinamikë edhe më të përshpejtuar për të qeverisur ligjshëm e ndershëm dhe për të shndërruar administratën komunale në funksion dhe shërbim të qytetarëve.

P.S Raportin për virusin Sars Co 2, me statistikat e bashkangjitura i keni te Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale

KAPITULLI II

Raportet e Zyrave të Kryetarit

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB)

Në kuadër të këtij raporti të punës, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) për punën e vet është bazuar kryesisht në Planin Vjetor të Punës për vitin 2020, i cili plan ka qenë i aprovuar nga kryetari i Komunës së Vitisë dhe nga Komiteti për Auditim të Brendshëm (KAB). Në të njëjtën kohë një kopje të miratuar e kemi dërguar drejtorit të NJQHAB të Ministrisë së Financave në Prishtinë. Ndërsa, bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr.06/L-21 për KBFP, Udhëzimet administrative për auditim të brendshëm, Doracakun e auditimit të brendshëm, Statutin e auditimit të brendshëm, Instruksionet lidhur me Standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Sipas Planit vjetor të NJAB-së, për vitin 2020 kanë qenë të planifikuara të kryhen gjithsejtë 5 auditime. Pikësynimi kryesor i auditimeve ka qenë kryesisht vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm të ushtruar nga ana e drejtorëve të drejtorive komunale, lidhur me minimizimin e rreziqeve që kanë pasur të bëjnë me realizimin e objektivave të drejtorive gjegjëse, si dhe respektimin e kërkesave ligjore për të arritur një siguri të arsyeshme mbi respektimin e bazueshmërisë ligjore gjatë procesit të të hyrave, shpenzimeve, si dhe proceseve të tjera.

Për periudhën janar – dhjetor 2020, NJAB-i ka arritur t'i kryej 5 auditime, pra aq sa ishin të planifikuara edhe me planin vjetor 2020.

1. Auditimi Nr. DSHS- 20/01

Titulli i auditimit : Zbatimi i Procedurave të Prokurimit Publik në Komunën e Vitisë për periudhën 30.09/2018 deri 31.12/2019

2. Auditimi Nr. DSHS-20/02

Tema e Auditimit: Të hyrat nga Tatimi mbi pronën e paluajtshme , për vitin 2019

3. Auditimi Nr. DSHS-20/03

Tema e Auditimit: Procedurat e Menaxhimit të Pasurive Jo Financiare për periudhën 30.06/2019 deri 30.06/2020

4. Auditimi Nr. DSHS-20/04

Tema e Auditimit: Procedurat e të hyrave në Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi për periudhën kohore 03.01.2020 deri me 30.09/2020

Auditimi Nr. DSHS-20/05

5. **Emri i Auditimit:** Procedurat e Shpenzimeve për Mallëra e Shërbime , Komunalit dhe Subvencione për periudhën e vitit 2019 dhe TM-2/2020.

NJAB-i për secilin auditim të brendshëm ka dhënë të gjeturat kryesore, konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat janë në proces të implementimit nga ana e menaxhmentit. Prandaj edhe presim që implementimi i tyre të jetë i kënaqshëm, me qëllim të arritjes së objektivave të menaxhmentit të lartë të komunës për këtë vit kalendarik.

Njësia e Personelit

Gjate periudhës kohore janar –dhjetor 2020, Njësia e Personelit ka kryer punët në bazë të kompetencave dhe autorizimeve të cilat dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Shërbimin Civil, Ligjin mbi Pagat, Ligjin mbi Administratën Shtetërore, Ligjin e Punës si dhe aktet tjera nënligjore. Statuti i Komunës dhe vendimi mbi organizimin e organeve komunale dhe aktet tjera nënligjore të cilat rregullojnë fushën e marrëdhënies së punës.

Njësia e Personelit udhëheqësi i saj ka bërë përpjekje të vazhdueshme që në Administratën komunale të vihet në rend Ligji dhe respektimi i tij nga ana e shërbyesve civil (punëtorët e administratës komunale).

Njësia e Personelit vazhdimisht ka insistuar që të vihet rendi në administratën komunale, duke inicuar trajnime për shërbyesit civil, me qëllim të profesionalizimit të tyre dhe të rritjes së njohurive të tyre për punën dhe disiplinën në punë, me qëllim që në administratën komunale të ketë më pak shqiptim të masave disiplinore si dhe akuza të ngritura për vepra penale, shpërdorim i detyrës zyrtare. Njësia e Personelit konform akteve të përmendura më lartë, s'pari ka bërë përshkrimin e detyrave të punës për të gjithë shërbyesit civil, konform Rregullores 05/2012, rregullore kjo e cila parasheh sistematizimin, gradimin e të gjithë shërbyesve civil në administratën komunale.

Njësia e Personelit, në bazë të Planit të punës për vitin 2020 të aprovuar nga Ministria e Administratës Publike vazhdimisht i përmbahet ashtu siç është edhe i aprovuar, por nëse kemi ndryshime në plan, jemi të obliguar që të marrim aprovimin për ndryshime nëse ka nevojë.

Njësia e Personelit, përkundër të gjitha kërkesave që janë kërkuar nga ministrinë e ndryshme dhe agjensione, gjithmonë me kohë iu janë dërguar edhe raportet për të cilat janë kërkuar nga agjencionet e ndryshme rreth shërbyesve civil dhe politik.

Njësia e Personelit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020 ka bërë skenimin e dosjeve personale të shërbyesve civil, të cilët shërbyes civil kanë ndjekur trajnime të ndryshme e të cilët janë pajisur me certifikata.

Njësia e Personelit sipas kërkesave të ministrive dhe agjensioneve të cilat kanë kërkuar raporte për punën dhe aktivitete të njësive këto raporte i ka dërguar me kohë.

Nr.	Emri i aktit të lëshuar	Nr.i lëndëve të kryera	Vërejtje
1	Mbajtja evidencave të pushimeve vjetore me kërkesa	143	
2.	Kërkesat dërguar M.A.P. për aprovim për lejin e konkurseve publike	12	
3.	Vërtetime mbi marrëdhënien e punës për Shërbyesit Civil.	45	
4.	Vërtetime të ndryshme për praktikantët të cilët e kanë kryer praktiken në Administratën Komunale.	2	
5.	Shpallje të konkurseve	12	
6.	Formular mbi pagat	17	
7.	Formular për punëtor të rinj	0	
8.	Formular për ndryshime	29	
9.	Formular për pagesa retroaktiv	0	
10.	Intervistim me shkrim	12	
11.	Intervista me gojë	12	
12.	Përshkrimi i vendeve të punës	12	
13.	Fletëparaqitje disiplinore të bëra nga përgjegjësit kompetent	0	
14.	Ankesa të shërbyesve civil dhe qytetarëve	3	
15.	Kontrata me SH.V. për 4 muaj	53	
16.	Kompletim i dosjeve personale	93	

17.	Dërgimi i formularëve për deklaram te pasurisë për te gjithë këshilltaret	43	
18.	Formular për ndryshime për ndërrim te llogarive rrjedhëse	14	
19.	Vendime për punëtorë të pensionuar parakohshëm	0	
20.	Aktëmërimet	0	
21.	Vendim për largim nga puna për shkak të vdekjes.	2	
22.	Vendim për pensionim të pleqërisë	6	
23.	Anulim te konkursit	7	
24.	Lëshime te vendimeve për të pensionuarit-Kompensim një page.	6	
25.	Konkurse me shërbime te veçanta	21	
26.	Raporte për MAP- 3mujorshe	4	
27.	Përgjigje ne ankesë KPMK	0	
28.	Përgjigje në informata të kërkuara nga KPMK	0	
29.	Vendime të pushimeve të lehonisë	0	
30.	Vendime për rifillim te punës	0	
31.	Numri i përgjithshëm për vlerësimet e punës të shërbyesve civil	0	
32.	Transfer prej KK. Viti nëpër institucione te ndryshme	0	
33.	Vendime për kompensim një pagë për anëtarët e ngushtë te familjes.	43	

Zyra për Barazi Gjinore

Në raport janë prezantuar aktivitetet të cilat pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara përgjatë periudhës janar – dhjetor 2020, ku prej tyre veçojmë:

- Analiza gjinore dhe përgatitja e buxhetimit gjinor në kategoritë ekonomike: paga mëditje dhe subvencione
- Sigurimi i të dhënave statistikore nga këto sfera:
 - zhvillim ekonomik;
 - punësim / mirëqenie sociale;
 - shëndetësi;
 - procesin e vendimmarrjes;
- Në bashkëpunim me Organizatën Women for Women është organizuar takim me grupe të ndryshme të interesit, për gjetjen e teknikave adekuate që rrisin pjesëmarrjen e femrave në takimet publike
- Fuqizimi ekonomik i grave (bizneseve për vetëpunësim) përmes ndarjes së garantëve për zhvillimin e bizneseve (biznese për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore).

- Takim i organizuar me këshilltarët e Kuvendit të Komunës për inkorporimin e kuotës gjinore sipas LBGJ-së në Rregulloren për funksionimin e këshillave të fshatrave

P.S. Për shkak të rrethanave pandemike, nuk kemi mundur të realizojmë të gjitha objektivat e përcaktuara në Planin e Punës të aprovuar në Kuvendin e Komunës në dhjetor të vitit 2019.

Zyra e Prokurimit

Raport vjetor për Zyrën e Kryetarit për vitin buxhetor 2020, ka të përmbledhur aktivitetet e prokurimit të zhvilluara për ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e punëve dhe furnizimeve që janë domosdoshmëri për plotësimin e nevojave të komunës, bazuar në kërkesën e njësive shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për plotësimin e kërkesave të njësive buxhetore dhe mbarëvajtje pa pengesa të aktiviteteve të komunës, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara në interes të komunitetit dhe mirëqenies qytetare në përgjithësi. Këto aktivitete zyra i zhvillon bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik. Bazuar në këtë, Zyra e Prokurimit ka përgatitur këtë raport për aktivitetet e prokurimit për vitin 2020, në të cilin janë të përfshirë aktivitetet e realizuara të prokurimit dhe aktivitetet tjera të cilat janë në procedurë e sipër, ku përfshihen në këtë vit buxhetor.

Në periudhën e vitit 2020, duke u bazuar në kërkesat e njësive shpenzuese, zyra ka iniciuar 67 aktivitete të prokurimit. Duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndara në punë, shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna: 20 aktivitete me lëndë prokurimi Shërbime, 20 aktivitete me lëndë prokurimi Punë dhe 27 me lëndë prokurimi Furnizime. Nga këto aktivitete, 60 janë përmbyll si aktivitete, tjerat janë në procedurë. Ndërsa lloji i procedurave e udhëhequra janë si vijon: 39 raste është përdorë procedura e hapur, 19 raste procedura e kuotimi i çmimit dhe 3 aktivitete procedurë me vlera minimale, dhe 6 aktivitete procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.

Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara, 60 aktivitete të prokurimit janë përmbyll dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave, ndërsa 7 aktivitete të prokurimit janë në zhvillim apo procedim të mëtutjeshëm.

Për këtë vit buxhetor janë planifikuar 84 aktivitete të prokurimit të parapara për tu udhëhequr për vitin 2020. Për këtë vit buxhetor janë realizuar 80% e aktiviteteve të gjithmbarshme të planifikuara, duke poentuar se disa nga aktivitetet e parapara janë zhvilluar nga AQP-ja dhe këto aktivitete ne nuk i kemi zhvilluar, por ato duhet të figurojnë në Planin e prokurimit, pasi që AQP-ja për çdo vit kërkon deklaratat e nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve, të cilat duhet plotësuar dhe dorëzuar si mjete të planifikuara për kontratat të cilat ka udhëhequr AQP-në në nivel qendror.

Zyra e Prokurimit përveç këtyre aktiviteteve ka realizuar edhe pagesa për operatorët ekonomik që kanë kryer punë, furnizime apo shërbime sipas kontratave që kanë me komunën tonë. Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura është 3.930.292.18 €.

Ndër aktivitetet që zhvillon nga Zyra e Prokurimit, është edhe nxjerrja e urdhërblereve dhe procedimi i pagesave. Gjatë kësaj periudhe kohore janë lëshuar **1163 urdhërblere** për pagesën e OE të kontraktuar, duke udhëhequr lëndët për kompletim dhe janë dërguar në thesar për pagesë, gjegjësisht ekzekutim. Zyra e Prokurimit ka kryer edhe 174 rekomandime për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlerësim dhe komisioneve tjera.

Duke e përgatitur këtë raport, duhet potencuar se Zyra e Prokurimit në gjatë viti fiskal 2020, ka kryer punë dhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë njësive shpenzuese, duke ofruar këshillime dhe shërbime profesionale, me qëllimin e mbarëvajtjes së punëve në komunë dhe respektimin dispozitave ligjore në fuqi, por edhe ka pranuar dhe proceduar të gjitha kërkesat që kanë ardhur nga këto njësi.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Gjatë vitit 2020, respektivisht periudhës janar-dhjetor, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e Komunës së Vitisë, ka qenë e angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale. Gjatë kësaj periudhe, që është karakterizuar kryesisht me gjendjen e pandemisë të shkaktuar nga virusi COVID-19, kjo zyre megjithatë ka vazhduar punën duke përcjellë të gjitha aktivitetet të rregullta por edhe të veçanta si dhe ka njoftuar publikun e gjerë për zhvillimet e gjithmbarshme në komunën e Vitisë. Gjitha këto ngjarje, janë pasqyruar dhe publikuar në Web faqen e komunës kk.rks-gov.net/viti si dhe në adresën e komunës së Vitisë në rrjetin social Facebook.

- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, gjatë kësaj periudhe ka publikuar 34 dokumente mbi procedurat e konkurrimit dhe pranimin në punë si dhe 70 dokumente mbi procedurat e prokurimit publik si: Kontratat e Nënshkruara, Njoftime për Kontratë, Njoftime për dhënie të Kontratës, Planet dhe Raportet e Prokurimit Publik.
- Janë publikuar gjithashtu edhe 63 Njoftime publike, 18 Vendime të Kuvendit Komunal, 24 Vendime të Kryetarit të Komunës, të gjitha draft dokumentet të cilat janë paraparë të shqyrtohen në Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin Komunal.
- Kemi harmonizuar dhe funksionalizuar uebfaqën në gjuhën serbe.
- Po ashtu janë publikuar edhe disa Plane e Raporte si dhe Dokumentet të cilët ndërlidhën me shpenzimin e parasë publike.
- Një bashkëpunim të ndërsjellët dhe shumë të mirë, kemi pasur me mediat lokale dhe ato qendrore. Përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet për ngjarjet nga komuna e Vitisë edhe përmes fotografive.
- Zyra për Informim publik ka përcjellë gjitha aktivitetet e kryetarit të komunës, apo edhe zyrtarëve të tjerë komunal në terren.
- Pritjen e delegacioneve vendore dhe të huaj në komunën tonë.
- Në kuadër të zyrës janë bërë specifikimet e shpenzimeve për publikime: Shpallje, Konkurse, tenderë, Njoftime etj.
- Ndërkaq në kuadër të punës së Zyrës për Informim Publik, janë pranuar dhe shqyrtuar --- Kërkesa për Qasje në Dokumentet Publike.
- Zyra për Informim ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha trajnimet, punëtorit dhe mbledhjet e ndryshme për ndryshimin e pakos ligjore për Transparencë dhe finalizuar ndryshimin e Rregullores për Transparencë. Kurse gjatë vitit 2021 pritet të bëhet edhe hartimi i Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 4 vjeçare.
- Janë mbajtur edhe dy debatet e rregullta të kryetarit të komunës në formë elektronike. Debat i parë është mbajtur me datën: 26.06.2020, kurse pyetjet janë pranuar përmes platformës Google Forms prej datë 17.06.2020 deri 26.06.2020. Në debatin e parë janë pranuar gjithsej
- Debat i dytë i rregullt që është mbajtur në të njëjtën formë me datën: 28.12.2020. Prej datës: 11.12.2020 deri 28.12.2020 janë pruar gjithsej 123 pyetje dhe komente. Këto debate janë transmetuar drejtpërdrejtë në rrjetin social facebook në llogarinë "Komuna e Vitisë" dhe nëpërmjet transmetimit të drejtpërdrejtë televiziv në Plus TV.
- Gjithashtu me qëllim të planifikimit të buxhetit komunal për vitin 2021-2023 ZIMP në bashkëpunim me DLEFZH ka bërë grumbullimin e komenteve dhe propozimeve. Edhe kjo është bërë në formë virtuale përmes platformës Google Forms prej datës: 11.08.2020 deri

25.08.2020. Gjithsej 20 qytetarë prej 9 lokaliteteve kanë dhënë komentet e tyre për investimet:

Më poshtë kemi një table të takimeve publike të mbajtur me qytetarë gjatë vitit 2020.

Evidenca nga vjetorja e takimeve publike Janar-Dhjetor 2020-TAKIMI	Gjinia M	Gjinia F	Gjithësej	Data
Propozim Strategjia Komunale kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 202-2023	5	5	10	20.02.2020
Korniza Afatmesme Buxhetore 2020 vlerësimet e hershme për vitet 2021-2023	15	5	20	19.06.2020
Debat i parë publik i kryetarit të komunës për vitin 2020-VIRTUALE	10	3	13	26.06.2020
Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave	26	3	29	01.07.2020
Propozim Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave	25	3	28	01.07.2020
Propozim Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021	7	0	7	01.07.2020
Propozim Rregullorja për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha 2021 (Virtuale) Nuk ka pranuar komente	0	0	0	03.08-04.09.2020
Plani i punës së Kuvendit Komunal (Virtuale) Nuk ka pranuar komente	0	0	0	04.09.2020
Propozim Rregullorja për Tatimin në Pronë 2021 (Virtuale) Nuk ka pranuar komente	0	0	0	04.09.2020
Planifimi i buxhetit komunal 2021-2023 (Virtuale)	17	3	20	11.08-25.08.2020
Propozim Rregullorja për mbrojtjen e fëmijës	6	1	7	30.11.2020
Konsultimi publik për projektin ideor "Rregullimi i sheshit në qytetin e Vitisë" (Virtuale) Nuk ka pranuar komente	0	0	0	01.05-01.06.2020
Debat i dytë publik i kryetarit, (Virtuale)	114	9	123	11.12-28.12.2020
Totali	225	32	257	
Struktura gjinore në përqindje	88%	12%	100%	

- Gjithashtu Zyra për Informim konkretisht Koordinatori Komunal për performancë, ka ndjekur të gjitha trajnimet lidhur me SMPK si dhe në bashkëpunim me zyrtarët raportues ka përgatitur raportin e SMPK-së për vitin 2019.

Lektori

Gjatë periudhës kohore janar - dhjetor 2020, si lektor Administratës së Komunës dhe i Kuvendit të Komunës së Vitisë, kam kryer punë dhe detyra të punës sipas përgjegjësisë zyrtare dhe përshkrimit të detyrave të vendit të punës. Kam lekturuar dokumente zyrtare për Zyrën e Kryetarit, për Kuvendin e Komunës, për drejtoritë, për njësitë dhe zyrat komunale etj.

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2020 kam lekturuar këto dokumente:

- Informata vjetore e Kryetarit të Komunës me drejtorit komunale 2019. Informatë e punës e kryetarit të komunës janar-qershor 2020.
- Propozim plani i punës për komunitete. Rregulloren komunale për transparencë 2020; Informatë (DSHPE-ja, 10.06.2020); Propozim vendim, korrik 2020 (DKA). Propozim rregullore, nëntor 2020 (DEFZH); Rregullore për ngarkesa, taksa dhe gjoha, 29.09.2020 (DEFZH); Informatë 10.06.2020 (DSHPE); Plani i punës i Komitetit për Komunitetet janar-dhjetor 2020; Rregullore për këshilla të fshatrave tetor 2020; Rregullore komunale për transparencë janar 2020.
- Kërkesë kryeministrit 13.10.2020; Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Vitisë dhe shoqatës ekonomike kulturore "Qëndresa Kosovare" sh.e.k.q.k
- Vendimet e kuvendit (shtator, tetor, 26.10, 30.11, 21.12, 2020). Vendim 15.09.2020.
- Procesverbalet e Kuvendit Komunal, procesverbali XII-2019, Mbledhja urgjente e kuvendit 31.03.2020; Mbledhjen e jashtëzakonshme 13.03.2020, 07.05.2020, 15.09.2020, procesverbal I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII.
- Procesverbalet e KPF-së, procesverbal XII-2019, procesverbali I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII. Ftesë KPF 27.11.2020.

Gjithashtu kam ndihmuar edhe gojarisht zyrtarët sipas ndonjë kërkesë me gojë që më është shtruar dhe kam kryer punë shtesë.

Zyra e Avokatit Publik të Komunës

Avokati i Komunës për periudhën për të cilën po raportojmë, 01.01.2020—21.12.2020 kemi pranuar nga gjykatat tona 38 lëndë në përgjithësi të natyrave të ndryshme, civile, penale dhe lëndë të ndryshme.

Landë me padi civile kontestimore janë 24, Penale janë 8, ndërsa lëndë të ndryshme që kanë të bëjnë me gjetjen, rregullimin, fiksimin e megjave ose sinorëve, janë 6. Për 24 lëndët me padi civile-kontestimore, me bazë juridike njohja e të drejtës së pronësisë –vërtetimit të pronësisë, në bazë të shpronësimit për interes nacional. Për këto lëndë kemi ushtruar përgjigje në padi, të cilat ende presin për tu proceduar në shqyrtimet gjyqësore. Për 8 lëndët penale, janë për uzurpime publike, në pronësi shtetërore, të cilat kanë filluar me kallëzim penal, të cilat sipas detyrës zyrtare i udhëheqë prokurori shtetëror, të cilat 4 lëndë janë përfunduar dhe uzurpuesit janë shpallur fajtor dhe janë dënuar sipas ligjit. Ndërsa 4 lëndët e tjera ende presin për tu shqyrtuar në gjykata. Për 6 lëndët e natyrës së ndryshme që kanë të bëjnë me gjetjen, rregullimin, fiksimin e megjave ose sinorëve, këto lëndë janë të përfunduara, se vet natyra e zgjidhjes së këtyre lëndëve të ndryshme nuk paraqesin probleme juridike, por varet vetëm ekspertiza nga vendi i ngjarjes, gjithëherë këto lëndë të natyrës së këtillë, prodhojnë efekte juridike, si për palën propozuese, njëashtu edhe për palën kundërpropozuese.

Për periudhë për të cilën po raportojmë, përveç lëndëve të rregullta kemi edhe lëndë të bartura nga vitet paraprake, të cilat nuk janë të pakta, ende gjinden në procedurat e ankimimit, duke u atakuar me mjete juridike dhe me mjete të jashtëzakonshme juridike, në të gjitha instancat gjyqësore dhe ende presin epilogun përfundimtar.

Arsyeja e mos përfundimit të lëndëve, qofshin ato të rregullta apo edhe ato të bartura, arsyeja qëndron në këto premisa: sepse që nga marsi 2020, si gjithë globin tokësor ashtu edhe Kosovën tone e ka kapluar një ngjarje e padëshirueshme edhe e rrezikshme për jetë, pandemia COVID 19 dhe në respektim të masave të Qeverisë së Kosovës. Të gjitha institucionet e Kosovës e edhe Gjykatat e Kosovës, kanë punuar dhe tani janë duke punuar me stafë shumë të reduktuar. Krejt kjo është arsyeja e mos arritjes së shtjellimeve, përfundimeve të lëndëve nga gjykatat tona dhe në përgjithësi. Të gjitha këto lëndë i takojnë periudhës tani që po flasim, dhe dhashë Zoti që tani e tutje të kaloj kjo pandemi dhe të fillojnë punët në të gjitha sferat e jetës, edhe në gjykatat tona.

Zyra për Integritet Evropian

Zyra Komonale për Integritet Evropian, zyrtari për integritet evropian gjatë periudhës janar – dhjetor 2020, ka kryer këto aktivitete:

- Kemi profilizuar Planin Kombëtar për Integritet Evropian 2020 dhe iu ka rekomanduar Zyrës së Kryetarit të Komunës, Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit, drejtorive komunale dhe zyrave ndihmëse të Kryetarit të Komunës, për plotësimin e objektivave që dalin nga Plani Kombëtar për Integritet Evropian 2020;
- Kemi mbajtur takim njoftues me Zyrën e Kryetarit të Komunës, Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit, drejtoritë komunale dhe zyrat ndihmëse të Kryetarit të Komunës;
- Kemi përcjell punimet e takimeve të KPF-së;
- Kemi përcjell punimet e seancave të Kuvendit të Komunës;
- Kemi marrë pjesë në komisionin për riintergrim e të riatdhesuarve.

Zyra për Riatdhesim

Gjatë kësaj periudhe kohore janë kryer këto aktivitete:

- Janë riatdhesuar:
Nga Gjermania:
-Me familje: dy persona
Nga Franca:

-Me familje- Një çifte bashkëshortor me dy fëmijë- 4 anëtarë

Nga Suedia;

-I person-serbe;

Nga Shtetet tjera: S'ka;

Gjithsej të riatdhesuar 7 persona;

- Ndihmë-Përfitues sipas rregullores 13/2017 janë:

Një familje me 4 anëtarë (banim përmes qeras 2 herë nga gjashtë muaj);

- Kërkesa 1;
- Përgjigje 1;
- Me formular të riatdhesimit janë pajisur 14 persona, kërkesa kryesisht për kompletim të dokumentacionit që iu është kërkuar palëve nga Zyra e Komunale e Punësimit
- Komisioni Komunal për Riintegrim dhe Riatdhesim ka mbajtur dy konsulta telefonit shkak i pandemisë nuk jemi takuar;

VENDIME-vetëm një VENDIM për banim përmes qerasë(dy herë nga gjashtë muaj);

- Janë monitoruar rastet që ishin për monitorim në bashkëpunim: ZKKK, ZKK-ja Regjionale dhe Zyra Komonale e Punësimit;
- Rregullorja (QRK), nr.22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.

Zyra për Projekte

Bazuar në detyrat e punës nga Zyra e Kryetarit të Komunës dhe kërkesat e zyrës së projekteve gjatë periudhës janar- dhjetor të vitit 2020, kemi punuar në hartimin e projekteve, raporteve të pranimi të tyre dhe mbikëqyrjes së zbatimit të projekteve.

Përveç hartimit të projekteve të lartpërmendura, kemi kryer edhe këto punë, si:

- Hartimin e detyrave projektuese;
- Pranimin teknik të hartimit të projekteve të ndryshme;
- Pranime teknike të projekteve të përfunduara;
- Komisione të ndryshme për vlerësim;
- Menaxhimi i zbatimit të projekteve;
- Angazhime tjera shtesë sipas kërkesave të menaxhmentit.

KAPITULLI III

Raportet e Drejtorive

Drejtoria për Administratë

Misioni i Drejtorisë për Administratë është zbatimi i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ligjeve tjera që aplikohen në Administratë, Udhëzimet Administrative të nivelit qendror, Statutit të Komunës së Vitisë dhe akteve tjera komunale të aprovuara nga Kuvendi i Komunës.

Drejtoria e Administratës, kryen shërbime të përgjithshme administrative për organet e administratës dhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Komunës së Vitisë.

Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera të kësaj drejtorie përfshijnë:

- Ofrimi i shërbimeve dhe kryerja e punëve administrative mbështetëse për punën e Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit të Komunës dhe Këshillit të Drejtorëve.
- Përgatitja e akteve të cilat i nxjerr Kryetari i Komunës, Këshilli i Drejtorëve.
- Harton propozim rregullore, propozim vendime në fushën e Administratës,
- Kujdeset për përkthimin e materialeve të Kuvendit, trupave të kuvendi dhe Këshillit të drejtorëve duke respektuar gjuhët zyrtare.

Drejtoria e Administratës, ka realizuar objektivat të cilat dalin nga Plani i Punës së Drejtorisë për vitin 2020.

Drejtoria për Administratë ka hartua planin e veprimit për muajt Janar dhe Dhjetor 2020 për arsye të kryerjes së shërbimeve administrative për bashkatdhetarët që vijnë nga bota e jashtme për pushime verore.

Në vazhdim do të paraqesim punën e sektorëve të kësaj drejtorie.

I. Sektori për punë administrative

Sektori për punë administrative ka kryer punët dhe detyrat e punës për nevojat e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Kryetarit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve dhe drejtorit të Drejtorisë për Administratë.

Ky sektorë ka përgatit ftesat dhe materialet tjera për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Këshillit të Drejtorëve, Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, etj. Kuvendi i Komunës ka mbajtur 9 seanca të rregullta, të jashtëzakonshme 3, solemne 2, urgjente 1. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta. Komiteti për komunitete ka mbajtur 8 mbledhje dhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta.

Kuvendi i komunës ka miratuar: 3 rregullore dhe 3 plotësim-ndryshim të rregullores, dhe 84 vendime të ndryshme. Të gjitha këto akte normative të Kuvendit janë përgatit për procedurë për nënshkrim dhe protokollim dhe janë dërguar në Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal për vlerësim të ligjshmërisë së këtyre akteve. Janë përgatit 9 procesverbale të seancave të Kuvendit të Komunës, 8 procesverbale të Komitetit për Politikë dhe Financa, 08 procesverbale të Komitetit për Komunitete, dhe 6 procesverbale të KKS, 3 procesverbale të seancave solemne, 2 procesverbal i seancës së jashtëzakonshme, urgjente 1.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Këshilli i Drejtorëve ka mbajtur mbledhje konsultative, ditorë, javore dhe mbledhje të rregullta ku janë shqyrtuar materiale të ndryshme të cilat janë përcjellë për shqyrtim dhe aprovim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal. Për mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve është përgatit materiali si dhe janë hartuar procesverbale për këto mbledhje.

Për nevojat e Kryetarit të komunës për këtë periudhë raportuese janë hartuar dokumente të ndryshme si vendime, marrëveshje të ndryshme, kërkesa dhe shkresa të ndryshme. Dokumentet e

hartuara janë të natyrave të ndryshme: Propozim vendime për kuvend, të ndarjes së ndihmave financiare, vendime për formimin e komisioneve të ndryshme për pranimin e mallit, vendime për caktimin e menaxherit për mbikëqyrjen e punëve, vendime për pranimin teknik të punëve etj.

Zyrtari për përkthim ka përkthyer në mënyrë simulantë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, Komitetit për Politikë dhe Financa, Këshillit për Siguri në Bashkësi, Komitetit për Komunitete dhe Këshillin e Drejtorëve. Gjithashtu ka përkthyer edhe të gjitha materialet të cilat kanë dal nga mbledhjet e Kuvendit, KPF, KKSBB, Komitetit për Komunitete dhe Këshilli i Drejtorëve.

II. Sektori i gjendjes civile

Në vazhdim po e paraqesim numrin e dokumenteve të lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile për periudhën Janar –Dhjetor 2020,

Nr.	Përshkrimi i Lendeve	totali
1	Ekstrakt nga regjistri qendrori gjendjes civile	14691
2	Certifikata Lindjes	6036
3	Certifikata e martesës	2707
4	Certifikata e Vdekjes	1278
5	Certifikata Vendbanimi	783
6	Deklaratë për bashkësinë familjare	2586
7	Certifikata e gjendjes martesore	497
8	Certifikata e Shtetësisë	271
9	Vërtetim nga Arkivi	577
10	Vendimet	127
11	Aktvdekjet	114
12	Vërtetimi Mjeteve	28
13	Vizita	04
14	Regjistrimet në LAL të jashtme	233
15	Regjistrimet në LAL të brendshme	06
16	Regjistrimet në LAV (vdekje të jashtme)	42
17	Regjistrimet në LAV (vdekje të brendshme)	210
18	Regjistrimet në LAM të jashtme	82
19	Kurorëzime të reja	320

20	Shkurorëzime	40
21	Humbje Shtetësie	40
22	Fitim Shtetësie	05
	Totali i dokumenteve të lëshuara	30.677

Numri i përgjithshëm dokumenteve të lëshuara për periudhën Janar – Dhjetor 2020 është 30.677 dokumente. Qytetar të futur në sistemin e Gjendjes Civile janë: 54234

Vërejtje: Efikasiteti dhe azhuriteti i punës të sektorit gjendjes civile kishte me qenë edhe me i madh po të mos përballeshim me pandeminë KOVD 19 që nga 13.03.2020.

III. Sektori i Zyres pritëse dhe arkivit

Zyra Pritëse, në kuadër të aktiviteteve të saj të cilat i ka kryer për këtë periudhë raportuese për vitin 2020 janë si: regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtresave, shërbimet postare për organet e administratës komunale, ofrimin e ndihmës juridike qytetarëve për plotësimin e kërkesave, dhe regjistrimin e kërkesave në protokoll.

Numri i kërkesave të pranuar në zyrën pritëse është paraqit në formë tabelore.

Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Vdekurve -L.A.V nga jashtë	31
Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Martuarve -L.A.M nga jashtë	86
Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Lindurve -L.A.L nga jashtë	232
Kërkesa për regjistrim në LAV brenda vendit	149
Deklarata për vendqëndrim	0
Deklarata për trashëgimi	108
Deklarata për përkujdesje financiare	65
Deklaratë për regjistrimin të më vonshëm në LAL	25
Deklarata për regjistrim në LAV	58
Gjithsejtë:	754

LËNDËT E ARKIVUARA

Drejtoria	Nr. i lëndëve të arkivuara
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	243
Drejtoria për Administratë	25.762
Drejtoria për Arsimit	931
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	157
Drejtoria për Financa Ekonomike dhe Zhvillim	8.914
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	192
Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mjedisit	141
Drejtoria e Inspeksionit	89
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	801
Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	5.660
Kuvendi i Komunës	2
Zyra e Kryetarit	375
Zyra për Komunitete	2
Totali	43.271

IV. Sektori i administrimit

Ky sektor përfshin shërbimet që kanë të bëjnë me mbështetjen logjistike të organeve të administratës dhe atë:

Kujdesit për mirëmbajtjen e auto veturave zyrtare të organeve të administratës, sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Vërejtje: Për punë më efikase dhe menaxhim me te suksesshëm ne këtë sektor duhen te bëhet renovimi i objekteve komunale, autoparkut, dhe krijim i hapësirave të nevojshme për punë.

Në vazhdim po i prezantojmë shpenzimet e mirëmbajtjes, karburanteve dhe shpenzime tjera për automjete dhe gjeneratorë për periudhën Janar – Dhjetor 2020.

Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe gjeneratorëve për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë për periudhën raportuese janë ; euro.

- Administrata.....13309.00€,
- Shëndetësia 12444.00€ dhe
- Njësia e zjarrfikëseve..... 4070,00€

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, gjenerator, nxehe qendrore dhe autorizime për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë.

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë: litra

- Administrata.....13503 litra,
- Shëndetësia12941 litra dhe
- Njësia e zjarrfikës.....10066 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për nxehe qendrore për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë: litra naftë,

- Administrata..... 15018 litra
- D. Kulturës..... 0
- Shëndetësia2.610 litra,
- Njësia e zjarrfikësve..... 0 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për gjenerator për të gjitha njësit shpenzuese janë: litra.

- Administrata..... 1518 litra,
- Shëndetësia..... 614 litra,
- Njësia e zjarrfikësve..... 198 litra.
- DKA-ja (Shkollat)653 litra.

Zyra e IT-së ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative me qëllimin e zbatimit të standardeve dhe ofrimin e shërbimit më cilësor, në veçanti:

- Ka zbatua hardware, Softwerin Kompjuterik dhe të qasjes me internet
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet dhe kyçe sipas nevojave të ndryshme për organet komunale.

PËR PERIUDHËN 03.01.2019 E GJERË MË31.12.2019.

Nr.	Emërtimi	Nr.Intervenimeve	Vërejtje
1	Risetimipassword të Domenit	270	
2	Hapja e Userve të Domenit	150	
3	Hapja e Userave të Intranetit	2	
4	Intervenimet në Usera	250	
5	Intervenimet në rrjetin qeveritar	72	
6	Intervenimet në programe	400	
7	Konfigurimi i swiqit	6	
8	Intervenimet në Gjendjen Civile	150	

9	Intervenimet në Tatimin Pronë	120	
10	Futja e kompjuterëve në Domen	170	
11	Instalimi i software	00	
12	Instalimi i computer hardware devices	00	
13	Rregullimi kablove të internetit	100	
14	Intervenimet në E-mail	100	
15	Hapja E-mail Zyrtar të reja për zyrtar Komunal	15	
16	Intervenimet në Intranet	250	
17	Monitorimi i Kuvendit përmes Teleprezencës	0	
18	Drejtoria Arsimit	25	
19	Qendra për punë sociale	50	
20	Telefonave VOIP	5	
21	Skanimi kompjuterëve nga viruset	00	
22	Përgatitja e parames dhe paralogarive	00	
	Gj i t h s e j t ë	2135	
1. Mirëmbajtja e Serverit çdo ditë 2. Mirëmbajtja e Intranetit çdo ditë 3. Mirëmbajtja e Gjendjes Civile çdo ditë 4. Mirëmbajtja e pasurisë çdo ditë 5. Sistemi për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve çdo ditë			

Zyrtari për pranimin e mallit, gjatë periudhës Janar-Dhjetor të 2020 ka punuar në harmoni me përshkrimin e vendit të punës, ku ka realizuar objektivat që parashihen me planin e punës gjatë kësaj periudhe.

Pranues i mallrave ka kryer këto detyra të punës: Pranimin dhe regjistrimin e mallrave në sistemin e menaxhimit të Pasurive (E-Pasuria), ku në të përfshihen materialet shpenzuese si dhe asetet Komunale ku vlera e këtyre materialeve është 15132.75€ apo mbi 71 lëndë.

Janë bërë mbi 100 kërkesa për furnizime me material për zyre dhe inventar; Janë bërë furnizime me material shpenzues si dhe inventar për të gjithë njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë duke përfshirë zyrën e Kryetarit dhe të gjitha drejtorit tjera dhe Komunitetet; Ka asistuar në disa paramasa për furnizim me material shpenzues si dhe ka kryer detyra tjera që iu janë besuar nga menaxhmenti i Komunës.

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

I. Sektori i Financave

-Janë regjistruar 2191 kupona të shpenzimeve në SIMFK (sistemi i menaxhimit të financave të Kosovës) përmes transferit me procedurë të prokurimit në vlerë prej 4,783,408.97 euro

-Janë certifikuar 2191 pagesa përmes transferit me procedurë të prokurimit dhe aprovimit në 4,783,408.97 euro;

-Gjatë kësaj periudhe në programin e Administratës Komunale dhe Arsimit parauniversitar janë dorëzua në MAP – divizioni i pagave (punëtorë të ri, largime dhe ndryshime) ndryshimet, nga QKMF-ja kopje të pranuar të cilat janë përfshirë në evidencën e përgjithshme;

-Është bërë barazimi i të hyrave vetanake në baza mujore në mes të hyrave të arkëtuara dhe të hyrave të paguara;

-Janë pranuar, evidentuar, protokolluar 1960 fatura, kontrata, vendime dhe të njëjtat janë dorëzua për zotim dhe vijim të procedurës të mëtejme deri te ekzekutimi;

-Janë pranuar 541 raporte nga drejtorit që inkasojnë të hyra vetanake në vlerë dhe janë bërë 110 depozitime në bankë në vlerë prej 139.426.00 euro.

II. Sektori i buxhetit dhe thesarit

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2020 janë kryer këto punë:

- Regjistrimi i obligimeve të pa paguara për periudhën janar-dhjetor 2020;
- Përgatitja e pasqyrave financiare për periudhën janar-mars, janar-qershor dhe janar-shtator 2020;
- Sistemimi i të gjithë punëtorëve në sistemin e pagave nëpër të gjitha programet sipas planifikimit të buxhetit vitit 2020;
- Janë përgatit të gjitha deklaratat e disponueshmërisë së mjeteve për pagesë të projekteve duke u bazuar në planifikimin e buxhetit të vitit 2020;
- Dhënia e informacioneve për të gjithë udhëheqësit e programeve buxhetore mbi gjendjen e rrjedhës së parasë së gatshme për tërë vitin 2020;
- Barazimi i regjistrave të pasurive mbi dhe nën 1.000 euro, të regjistruara në frebalanc/E pasuria si dhe regjistrimi në regjistra intern;
- Janë bërë zotimet e mjeteve për të gjitha programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike, varësisht nga kërkesat e autorizuesve të buxheteve përkatëse;
- Përpilimi i raportit të shpenzimeve për MF për TM-1 , TM-2 dhe TM-3 2020;
- Raportimi i obligimeve të pa kryera në MF ,në departamentin e thesarit për çdo muaj dhe është bërë përgatitja e pasqyrave financiare për TM-1, TM-2 dhe TM-3 2020;
- Përgatitja e qarkores së parë interne komunale 2021/01.e datës 15.05.2020 për të zhvilluar procesin buxhetor komunal 2021-2023;
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Buxhetit (KAB) komunal për vitin 2021-2023 të datës 16.06.2020;
- Konsultimi i vazhdueshëm me drejtorët e drejtorive rreth inicimit të shpenzimeve të ndryshme komunale.

III. Sektori i Tatimit në Pronë

Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2020 janë kryer këto punë:

- Afrimi i shërbimeve për qytetarët e komunës për kryerjen e obligimit të tatimit në pronë;
- Afrimi i shërbimeve për qytetarët e komunës për pagesën e taksës komunale për automjete; .
- Lidhja e marrëveshjeve me tatimpagues për pagesën e detyrimit tatimor sipas kushteve të parapara nga DFEZH dhe dhënia e këshillimeve palëve për kushtet e pagimit të tatimit në pronë;
- Gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2020 janë shërbyer 7120 palë me vërtetime (struktura: 6050 vërtetime për regjistrim të automjeteve, 250 vërtetime për raste sociale dhe 2070 vërtetime për nevojë të katastrofit);
- Është kryer shpërndarja e mbi 11327 fakturave për çdo qytetar në Komunën e Vitisë;

- Gjatë periudhës janar- dhjetor të vitit 2020 janë inkasuar 331,345,69 euro nga tatimi në pronë dhe 84,810.00 euro nga taksa komunale për automjete;
- Realizimi i planit për tatimin në prone shprehur në përqindje është realizuar 77.06 % kurse taksa komunale për automjete është realizuar 94.76%;
- Kemi përgatitur një plan të veprimit nga një komision kompetent për rritjen e shkallës së inkasimit të tatimit në pronë;
- Është përpiluar lista e borxheve të qytetarëve sipas fshatrave dhe paraqitja e përqindjes së realizimit të obligimeve për çdo lokalitet.

IV. Sektori për ekonomi dhe zhvillim

Gjatë periudhës janar- dhjetor të vitit 2020 janë kryer këto punë:

- Kemi bere dorëzimin e raportit te punës për vitin 2020 dhe planin e punës për vitin 2020;
- Kemi bere shqyrtimin e kërkesave te qytetareve për marrjen e pëlqimeve për shfrytëzimin e parcelave te Agjensionit Pyjor dhe te pronave nën menaxhimin e AKP-se;
- Kemi bere kërkesat pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje te Mjedisit për marrjen e lejeve te kërkuara nga zyra e projekteve;
- Me kërkesë te MTI, përkatësisht Divizioni I Turizmit, ne bëmë grumbullimin e informative gjegjësisht bëmë identifikimin e produktit turistik për rajonin e Anamoravës, Komuna e Vitisë.

V. Projektet e investimeve kapitale për vitin 2020 të financuara nga buxheti i Komunës së Vitisë dhe buxheti i nivelit qendror.

1	Asfaltimi i rrugës Skifteraj - Stubell	64,127.00
2	Asfaltimi i rrugëve rurale (Viti, Drobesh, Beguncë, Lubishtë, Ramnishtë, Trestenik, Terpezë, Pozheran, Sllatine, Skifteraj, Budrikë, Smire)	512,547.20
3	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Smirë, Kolishtë dhe Terpezë	290,067.77
4	Rregullimi i kanalizimeve (Radivojc, Pozheran, Viti, Kabash, Beguncë, Sodovinë, Remnik, Smirë etj.	107,508.24
5	Rregullimi i rrugëve me zhavor (Kabash, Goshicë, Verban dhe Beguncë etj.)	131,306.15
6	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik (Smirë, Germove, Ramjan, Ramnisht, Pozheran, Viti, Germove, Kabash, Verban etj.)	372,800.00
7	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese – publike	43,703.00
8	Rregullimi i fushave sportive	168,382.00
9	Rregullimi i lumenjve (kanaleve) dhe prrockave	54,999.00
10	Zgjerimi i urave (Binçë, Pozheran)	11,800.00
11	Fusha ndihmëse e futbollit ne Pozheran	181,305.00
12	Riparime nëpër shkolla (Kabash, Smirë, Terpezë, Viti, Radivojc, Sllatinë, Fshati Ri dhe Pozheran.	137,047.98
13	Renovim i ambulantave	11,000.00
14	Furnizim me autoambulance	38,340.00

15	Ndërtimi i ambulantes në fshatin-Terpezë	20.000,00
16	Rregullimi i sheshit ne Viti në	194.951,25
17	Rregullimi i dy fushave sportive	40.000,00
18	Rregullimi i rrugës Viti-Sllatinë	39.116,50
19	Renovimi i shtëpisë se kulturës ne Viti	22.500,00
20	Rregullimi i studionit ne Pozheran	179.700,00
21	Rregullimi i gypit furnizues te ujës/jellësit Viti - Letnicë	24.000,00
22	Ndërtimi i shkollës fillore ne Drobesh	383.885,14
23	Ndërtimi i shkollës fillore ne Pozheran	300.000,00
24	Palestra e sporteve ne Drobesh (Punimi i konstruksioni te kulmit me kapriate)	117.000,00
25	Asfaltimi i rrugës Sedovinë e Jerlive-Verban	54.886,00
26	Hartimi i projekteve	68.537,00
27	Renovimi dhe ndërtimin i infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumit “Morava”	375.000,00
28	Renovimi i objekteve Komunale	23.405,58
29	Ndërtimi i infrastrukturës ne parkun industrial Budrikë	803.621,00
30	Ndërtimi i stadionit ne Viti	79.864,00
31	Projekti i furnizimit me ujë (Stubell Epërme, Podgorc, Dobelldeh) CDI	403.250,00
32	Furnizimi me aparatura dhe digjitalizim QKMF	12.635,00
33	Rregullimi i objektit për muze	29.400,00
34	Rregullimi i çerdhës së fëmijëve në Qifllak	66.000,00
	Gjithsej	5.062.384,81

Realizimi i këtyre projekteve gjatë vitit 2020 do të ndikoj drejtpërdrejtë në përmirsimin e jetës të qytetarëve.

VI. Zyra për regjistrimin e bizneseve

- Gjatë periudhës janar- dhjetor 2020 janë regjistru 172 biznese të reja;
- Gjatë kësaj periudhe janë shuar 27 biznese;
- Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 192 punëtorë.

Drejtoria e Inspeksionit

Drejtoria e Inspeksionit për viti 2020 është ballafaquar në mbi 70 % të punës me paraqitjen e pandemisë Anti-Covid, ku pothuajse të gjithë Inspektorët me autorizimet që ju kemi dhënë, kanë qenë në nivel të detyrës gjatë 24 orëve që iu është paraqitur rastet për inspektim, e në veçanti inspektori i sanitarisë ka qenë jashtëzakonisht i angazhuar edhe i rrezikuar për 24 orë prej fillimit të pandemisë 13 mars e tutje.

Inspektorët e tregut

- 54 Procesverbale mbi legalizimin e veprimtarisë së subjekteve të biznesit dhe pajisje me leje pune dhe mbikëqyrjet tjera në aspektin e zbatimit të ligjit për Nr:03/L-181;
- 120 Biznese ju është ndërpre veprimtaria në zbatim të masave anti covid, ndërprerja e masave kryesisht është bërë për tejkalim të orarit të përcaktuar me vendim të qeverisë për kufizim të orarit të veprimtarisë;
- 80 kontrole në zbatim të masave higjienike, dezinfektimin e hapësirave afariste, pajisjen e punëtorëve me mjete personale mbrojtëse, masave për distancim social dhe shmangien e kontaktit, hapësirave në mes tavolinave shërbyese, etj.
- 20 kontrole të përbashkëta me inspektorët nga drejtoria dhe policia në rrugët dhe sheshet e tubimit të njerëzve, me qëllim ndalimi i grumbullimit dhe respektim të masave tjera.
- 25 kontrole të tjera të përbashkëta me Policinë e Kosovës, në orët e mbrëmjes e sidomos në kohën e kufizimit të veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave nga vendimet e qeverisë;
- 5 aksione të përbashkëta me inspektorët e AUV në territorin e Vitisë;
- 12 kontrole mbi kualitetin, cilësinë, sigurinë e produkteve në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, së bashku me inspektorët sanitar, ku janë larguar nga qarkullimi dhe asgjësuar sasi e konsiderueshme e mallit të rrezikshëm për jetën dhe shëndetin e konsumatorëve;
- 14 kontrole në bizneset në zbatim të vendimit Nr:6167 për ndalimin e importit të vajit të pallmës, kontrollet tona në zbatim të këtij vendimi ishin në të gjitha bizneset që merren me veprimtari tregtare ushqimore dhe janë obliguar të bëjnë ndarjen, e në veçanti në rafta të produkteve bimë, shtazore dhe produkteve në përbërje me vaj pallme;
- 3 kontrole mbi ndalimin dhe kufizimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, me ç'rast ka ardhur deri te mbyllja e lokaleve dhe konfiskim i mjeteve dhe pajisjeve. Këto kontrole janë kryer kryesisht me njoftime dhe aksione të përbashkëta me Policinë e Kosovës;
- 10 kontrole nga urdhëresat e kryeinspektorit për largim të produkteve që nuk kanë qenë të regjistruara si market tregtar pranë MTI-së, e kryesisht kanë qenë produkte si çaji, etj;
- Nga kontrollet e ushtruara më lart, janë urdhëruar bizneset që të shpallim njoftimet për ndalim shitje, shërbim e duhanit dhe pijeve alkoolike të personave nën moshën 18 vjeçare; Gjithëashtu janë zgjidhur edhe kërkesa nga lëmia e mbrojtjes së konsumatorëve si dhe shume palë nga komunat janë udhëzuar për qendrën mbi mbrojtjen e konsumatorëve;
- Kërkesa mbi pranimin teknik të lokalit në shume prej 862.5 €;
- 24 Pranime teknike të lokaleve;

- 24 procesverbale të komisionit për pranim teknik;
- Gjatë këtij viti në trend ka qene hapja e barnatoreve farmaceutike dhe ordinancave të tjera mjekësore, ndërsa veprimtaritë tjera kanë pas vështirësi të njohura tash më;
- 65 vizita tjera ne biznese ne aspektin e zbatimit te dispozitave te ligjit Nr:03/L-181, dhe depozitave tjera mbi peshën dhe njësit matëse, çmimet e artikujve, shpallja e emërimit biznesit, kushtet e ushtrimit të veprimtarisë, e sidomos pajisje me pranim teknik të lokalit;
- 1 Takime pune me kryeinspektorin e inspektoratit te tregut ne Prishtinë.

Inspektori i mbrojtjes së mjedisit

- Mbikëqyrja e largimit të mbeturinave në qytet dhe lokalitete ku janë të pajisur me kontejner;
- Shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve;
- Implementimi i ligjeve dhe rregulloreve mjedisore;
- Zbatimin e Udhëzimit Administrativ për Ndëshkimet me Gjoha Mandatore;
- Implementimi i Rregullores për Leje Mjedisore Komunale;
- Në vazhdimësi i kemi përcjell gjendjen mjedisore në shumë lokalitete (e që hedhja e mbeturinave është mjaft e shprehur sidomos në lokalitete ku mungojnë kontejnerët);
- Inspektimin e enteve shëndetësore, lidhur me zbatimit e Udhëzimit Administrativ për Administrimin e Mbeturinave Shëndetësore;
- Inspektim në fshatin Sllatinë e Poshtme, Sadovinë e Qerkezve, Smirë sipas kërkesës gojore të palëve, lidhur me djegien e mbeturinave (kemi zgjidhur kontestin). Inspektim në fshatin Devaj, sipas kërkesës gojore të kryetarit fshatit, që disa familje nuk janë të kyqur në rrjetin e kanalizimit. Ju kemi dërgu vërejtje me shkrim gjashtë familjeve, dhe të gjashtë familjet janë kyqur në rrjetin e kanalizimit;
- Inspektim në fshatin Smirë, verifikimi kyqjes të një qytetari në rrjetin e kanalizimit kolektiv pas marrjes të ankesës gojore të një qytetari (ku kemi konstatuar se pala është e kyqur në rrjetin e kanalizimit);
- Inspektim i lokaleve afariste në Viti, që të pajisen me kontrata për bartjen e mbeturinave me ndonjë kompani të licencuar;
- Kemi inspektuar në trekëndëshin e rrugës Smirë, Kabash, Drobesh, ku ka hedhje të mbeturinave;
- Inspektim në rrugën Viti- Pozheran, Viti-Sllatinë e Epërme, Sadovinë e Qerkezve, Sadovinë e Jerlive, Vërban, Goshicë në pikat ku ka hedhje të mbeturinave;
- Inspektim në fshatin Debelldëh dhe kemi konstatuar se në rrugën anësore që qon kah Lagjja e Shaqirëve ka hedhje të mbeturinave përkaj përroit. Kemi inspektuar edhe fshatin Shushtë vendin e qujtur „Centralla”;
- Inspektim në fshatin Pozheran;
- Inspektim në fshatin Gjylekar, pikat e hedhjes të mbeturinave „Cërnell” dhe te „Ura e Moravës”;
- Inspektim në Lubishtë dhe kemi vërejtur sasi të madhe të hedhjes së mbeturinave në përroin e fshatit;
- Kemi kryer edhe punë tjera sipas kërkesës së drejtorit.

Inspektori i komunikacionit

Në bazë të planit vjetor të punës për vitin 2020, sipas dinamikës së punëve kemi realizuar këto objektiva:

- Zbatimi i Ligjeve dhe Rregullore në Fuqi si:
 1. Ligji i Transportit Rrugor Nr.04/L-179
 2. Ligji i transportit për mallra të rrezikshme Nr.2004/6
 3. Ligji i Trafikut Nr.05/L-088, si dhe Rregullorja Komunale për Organizimin e Transportit Brenda territorit të Komunës së Vitisë me Nr.01-13/764 të datës 30.05.2014, Vendimi mbi rregullimin e Komunikacionit në qytetin e Vitisë dhe territorin e sajë, me Nr.01-013/372 të datës 04.04.2017. si dhe rregulloret tjera komunale që lidhen me Komunikacion.
- Aktivitetet dhe detyrat sipas urdhrave të Drejtorisë dhe Eprorëve të tjerë, nga Komuna e Vitisë.
- Bazuar në Planin e punës sipas dinamikës kemi pasur këto aktivitete:
 - Koordinimi i bashkëveprimit me Policinë e Kosovës, Stacioni Policor në Viti
 - Bashkëpunimi me Gjykatën Themelore Gjilan dega në Viti D. për Kundërvajtje.
 - Organizimi i aktiviteteve të transportit me Operatorët e Transportit Publik dhe të mallrave në Komunën e Vitisë.
 - Kontrollimi i infrastrukturës rrugore, furnizimi dhe vendosja e shenjave vertikale dhe horizontale të komunikacionit.
- ❖ Koordinimi me Policinë e Kosovës, Stacioni Policor në Viti
Kemi pasur veprime të përbashkëta me Policinë Kosovës, në bazë të planit operativ të hartuar që më parë, mbi kontrollimin e transporteve, ndërsa sa i përket dëmtimit të shenjave të komunikacionit kemi pasur një ngecje duke mos u thirrur në kompetencat e përbashkëta, por vetëm në rastet kur unë kam hapur ndo një rast të veçantë edhe pse ligji autorizon edhe Policinë e Kosovës që të merret me angazhimin rreth ruajtjes së shenjave të komunikacionit. Gjithashtu kemi pranuar edhe kërkesa dhe njoftime të ndryshme nga P.K.-ja për ndryshimin apo edhe vendosjen e shenjave të Trafikut.
- ❖ Gjithashtu kemi organizuar veprime të përbashkëta me kolegët nga komuna e Gjilanit, dhe kemi pasur takime pune edhe me kolegët nga Ferizaji, Kamenica, Shtimja e Kaçaniku.
- ❖ Gjithashtu kemi koordinuar dhe harmonizuar të gjitha linjat Urbano-Periferike me Autobus, ku kemi një transport publik të kënaqshëm, në të gjitha linjat.
- ❖ Në kudër të kompetencave dhe përgjegjësiave tona, kemi kontrolluar të gjitha rrugët publike ku në disa raste kemi intervenuar në sanimin e gjendjes apo dëmtimeve të rrugës, mbylljen e kanaleve të hapura, apo mënjanimin e pengesave në rrugë pa ndo një leje përkatëse.
- ❖ Gjithashtu vlen të potencohet se kemi pasur shpesh prerje të rrugëve publike por në shumicën e rasteve ishim të kufizuar për të ushtruar detyrën tonë.
- ❖ Gjithashtu kemi lejuar vendosjen e Pengesave të ashtu quajtura (Polic i shtrirë) prej të cilave disa në mënyrë alternative nga gjysmë pengesa në të dy anët e shiritit të rrugës si në Kabash, Sodovinë e Jerlive, Beguncë (Rr.Toplana), Devajë, Sodovinë e Qerkezve etj.
- ❖ Gjithashtu edhe kemi menjanuar shumë pengesa si në Rr. "Mustafë Koka" në Viti, Beguncë etj.
- ❖ Në kuadër të furnizimit dhe vendosjes së shenjave Vertikale dhe Horizontale të Komunikacionit, në bazë të planit paraparak mbi kontratën për shërbime kemi furnizuar me

- shenja Vertikale dhe Horizontale të gjitha rrugët e qytetit të Vitisë, Rrugën Viti-Pozheran, Viti-Binë, Viti-Ramnishë-Bëguncë, Skifteraj, Tërpezë, Remnik, Sllatinë e Epërmë, etj.
- Kemi shënuar të gjitha vendkalimet për këmbësor, të cilat pas riasfaltimit përsëri janë shënuar por kësaj radhe me material plastik dy komponentësh.
 - Kemi sinjalizuar me shenja horizontale si Vendkalime etj. Edhe rrugët Rajonale në Pozheran, Radivoje, etj.
- Ndërkaq gjatë këtij viti janë asfaltuar edhe shumë rrugë të tjera të cilat i kemi vendosur në prioritet për sinjalizime me shenja të Komunikacionit horizontale dhe vertikale.
- Kemi lejuar vendosjen e të ashtuquajtura (Polic i shtrirë), me qëllim të rritjes së sigurisë në rrugë, në të gjitha vendet ku kemi konsideruar rrezik permanent.
 - ❖ Në kuadër të bashkëpunimit me komunitete: kemi qenë gjithherë në dispozicion për një bashkëpunim të mirëfilltë.
 - ❖ Kemi shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarë të ndryshëm, si dhe subjekte, si Operatorët e Transportit, po njashtu kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me të gjithë përfaqësuesit e Auto-Shkollave, dhe subjektet tjera që ishin të lidhur apo të interesuar për Gjendjen në Komunikacion, si Shoqëri civile Media etj.
 - ❖ Kemi bërë 95 kontrollime të mjeteve të transportit publik dhe të mallrave.
- Në këtë vit kemi bërë 2 (dy) vërejtje me shkrim për personat që kanë ndërhyrë në forma të ndryshme në rrugët publike.
 - Kemi hartuar 15 (Pesëmbëdhjetë) Procesverbale sipas detyrës zyrtare si leje, vërejtje, njoftime etj.
 - Kemi bërë 65 Procesverbale mbi shikimin e Automjetit për transport publik –Taxi
 - Dhe 2 Procesverbale për kontrollimin e Autobusëve.
 - Kemi bërë 67 Fletëpagesa për taksa komunale dhe atë 65 mbi shikimin e automjetit në vlerë prej 10 € për secilin automjet, dhe 2 fletëpagesa për Autobusa nga 10€
 - Kemi lëshuar 3 (Tre) leje për vendosjen e pengesave në rrugë.
 - Kemi bërë pranimin teknik të lokaleve së bashku me Ins. E Tregtisë dhe atë Sanitarë.
 - Pranimi i punimeve dhe hartimi i raporteve nga kontraktori Studio Reklama "Krosa", për vendosjen e shenjave të komunikacionit, në të cilin komision jam i angazhuar si Menaxher me vendim të kryetarit të Komunës.
 - Në pjesën e dytë të vitit kemi menaxhuar furnizimin dhe vendosjen e shenjave nga Kompania, "LIMIT" Prizren
 - Pastaj kemi qenë edhe nëpër komisione të ndryshme të pranimin të punimeve me vendime nga kryetari, si kanalizime, rrjete të ujësjellësit rrugë trotuare etj.
 - Dhe shumë punë e detyra të tjera të ngarkuara nga eprorët.
 - Linjat urbano-periferike për vitin 2020 në komunën e Vitisë. Gjithsej i kemi të mbuluar 28 vendbanime me 44 vendndalje për transport publik. Nga këto vendndalje 10 janë të shenjëzuara në rrugët rajonale ndërsa të tjera janë të pashënjëzuara.

Inspektorët e ndërtimit

Në bazë të planit vjetor të punës për vitin 2020, sipas dinamikës së punëve kemi realizuar këto objektiva:

- Zbatimi i Ligjit të Ndërtimit me Nr.04/L-110 të datës 31 Maj 2012 të Kuvendit të Kosovës dhe Rregullores Komunale mbi ndërtimet.
- Aktivitetet dhe detyrat sipas urdhreve të drejtorisë, dhe eprorëve të tjerë të komunës.

- Përcjellja e punimeve në ndërtimtari të cilat ka qenë të pajisura me leje ndërtimi, nëpër të gjitha fazat e betonimit të pllakave etj.

Në kuadër të aktiviteteve sipas detyrës zyrtare kemi pasur mjaftë angazhime rreth kontrollimit të ndërtimeve në komunën e Vitisë, ku kemi konstatuar këtë gjendje:

Se në disa raste të ndërtimit pa leje përkatëse, pas intervenimit tonë dhe hartimit të procesverbalit, shumë nga ndërtuesit i kemi detyruar që të pajisen me leje përkatëse të ndërtimit.

Ku në disa raste kemi bërë edhe vendime për ndërprerjen e punimeve dhe janë vendosur shiritat për ndalimin e punimeve të mëtejshme.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiave tona në këtë vit kemi hartuar Gjithsejtë: 78 Procesverbale nga vendi i ngjarjes.

Aktivitete në teren kemi pasur 345 raste të kontrollimeve.

- Aktvendime për ndërprerjen e punës 18 sosh.
- Vendosjen e shiritave për ndërprerjen e punimeve në 18 raste
- Kemi përgatitur mbi 5 lëndë të cilat i kemi të proceduar në Prokurorinë themelore në Gjiilan.
- Kemi përgatitur 6 Lëndë të cilat i kemi proceduar në Gjykatën Themelore Gjiilan, dega në Viti divizioni për kundërvajtje.
- Kemi hartuar 11 Vendime për rrënime të rasteve të ndryshme.
- Kemi përfaqësuar në Gjykatën Themelore në Gjiilan dega në Viti, D. për kundërvajtje në 9 lëndë të cilat janë përfunduar, ku kanë mbetur në procedurë edhe 6 lëndë.
- Kemi përfaqësuar edhe në shumë lëndë pranë Prokurorisë në Gjiilan.
- Gjithashtu në kuadër të aktiviteteve tona kemi qenë të angazhuar me Vendim të Kryetarit të komunës edhe në shumë raste të pranimeve teknike si: kanalizime, shtrirje të rrjetit të ujësjellësit, rrugë të ndërtuara, trotuare, ku për secilin rast kemi hartuar raporte pune veç e veç.

Inspektori i veterinarisë

Gjatë këtij, inspektori i Veterinarisë ka kryer këto shërbime me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik.

- Marrja e mostrave të gjakut për sëmundjet infektive: mbi 360 mostra të marra.
- Të eliminuara kafshë dhe bletë me sëmundje infektive 60 krerë gjedhe, 40 krerë dhi, 78 krerë dele, të cilat i kemi gruposur në varrezat e kafshëve me inspektoret e A.U.V-së dhe është duke u vazhduar në shëndetësimin e fermave.
- Inspektim thertore në Pozheran mbi 150 rate dhe mjetet e grumbulluara nga kontrolli dhe vulosja e mishit janë gjithsej 220 €.
- Inspektime të dyqaneve e qendrave tregtare që tregtojnë ushqime me prejardhje shtazore mbi 50 herë.
- Gjitha kërkesat e fermerëve dhe bletarëve janë shqyrtuar, qofshin ato gojore apo me shkrim.
- Inspektim të veterinerëve gjatë aplikimit të vaksinimit kundër sëmundjeve infektive.
- Gjitha ngordhjet e kafshëve në tërë territorin e Komunës së Vitisë që fermerët i kanë hudh që ne nuk kemi pas mundësi identifikimi janë gruposur rreth 7 krerë, të identifikuar ku pronaret na kanë ftuar janë mbi 10 krerë.
- Inspektime ambulancave veterinare.
- Inspektime të tregut të kafshëve dhe tregut të gjelbër.
- Inspektime në rastet e bartjes së kafshëve ilegalisht, ku kemi ftuar nga policia kufitare.

- Pjesën dërmuese të inspektimeve gjatë këtij viti i kemi zhvilluar së bashku me Inspektorët regional.
- Inspektime se bashku me bashkëpunëtorë, ku kemi zbatuar vendimet e Qeverisë anti Covid nga marsi e deri në fundvit.
- Procesverbale të hartuara në vend ngjarje 7 dhe së bashku me Inspektorët e AUV mbi 60 procese.
- Takime me qytetarë në zyre për probleme të ndryshme që i preokupojnë qytetarët, dhe punë tjera që i kontribuojnë drejtorisë i kemi zhvilluar me bashkëpunëtorë të drejtorisë.

Inspektori i sanitarisë

Nr.	INSPEKTIME	Shprehur në numra
1	Inspektime te objekteve afariste	Mbi 300
2	Pranime teknike te lokaleve	21
3	Mbyllje të lokaleve	5
4	Procesverbale	100
5	D>D>D	215
6	Inspektime te ujërave te pijshëm	35
7	Inspektime te ujërave te zeza	2
8	Mostra te ujerave rurale	7
9	Mostra te ushqimeve	15
10	Pëlqime Sanitare	10
11	Aktvendime	30
12	Kundërvajtje	43
13	Vepra Penale	2
14	Libreza Sanitare	55%
15	Inspektime te tregut	8
16	Asgjësimit te artikujve ushqimor	29.818 kg
17	Urdhëresa	15
18	Inspektime te objekteve shkollore	14
19	Inspektime te objekteve shëndetësore	10
20	Inspektime te pishinave	4
21	EX-Humime	0
22	Vendime për karantinim	782
23	Vendime për përfundim të karantinimit	29
24	Vendime për raste vdekje	19
25	Monitorime të varrimeve	35

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë gjatë periudhës raportuese Janar–Dhjetor 2020, ka pasur shumë detyra, obligime dhe përgjegjësi sipas planit të punës, të cilat i ka kryer me sukses. Gjatë kësaj periudhe, ne si Komunë jemi ballafaquar edhe me pandeminë COVID-19, edhe pse me kushte të vështirësuar, mirëpo drejtoria jonë ka punuar me kapacitete të plota në ofrimin e shërbimeve komunale.

1. Sektori i shërbimeve publike

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2020, ky sektor ka pranuar gjithsej 230 kërkesa të protokolluara të natyrave të ndryshme, të cilat i kemi kryer në afatin ligjor. Kemi lëshuar vendime të ndryshme.

leje për parkim, vazhdimi i lejeve për auto-taxi dhe ngarkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike për vitin 2020, si dhe janë bërë pagesa për shfrytëzimin e hapësirave publike, vendosjen e reklamave etj.

Gjatë kësaj periudhe kemi përcjell punët e operatorëve të kontraktuar nga Komuna, të cilët kanë kryer shërbime për Komunën.

Buxheti i drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjencë

DSHPE-ja për vitin 2020 ka pasur buxhetin e aprovuar dhe atë në shumë prej 949.792,92 € dhe atë sipas kategorive:

- Paga.....282.331,54
- Mallra dhe shërbime.....521.461,38
- Komunal.....146.000,00

Nga buxheti i aprovuar në total: 949.792,92 Euro, është alokuar shuma 886.031,44 Euro dhe është shpenzuar shuma prej: 883.596,44 Euro, ndërsa shuma prej: 66.196,48 është, buxhet i pa shpenzuar, ndërsa nga mjetet e alokuara kanë mbet të pa shpenzuara 2.435,47 Euro.

Shpenzimet për komunal

Shuma e përgjithshme e shpenzuar për komunal është 146.000,00 Euro, shpenzimi për komunal në përqindje është 100 %, duke mos i përfshirë obligimet e muajit dhjetor të vitit 2020, për PTK, Eco-higjiena, Hidromorava, KES/CO, të cilat barten për vitin 2021.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime

Për mallra dhe shërbime kemi pasur buxhet të aprovuar 521,461.38 Euro, të alokuara 457.700.00 €, të shpenzuara 443,693.60 €, dhe nga shuma e alokuar vetëm shuma prej 2,436.47 ka mbet e pa shpenzuar. Ka mbet një shume e pa paguar si obligim për punët që janë kryer në muajin dhjetor 2020, e që do të paguhet në tremujorin e parë të vitit 2021. Pra, drejtoria gjithsej për mallra dhe shërbime nga mjetet e alokuara ka shpenzuar 85.00%, për vitin 2021, duke mos i përfshirë edhe disa fatura të vitit 2020 të cilat barten në vitin 2021.

Të hyrat vetanake

Tabela e të hyrave vetanake të planifikuara dhe të realizuara 2017

Nr	Përshkrimi i të hyrave	Planifikimi vjetor për 2020	Realizimi vjetor për 2020	Përqindja e realizuar. Janar-dhjetor 2020
1	Qiraja	13.548.00 Euro	9139.00 Euro	67.46%
2	Shfrytëzim të hapësirës publike	3.600.00 Euro	3,160.50 Euro	87.79%
3	Reklamat	3,000.00 Euro	1,286.25 Euro	42.88%
4	Taksa për licenca tjera për afarizëm. (leje për autotaksi) dhe shërbime tjera profesionale.	1,800.00 Euro	110,00 Euro	6.11%
5	Parkimi publik	7.700.00 Euro	3,485.00Euro	45.26%
6	Të hyrat nga shitja e aseteve	0.00	7,273.38	
	Gjithsej	32.048.00 Euro	24,456.13 Euro	76.30%

Nga kjo tabelë shihet se realizimi i të hyrave vetanake ka qenë mesatarisht i realizuar nga ai i planifikuar.

-Mos realizimi i të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2020, qëndron në faktin se Kuvendi Komunal i Vitisë ka marrë vendim për lirim nga pagesa e shfrytëzuesëve të hapësirave publike për periudhën kohore mars, prill dhe maj, 2020.

Si dhe mos realizimi i të hyrave vetanake ka ndikuar pandemia Covid-19.

- Nuk janë inkasuar edhe të hyrat si taksë komunale për vitin 2020, në bazë të vendimit me Nr.01-013/1710, të datës 23.12.2016, për pezullimin e përkohshëm të nenit 13 pika 13.6 të rregullores komunale për taksa. Ngarkesa dhe Gjoka (taksës komunale autotaxi).

- Po ashtu edhe disa operator ekonomik të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj autoritetit kontraktues, ka ndikuar në mos realizimin e të hyrave vetanake të planifikua.

Mirëmbajtja verore – dimërore e rrugëve lokale

Kemi përcjell punët e kompanisë për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve si: pastrimi i rrugëve lokale nga akulli dhe bora, mbushjen e gropave me asfalt nëpër rrugë të asfaltuara, furnizimin me zhavor nëpër rrugët e rendit të katërt, pastrimi i bankinave të rrugëve lokale nga barojat dhe shkurret, vendosjen e mbrojtësve në disa ura etj. Operatori "Zuka Commerce" nga Gjilani, ka kryer shërbimet e kërkuara nga DSHPE dhe për shërbimet e kërkuara kemi shpenzuar për vitin raportues gjithsejtë shumën prej 45,918.25 Euro.

Mirëmbajtja e hapësirave të hapura publike(HHP)

Me Hapësira të Hapura Publike (HHP) të përfshira në këtë projekt nënkuptohen të gjitha sipërfaqet publike me rendësi për zhvillimin e jetës shoqërore dhe publike në qytetin e Komunës së Vitisë. Janë mirëmbajtje: parqet, sheshet, shëtitorja Viti-Binçë, Sshtrat i lumit "Morava", sipërfaqe gjelbëruese, hapësirat për parkim automjesh, rrugët në qytet, trotualet në qytet dhe lokalitetet e komunës, tregjet, lapidarë, pllakat përkujtimore, Varrezat e Dëshmorëve dhe varrezat e qytetit të Vitisë. Është bërë edhe krasitja e drunjeve dekorativ në qytet, mbjellja e drunjeve dekorativ, mbjellja e luleve në qytet etj. Me këtë projekt mirëmbahen gjithsej 319.156 metra katror hapësira publike në qytet dhe lokalitete të komunës. Në këtë projekt janë të punësuar 26 punëtor nga komuna jone. Operatori Arbor Grup nga Kamenica ka kryer këto shërbime për komunën tonë dhe në si komune për këtë projekt për vitin 2020 kemi shpenzuar gjithsej 141.525,10 Euro.

Mirëmbajtja i objekteve të administratës komunale, shëndetësore dhe arsimore

Gjate kësaj periudhe raportuese janë mirëmbajt dhe pastruar objekteve të administratës komunale, shëndetësore dhe arsimore. Në këtë projekt janë paraparë hapësira të brendshme dhe të jashtme të mirëmbahen dhe pastrohen. Janë mirëmbajt gjithsej 71489 m², ku hapësira të brendshme 15873 m² dhe hapësira të jashtme (oborret e objekteve) 55616 m². Në këtë projekt janë të punësuar 30 punëtor nga Komuna e Vitisë.

Me kontratën e lidhur në mes të komunës dhe kompanisë "AROMA PLUS" shpk & "KRASNIQI" shpk Ntp BENI, nga Prishtina – janë mirëmbajtur këto hapësira dhe komuna për këto vite ka shpenzuar gjithsej 147.609,10 Euro.

Mirëmbajtja e ndriçimit publik

Në komunën tonë kemi gjithsej llampa elektrike 10.882 copë, të cilat janë të vendosura në shtylla elektrike druri, betoni dhe shtylla metalike të zingura. Kemi tri lloje të llampave elektrike: llampa me natrium-(zhivë)-100 cope, poca ekonomik 65W- 4233 cope dhe të llojit LED 100W, 50V, 11W, 16W - gjithsej: 6549 copë. Në këtë raport nuk janë përfshirë dhe llogaritur trupat ndriçues që komuna këtë vit i ka bërë në ndriçimin publik, që do të thotë se kemi diku mbi 11.000 trupa ndriçues në territorin e komunës sonë të cilët mirëmbahen.

Me kontratën e lidhur në mes të komunës dhe kompanisë TERMOMONTIM SH.P.K janë kryer shërbimet e mirëmbajtjes së ndriçimit publik, ndërsa në si komune kemi shpenzuar gjithsej 40.019,60 euro. Ndërsa dekorimin e qytetit për festat e fundëvitit i ka bërë operatori i ri Shpk ATC COM nga Kaçaniku, e që do të paguhet në fillim të vitit 2021, e cili deri në muajin dhjetor 2021 e ka kontratën përveç dekorimit të qytetit edhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik.

Dezinfektimi dhe Dezinfektimi i objekteve të administratës komunale, objekteve shkollore, shëndetësore dhe hapësirave Publike

Gjatë kësaj periudhe raportuese respektivisht nga 13.03.2020 Komune e jone është ballafaquar me pandeminë COVID-19 dhe me operatorin ekonomik EKOLOGJIA SHPK të kontraktuar nga Komuna është bërë dezinfektimi i objekteve komunale, shëndetësore, arsimore, fetare, objekteve private (ku kanë jetuar të prekurit nga kjo epidemi) dhe hapësirat publike. Janë dezinfektuar edhe objektet e organeve shtetërore, Gjykata dhe Policia. Vlen të theksohet se me dezinfektim është marrë edhe një kompani Everi Day VM SHPK nga Ferizaji, e cila ka bërë dezinfektimin sipas kërkesave të komunës e që ka qenë donacion i kompanisë për komunën. Shërbimet për dezinfektim i kanë kushtuar komunës 35.263,96 Euro, duke mos llogaritur donacionin nga kompania e lartpërmendur.

Mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit

Me këtë projekt njëvjeçar mirëmbahen aparatet kundër zjarrit për NJPZ, institucionet e administratës komunale, arsimore dhe shëndetësore. Servisimi i tyre bëhet për çdo 6 muaj.

Furnizimi me veshmbathje verore për Njësia Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtimin në Viti

NJPZSH-ë janë furnizuar me këpucë verore, pantallona për sezonin verore dhe maica për të gjithë zjarrfikësit.

Ujësjellësi dhe kanalizimi

Në komunën tonë për mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përgjegjëse është kompania regjionale "Hidromorava", njësi në Viti. Kompania në fjalë, bënë furnizimin me ujë të pijshëm dhe mirëmban kanalizimin në qytetin e Vitisë, fsh.Drobesh, Ramnishtë, Pozheran, Qifllak dhe Letnicë. Ndërsa, në lokalitet tjera ku rrjetet e ujësjellësve dhe rrjetet e kanalizimeve nuk mirëmbahen nga kompania regjionale "Hidromorava", njësi punuese në Viti, janë mirëmbajtur nga operatori ekonomik Vizioni BD nga Vitia, i kontraktuar nga komuna jone. Janë përcjell punët e kompanisë për mirëmbajtjen e ujësjellësve dhe kanalizimeve nga ana e drejtorisë dhe gjatë kësaj periudhe raportuese janë bërë 58 intervenime në rregullime të kanalizimit dhe ujësjellësit, zhbllokime të kanalizimit, ndërrim të gypave, vendosje të pusetave, vendosje kapakëve nga betoni, vendosja e kapakëve nga metali etj. Gjatë vitit raportues për këto shërbime kemi shpenzuar shumën prej 21.657,50 Euro.

Mbeturinat

Eco-Higjiena si kompani publiko-private, njësi në Viti, bënë mbledhjen, transportimin e mbeturinave në deponin regjionale në Velekinë të Gjilanit dhe atë nga këto vendbanime të Komunës: Qyteti i Vitisë, Droboesh, Smirë, Terpezë, Pozheran, Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Ulët, Radivojë, Fshati Ri, Budrik, Remnik, Ramjan, Beguncë, Kabash, Germovë, Sodovin e Jerlive, Sadovin, Qerkezeve, Verban, Ramnisht, Goshicë, Skifteraj, Terstenik, Podgorc, Stubël, Epërme, Lubi shtë, Binç, Devaje, Qifllak dhe Letnice(2020). Duhet përmendur faktin se donacioni i fituar nga komuna e jonë, nga Grandi i performances, nga GlZ-Gjerman dhe Ministria e Planifikimit

Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, po ju kthehet qytetarëve, duke i furnizuar me kontejner familjar 120 L dhe kontejner plastike e të metalta me masë vëllimi prej 1.1 m³. Këta kontejner gjithsej 2855 kontejner familjar dhe 126 kontejner 1.1 m³, u janë shpërndarë klientëve të rinj dhe të vjetër nga njësi i kompanisë Eco-Higjiena, ndërsa kontejnerët 1.1 m³ janë vendosur në disa pika në qytet dhe janë zëvendësuar të dëmtuarit neper shkolla etj.

Deponitë ilegale

Në fillim të vitit raportues janë evidentuar **21 deponi ilegale**, nga dy zyrtaret komunal me përfaqësuesin e GIZ-Gjerman. Gjate kësaj periudhe raportuese DSHPE-ja ka eliminuar gjithsej **17 deponi ilegale** të regjistruara dhe shumë të tjera të cilat kohe pas kohe janë krijuar në vende të caktuara.

Tabela e deponive aktuale për vitin 2020

Nr.	Vendi i deponive	Sasia	Të pastruara	Data e pastrimit	Komuna
1.	Devaj	1			Viti
2.	Drobesh	3	3	04.09.2020 17.09.2020	Viti
3.	Begunce	2	1	22.09.2020	Viti
4.	Radivoje	1	1	02.10.2020	Viti
5.	Skifteraj	1	1	04.08.2020	Viti
6.	Remnik	1	1	21.09.2020	Viti
7.	Stublla e Eperme	1	1	28.09.2020	Viti
8.	Letnice	2	2	17.08.2020 22.09.2020	Viti
9.	Lubishte	1	1	03.08.2020	Viti
10.	Kabash	2	2	06.07.2020	Viti
11.	Sadovin e Jerlive	1	1	17.07.2020	Viti
12.	Sllatin e Ulte	1		02.09.2020	Viti
13.	Sllatin e Eperme	1	1	25.09.2020	Viti
14.	Pozheran	2	1	21.09.2020	Viti
15.	Zhiti	1	1	05.08.2020	Viti
	Totali	21	17	80,95% të pastruara	Deponi

Punët me Skipin e Komunës

Për periudhën raportuese janar - dhjetor janë bërë gjithsej 128 intervenime me skipin e komunës, neper lokalitete të ndryshme të komunës sonë, si: hapja e kanaleve të ndryshme, largimin e borës nga rruga në disa rrugica të qytetit dhe në disa lokalitete rurale, largimin e mbeturinave inerte, varrosjen e kafshëve të ngordhura, mbyllja e rrugëve malore me kërkesë të Drejtorisë së Bujqësisë, rregullimi i hapësirave publike dhe rregullimi i rrugëve nga gërryerjet erosive. Pra, me

skipin e komunës janë kryer punë të ndryshme dhe atë në total 436 orë pune për këtë periudhë raportuese.

2. Sektori i emergjencave

Funksionalizimi i QOEL(Qendra Operative Emergjente Lokale) dhe koordinimi i aktiviteteve me QOMPB gjatë gjendjes emergjente me pandemi COVID-19. Dhënia e 100 lejeve për nevojat e qytetareve për lëvizje në orë policore;

Punët e përditshme administrative;

Takimet me QRAK-pandemia nga 12 mars deri tash;

Bashkëpunimi me NJSHZSH, klorizimi i rrugëve në gjitha lokalitetet, mbi 113 klorizime;

Koordinimi rreth shpërndarjes së ndihmave në kohë të pandemisë me NJPZSH, Kryqi i kuq dhe KKMSH(asistimi me automjete dhe zjarfiksa);

Vlerësimi i dëmeve nga stuhia e erës;

Angazhimi në shuarjen e zjarreve gjatë sezonit veror me NJPZSH.

Njësia profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim(NJPZSH)

NJPZSH në Viti, gjatë kësaj periudhe raportuese i ka kryer me përgjegjësi profesionale të gjitha punët dhe detyrat të cilat me ligje është e obliguar ti kryej. Edhe gjatë kësaj periudhe të Pandemisë, njësiti ka punuar me kapacitete të plota. Me COVID-19 kanë qenë të prekur dy zjarrfiksa dhe dy tjerë kanë pasur kontakt, andaj edhe kanë munguar me arsye në punë. Njësiti ka 8 automjete me të cilët kryen gjitha aktivitetet e saja dhe 26 zjarrfiksa dhe inspektorin e preventives kundër zjarrit.

Intervenimet e NJPZSH në 200 zjarre :

-26 në objekte ndërtimi;

-8 në instalime eklektike;

-156 zjarre të hapura (malore 47, fushore 82 dhe 27 në mbeturina);

-13 aksidente rrugore me 3 raste fataliteti;

- 6 Intervenime në vërshime.

Gjatë periudhës së pandemisë Njësiti i zjarrfikësve vazhdimisht ka bërë klorifikimin e rrugëve në qytet dhe në gjitha vatrat e prekura nga COVID -19.

Inspektori i preventives ndaj zjarrit

Inspektime të përgjithshme 41

· Inspektime në sektorin privat 27

· Inspektime në sektorin publik 14

· Nr. i vërejtjeve169

- Nr. propozim masave.....169

-Shikime në vende ngjarje të zjarreve.....25

-Raporte zjarri për njësitin hetues në polici.....12

-Kërkesa nga palët.....2

Vërtetime zjarri për palët e dëmtuara.....1

Aktivitet tjera

Bashkëpunimi me GIZ-in gjerman në projektin Shërbime të Qëndrueshme Komunale për Grandin e performances si dhe në hartimin e Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2020-2025. Përgatitja e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave, të cilat dokumente edhe janë miratuar në kuvend. Angazhimi i një

pjesë të stafit të Drejtorisë në Komitetin Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim, si dhe në Qendrën Operative Emergjente Komunale, në luftimin e pandemisë COVID-19 nga dt.13.03.2020 e tutje.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale përmes politikave shëndetësore dhe sociale ka krijuar rrethana dhe ka zhvilluar aktivitete shëndetësore në baze të planifikimeve të saja, të cilat janë koordinuar përmes Drejtorisë së QKMF-së, duke krijuar standarde të reja të organizimit të punës dhe kualitetit të shërbimeve shëndetësore përmes projekteve të reja në institucionet tona si dhe përmes QPS-se, dhënien e shërbimeve sociale. Në këtë raport janë të radhitura dhe të përmbledhura të gjitha aktivitetet dhe punët të ushtruara gjatë kësaj periudhe vjetore në QKMF si dhe në QPS.

Punët dhe detyrat e punës në këtë drejtori I kemi kryer në baze të kompetencave ligjore, ku rendësi të veçantë I kemi kushtuar funksionimit në QKMF-QPS me qëllim që të ngritët efikasiteti dhe cilësia e shërbimeve shëndetësore dhe ofrimi I shërbimeve sociale, vlerësimin real dhe kujdesin primar për shëndetësi si prioritet dhe në QPS kryerjen e detyrave sipas planit të punës dhe në përputhshmëri me rrethanat e krijuara për shkak të pandemisë. Përveç detyrave dhe aktiviteteve që I kemi kryer e që do të paraqesim me vone, qëllimi kryesor I Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është përmirësimi I gjendjes së përgjithshme në të gjithë sektorët, si në Shëndetësi ashtu dhe në shërbime sociale që është një domosdoshmëri.

Në sajë të këtyre veprimeve rol të rëndësishëm ju kemi kushtuar përmirësimit të shërbimeve emergjente shëndetësore dhe përgatitjes për sektorin emergjent për situatë emergjente që ka qenë një sfidë që na ka përcejell gjatë tërë vitit pandemia COVID 19. Si drejtoresh i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, kemi koordinuar punën edhe me qendrën për punë sociale, për kujdesin social përmes Qendrës për Punë Sociale dhe kemi ofruar shërbime sociale dhe familjare për të gjitha kategoritë e familjeve të rrezikuara gjithëherë duke u bazuar në ligjet që janë në fuqi nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të gjitha këto aktivitete I kemi të përgatitura dhe do të paraqesim në vijim.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ju ka kushtuar rendësi të veçantë menaxhimit të buxhetit në shëndetësi si dhe të hyrave vetanake, duke përfshirë participimin që behet nga shërbimet shëndetësore. Përpos kësaj cekim dhe bashkëpunimin që kemi pasur me të gjitha drejtoritë në nivel komunal, me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare në shërbim të shëndetësisë dhe shërbimit social.

Organizimi I punës në Sektorin e Shëndetësisë

Drejtoria Komunale e Shëndetësisë përbehet nga disa sektorë të cilët kanë kryer shërbime sipas kërkesave të qytetareve si në aspektin shëndetësor ashtu edhe në atë psikosocial.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ka 10 njësi në territorin e Komunës së Vitisë: Pozheran, Sllatin e Eperme, Smire, Sodovine e Jerlive, Begunce, Skifteraj, Stubell, Terpeze dhe Letnice.

Në QKMF behet ofrimi I shërbimeve mjekësore për qytetare sipas këtyre qendrave:

1. Qendra e Mjekësisë Familjare në Pozheran punohet 24 orë në këtë qendër ofrohen të gjitha shërbimet mjekësore familjare, shërbimet stomatologjike si dhe analiza laboratorike gjatë ndërrimit të pare.
2. Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme ofron shërbime infermierja dhe mjeku gjatë gjithë javës.
3. Në QMF- në fshatin Smire punohet çdo ditë përveç të dielave dhe të shtunave me shërbime nga infermierja si dhe mjeku njëherë në javë.

4. Ne QMF ne Fshatin Sodovin e Jerlive punohet çdo dite përveç vikendit, me shërbime nga infermierja si dhe Mjeku pëse dite ne jave.
5. Ne AMF ne Skifteraj punohet çdo dite me infermiere, ndera shërbimet nga mjeku mund ti marrin tri dite ne jave.
6. Ne AMF ne fshatin Begunce ofrohen shërbime nga infermierja çdo dite si dhe mjeku një here ne jave.
7. Ne AMF ne fshatin Terpeze shërbimet mjekësore ofrohen çdo dite pune nga infermierja ndërsa mjeku tri here ne jave.
8. Ne AMF ne fshatin Stubell e Epërme punohet çdo dite ofrohen shërbime nga infermierja dhe një here ne jave mjeku.
9. Ne AMF ne Letnice shërbimet shëndetësore janë dhënë një here ne jave nga infermierja dhe Mjeku kurse Nëntor dhe Dhjetor s'ka punu fare.

Shërbimet e ofruara ne mënyrë tabelare

DEPARTAMENTET	VIZITAT MJEKËSORE 2020
MJEKËSIA FAMILJARE 1	13474
MJEKËSIA FAMILJARE 2	7287
MJEKËSIA FAMILJARE 3	9089
Infuzione dhe Injeksione	8527
Pediatra	2377
Internisti	679
INTERNISTIKA	875
Gjinekologjia	531
Stomatologjia	2155
Laboratori	97150
Rentgeni	2072
Vaksina	12072
Inhalimi	284
Vizita për nëna dhe fëmijë	8769
Reparti Covid	2231
Gjithsejt shërbime në 2020	329221 shërbime

328.346

Investimet Kapitale në QKMF

- Rënovimi i disa pjesëve të QKMF-së.
- Përrurimi i objektit të rinovuar AMF-së në Remnik, kompletimi me inventar dhe aktivizimi i dhënies së shërbimeve për qytetarë.
- Përrurimi i objektit të ri të QMF-së në Sllatinë të Epërme
- Furnizimi me autoambulanc te re me mjete nga buxheti i komunës
- Është bërë rregullimi i sistemit qendror të oksigjenimit në QKMF-Viti dhe QMF-Pozheran
- Janë rregulluar pjerrinat për personat me aftësi të kufizuara ne ambulancat e fshatrave Sllatinë e Epërme, Sadovinë e Jerlive dhe Skifteraj..
- Ndertimi i AMF-së në Terpezë me bashkëfinancim mes Komunës dhe OJQ-së “Qëndresa Kosovare”, me përkrahje nga Kuvajti, ku punimet janë në përfundim e sipër.

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

- Edhe këtë vit ka vazhduar edukimi i vazhdueshëm profesional për mjekë dhe infermierë ku gjatë kësaj periudhe punëtorët shëndetësor kanë qenë pjesë e trajnimeve të organizuara në Viti ne kuadër te ZHVP-së si dhe trajnimeve në bashkëpunim me KFOR LMT 20, ekipi i paramedikeve.
- Gjithashtu, në muajin tetor janë mbajtur trajnimet me KFOR-in Amerikan, ku pjesë e trajnimit kanë qenë 60 punëtorë shëndetësor të QKMF-së në Viti.
- Mjekë tanë kanë qenë pjesë e organizimit të trajnimeve virtuale që janë organizuar nga UNDP, Unicef dhe MSH.

Menaxhimi me pandeminë COVID-19

- Rasti i parë me COVID-19 është paraqitur ne Viti me 13 mars.
- Gjatë këtij viti, puna në QKMF ka qenë me sfida të mëdha për stafin shëndetësor pasi që në çdo moment kanë qenë të rrezikuar nga virusi që nga 13 marsi kur për herë të parë është paraqitur pacienti zero me virusin SARS COV2, i cili është identifikuar si i dyshimtë në QKMF, në repartin e emergjencës si pacienti i parë në Republikën e Kosovës.
- Gjithashtu, prej 13 marsit jemi detyruar që t'i vetizolojmë 17 punëtorë shëndetësorë për 15 ditë, të cilët ishin në kontakt me pacientin e identifikuar me Covid-19, mostrat e të cilëve për fat të mirë rezultuan negative.
- Kemi kontaktuar FSK-në dhe menjëherë është vendosur tenda nga FSK në oborrin e QKMF-së në Viti dhe QMF në Pozheran
- Me 15.03.2020 janë diagnostifikuar 6 persona me COVID-19 nga Stublla.
- Janë vendosur tunele dezinfektuese para QKMF-së në Viti dhe QMF ne Pozheran nga donatorët

- Kemi intervenuar në blerjen e barnave dhe materialit shpenzues mjekësor pasi që nuk kemi pasur furnizim të mjaftueshëm nga lista esenciale nga Ministria e Shëndetësisë.
- Kemi ndarë hapësirat për trajtimin e pacientëve me COVID-19 në QKMF-Viti dhe QMF-Pozheran, ku në këto hapësira janë trajtuar vetëm pacientët e dyshuar dhe konfirmuar me COVID.
- Kemi aktivizuar personelin shëndetësorë të cilët janë marrë tere kohës vetëm me pacientët me COVID.
- Kemi vendosur 2 Oksigjen Koncentrator në hapësirën për COVID-19, kemi furnizuar ekipet me pulsoksimetra si dhe me pajisje mbrojtëse tërë kohën..

Rastet e testuara për Covid-19 në Komunen e Vitisë prej 13.03.2020								31.12.2020
Vendbanimet	Aktive	Pozitive	E shëruara	Vdekje	Spital	Izoluara	Negative	Testimet
Stubëll	0	17	16		0			
Pozheran	0	106	98		0			
Ramjan	4	32	28		1			
Skifteraj	1	60	57		0			
Smirë	2	76	71		2			
Viti	1	168	162		0			
Goshicë	1	22	21		0			
Zhiti	0	18	16		0			
Vërban	0	34	32		0			
Beguncë	2	29	26		0			
Sllatinë e Ep.	2	52	47		1			
Remnik	0	13	12		0			
Sllatinë e Po.	0	15	14		0			
Tërstenik	0	12	10		0			
Kabash	3	58	53		0			
Tërpezë	2	50	46		0			
Buzovik	0	5	5		0			
Radivojcë	3	30	27		1			
Çifllak	0	3	3		0			
Sadovinë e Je.	0	19	18		0			
Gërmovë	1	8	7		0			
Devajë	0	6	5		0			
Drobesh	0	11	11		0			
Fshati I ri	0	16	15		0			
Lubishtë	0	17	14		0			
Sad. e Muhaxherve	0	20	18		0			
Budrikë	2	27	25		0			
Ramnishtë	1	11	9		0			

Ballancë	0	7	6	1	0			
Shushtë	0	2	2	0	0			
Letnicë	0	1	1	0	0			
Binqe	1	2	1	0	1			
Podgore	0	1	1	0	0			
Nr. TOTAL	26	948	877	45	6	126	1172	2120
	Aktive	Pozitive	Shëruar	Vdekje	Spital	te izoluar	Negative	Testimet

Trajtimi i pacientëve me COVID-19 deri me datë 30.12.2020

Pacientë të konfirmuar me COVID-19

945

Pacientë të shëruar nga COVID-19

876

VIZITAT MJEKESORE

1920

Pacientë të vdekur me COVID-19

45

Punëtorë të QKMF-së të konfirmuar me COVID-19

2

Punëtorë të QKMF-së të vdekur nga COVID-19

2231

INFUZIONET injeksione

Gjithsejt shërbime për pacientët me COVID-19

4151

PERSONELI I INFEKTUAR ME COVID-19

MJEK	10
INFERMIER	17
STAF MBESHTETES	5
KARITAS	6
GJITHSEJ	38

Donacionet

QKMF ne Viti është nga buxheti komunal ku jemi furnizuar me pajisje mjekësore te ndryshme, ndërsa një ndihme shume e madhe është siguruar nga donator te ndryshëm vendor dhe ndërkombëtar.

Shërbimet shëndetësore ne QKMF,QMF dhe AMF-te

RAPORT DYMBDHJET MUJOR

JANAR - DHJETOR 2020

Repartet	Vizita	Therje	Infuzione	Transfer	Transf Diag	Lidhje	Inhalime	Këshilla	Ekg	Nr. Analizav	Ndrrim I kat	Me. Nxejme	Pagesa	Lnga Page
Emergjencia	34896	21113	9207	3317		1355				787			8197.5	2896
Mjeksi Familjare 1	13477	8324		2467									4317	1540
Mjeksi Familjare 2	7287			1259									1383	537
Mjeksi Familjare 3	9039			316									393	343
Stomatologjia	2155													
RTG	2057											679	161	204
Dhoma e Inf Covid	802		2231										2191	148
Dhoma e Infuzioneve			2203											223
Laboratori	8050									97150			489	171
Pediatr	2377			31	82			151					4154	632
Interno	672									333		238	294	58
Ekipa e terentit Caritas	179	395	138			47						108		83
Ekipa e terentit QKMF	361	194	602			31								88
Kontrolla Gjinekologjike	531	176		12									456	78
Vizita per nene dhe femijen	617													56
Sherbimi i Vaksinit	6623	12072						205						667
Inhalime ne QKMF Viti							284							21
Lidhtorja						1752							86	177
TOTALI	89183	40279	14381	8402	82	3685	284	356	1120	97150	346	679	22621.5	8231
NUMRI I VIZITAVE NE AMBULLANTAT E QENDRES KRYESORE TE MJEKSISE PRIMARE														
Amb. Smire	222	179	29	1		75		346					21	84
Amb. Sadovin	384	442				165	3	160					166	61
Amb. Silatin	434	480	133	8		115	10	39					165	101
Amb. Pozheran	30541	14132	6700	4438		1520	5	6	306				7843.5	2351
Laboratori Pozheran	3559									34797			1551	30
Stomatologjia pozheran	526											243	110.5	41
Amb. Terpez	223	227	15			148	24	175					30	81
Amb. Gjylekar	177	260	25	19		44		153					37	61
Amb. Begunce	32	150	24			158	6	134					15	51
Amb. Remink	45	23	9			2		12					7	11
Amb. Letnic	15	1												
Amb. Stubell	1162	373				120	14	100					18	13
TOTALI	37316	16267	6935	4466		2347	62	1125	306	34797	0	243	9964	331
	89183	40279	14381	8402	82	3685	284	356	1120	97150	346	679	22621.5	8231
	37316	1627	3935	4466		2347	62	1125	306	34797		243	9946	331
GJITHSEJ TOTALI	126499	41906	18316	12868	82	6032	346	1481	1426	131947	346	922		
GJITHSEJ SHERBIME 329221													32567.5	1154
Raporte Statestikore														

Pasqyra financiare e grumbullimi të mjeteve për periudhën 01.01.2020 deri me 31.12.2020

Shërbimi	Janar	shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	gjitheshej
Energjenc	907.5	1548	837.5	161		712.5	601	282	732	825	822	1565	8993.5
Arka 1	2277.6	2390.1	1212.8	308.8		1059.2	912.1	914.6	1437.8	2157.7	1257.4	1481.4	15409.5
Pozhorani	1401	1405.5	982	221.5		1004.5	718.5	594.5	836.5	689.5	702	1364.5	9920
Gjylekarë												38	38
Tërpeza												30	30
Smirë												24	24
Zhiti													
Sllatinë							67					128	195
Remnik												10	10
Beguncë												14	14
Sod, Jerlive									62		65	43	170
Goshicë													
Letnicë													
Stubell e Ep												18	18
	4586.1	5343.6	3032.3	691.3	0	2776.2	2298.6	1791.1	3068.3	3672.2	2846.4	4715.9	34821

Shërbimi Social

Veprimtaria e Qendrës për Pune Sociale në Viti, ofron përkujdesjen e mirëqenies sociale për banoret e komunës si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror, përmes ofrimit dhe zbatimit të konceptit të punës sociale dhe mirëqenies sociale në kuadër të sistemit unik të përkujdesjes në Komunën e Vitisë.

Koncepti i përkujdesjes sociale konsiston në atë që banorëve të komunës sonë t'ju ofroj përkujdesje dhe mirëqenies sociale, këshillime gjithëpërfshirëse dhe efikasë në të dhëna shoqërore përmes eksperteve profesional të cilët për rastet në nevojë sociale do të jenë të domosdoshme në sistemin e përkujdesjes sociale. Përkujdesja dhe mirëqenia sociale në QPS sigurohet dhe zbatohet nga zyrtarët e shërbimeve sociale të cilët i plotësojnë kriteret e parapara në dispozitat ligjore.

Kategoritë e shërbimeve sipas rasteve, gjithsej raste të trajtuara dhe shërbime të ofruara gjatë një viti janë 675.00 raste.

Kompensimi për strehimin familjar tek të afërmit, pagesa për strehimin familjar tek familja strehuese dhe pagesa për fëmijët me nevojë të veçanta gjithsej janë 67,850.00.

Shërbimet e asistencës

Pasqyra e pagesave nga shërbimi i asistencës			
Nr.	Muaji	Numri familjeve	Pagesa mujore
1.	Janar	452	48.792.50 €
2.	Shkurt	458	49.790.00 €
3.	Mars	441	48.642.00 € -
4.	Prill	461	100.395.00 €
5.	Maj	465	100.097.50 €
6.	Qershor	458	50.010.00 €
7.	Korrik	467	51.062.00 €
8.	Gusht	475	51.520.00 €
9.	Shtator	470	50.522.50 €
10.	Tetor	473	101.847.50
11.	nëntor	486	104.672.50
12.	Dhjetor	497	106.950.00
gjithsej			864.291.50 €

Shuma e mjeteve të paguara nga DPSF - MPMS për të gjitha kategoritë në nevojë për shërbime nga QPS-viti

Shërbime sociale	67,850.00
Asistencë	864.291.50 €
Gjithsej	932.141.50 €

Kërkesat e aplikantve për pakon 15

Të aprovuara	Të refuzuara	Të suspenduara	Lëndë me gabime	gjithsej
826	825	50	86	1.787

Shuma e mjeteve të paguara 32.2140.00

RAPORTI FINANCAR

Të hyrat vetanake financiare nga taksat komunale në QPS:

Të inkasuara	Të dorëzuara	Gjithsej
2596,00 €	2596,00 €	2596,00 €

Drejtoria për Arsim

Në Komunën e Vitisë procesi mësimor zhvillohet që nga çerdhjet, parashkollorët, mësimi i ulët i mesëm dhe ai i lartë mesëm dhe ai i mesëm profesional. Gjatë kësaj periudhe deri më 11 mars 2020, mësimi është zhvilluar normalisht. Qeveria e Kosovës në përputhje me rekomandimet e IKPSH-së dhe në bashkëpunim me MASHT-in marrin masa përkatëse me rastin e shfaqjes së rasteve të para të Covid 19 në Kosovë. Sipas udhëzimeve të lëshuara nga Qeveria e Kosovës dhe MASHT kanë pezulluar mësimin e rregullt dhe njëkohësisht brenda javës kanë dalë me vendim që procesi mësimor online të fillojë më 23 mars në distancë përmes Televizionit publik RTK i cili vazhdoi sipas kalendarit shkollor 2019/2020 për ciklin e shkollës së mesme të ulët pra klasat 1-9. Kjo gjë ka ndodhur njësoj si edhe në komunat e tjera në Kosovë. Ne kemi filluar me kohë planin e veprimit për aktivizim të shkollave për fillimin e mësimin online përmes platformave të ndryshme sidomos atyre të propozuara nga MASHT-i. Që nga evidentimi i rasteve pozitive me virusin Covid 19, të gjitha aktivitetet e punës kanë kaluar online, me anë të platformave si ZOOM, Google Meet, WhatsApp, Viber, Facebook dhe shumë të tjera me qëllim që të mbahet kontakti virtual mësimdhënës-nxënës etj. duke përfshirë edhe:

- Ligjëratat me nxënës, përcaktimi i orarit mësimor shkollor, raportimet pas ligjëratave në TV.
- Ligjëratat ku në fokus kanë qenë temat për menaxhimin e kohës në izolim, menaxhimin e ankthit, depresionit, stresit etj nga ana e psikologëve shkollorë.
- Seanca me nxënës me nevoja të veçanta dhe me prindër për shqyrtime dhe ankesa për organizim më të mirë të mësimin.
- Me mësimdhënës për trajnime teknologjike që janë organizuar nga ana e DKA-së dhe grupe të mësimdhënësve.
- Zhvillimi i takimeve online me MASHT-in.
- Trajnime me organizata të ndryshme.
- Mbajtja e kontakteve në mes të DKA-së dhe MASHT-it.
- Raportimet dhe takime të rregullta me drejtorët e shkollave dhe DKA.
- Raportimet e rregullta të DKA-MASHT dhe Inspektoratit arsimor.

1. Mësimi në distancë

- Pas vendimit të qeverisë për ndërprerjen e mësimin për shkak të pandemisë, DKA-ja në bazë të udhëzimeve të MASHT-it ka organizuar mësimin online në të gjitha shkollat duke filluar në disa shkolla me herët se sa vendimet e Masht-it.
- Janë kontrolluar të gjitha shkollat në aspektin profesional pedagogjik si dhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm.
- DKA-ja ka bërë parapërgatitjet për Testin e Arritshmërisë për klasat e IX-ta dhe për Testin e Maturës Shtetërore për klasat e XII-ta.
- Kemi dërguar në MASHT, shënime statistikore përmes Sistemit të SMIA-së, për nr. nxënësve sipas paraleleve në secilën shkollë, numri i personelit arsimor etj.
- DKA-ja, ka shtuar aktivitetet për ngritjen e interesimit të nxënësve për testet e Arritshmërisë dhe Maturës Shtetërore, duke i njoftuar nxënësit për mënyrën e plotësimit të testit, për fushat e dijes në cilat do të testohen etj.
- Po ashtu arsimtarët e fushave të ndryshme me qëllim të ngritjes së tyre profesionale kanë marrë pjesë në trajnime .Seminare. Debate etj.
- Janë mbajtur debate .konsulta për tema të ndryshme rreth dukurive negative të nxënësve nëpër shkolla.

- Në mënyrë të rregullt kemi përcjell procesin mësimor në vazhdimësi.
- Është bërë dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore nga dy herë brenda vitit.

2. Përfundimi i vitit shkollor

- Komuna e Vitisë me gjithsejtë 17 shkolla fillore te mesme të ulëta si dhe 18 paralele të ndara. 3 shkolla të mesme të larta e dy çerdhe për fëmijë, njëra private ka gjithsejtë 8123 nxënës duke përfshirë edhe çerdhet.
- Me vendim të MASHT-it mësimi ka filluar në distancë TV më 23 mars si dhe online përmes platformave digjitale nëpër shkolla dhe disa shkolla edhe më herët se kjo datë në komunën e Vitisë dhe është realizuar plani pothuajse në tërësi.
- DKA-ja ka organizuar mësimin në distancë si dhe online në të gjitha shkollat e komunës së Vitisë duke përfshirë të gjithë nxënësit me rreth 93% e nxënësve që janë përfshirë në mësimin online.
- Viti shkollor 2019/20 apo gjysmë-vjetori dytë, periudha e tretë është përfunduar në të gjitha shkollat me data të parapara nga kalendar i MASHT-i për këtë vit shkollor, të gjithë nxënësit janë notuar, raportet e mësimdhënësve janë dorëzuar në shkollat ku punojnë dhe të gjitha punët janë kryer duke ju përmbajtur udhëzimeve administrative të nxjerra nga MASHT-i për organizimin e mësimin online, në distancë, si dhe për përfundimin e vitit shkollor 2019/20.

3. Regjistrimet dhe testimet

Sipas UA të Masht-it Nr. 22/13 dhe kalendarit të përshtatur 2019/2020 regjistrimi për klasat e e para është kryer në afatet prej datës 22.06.2020- 10.07.2020.

Testi i arritshmërisë për klasat e nënta i anuluar me vendim të MASHT-it dhe nxënësit janë regjistruar në bazë të suksesit dhe notimit në shkollë më datë 06.08.2020 dhe menjëherë u janë shpërndarë dëftesat. Regjistrimet në shkollë të mesme të lartë janë bërë nga data 17.08.2020- 21.08.2020 (Numri i nxënësve të regjistruar në këto afate janë të paraqitura në tabelë). Gjithsej në klasën e X këtë vit janë regjistruar 555 nxënës të rinj. Të regjistruar për herë të parë në klasën e parë janë 614 nxënës. Ndërsa numri total i nxënësve në shkolla të mesme të ulëta është 5941 nxënës, në shkollat e mesme të larta 1715 nxënës. Numri i nxënësve nëpër shkolla dhe paralele i gjeni në tabelën e mëposhtme.

Shkollta	Vendi	Parashkollor	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Klasa 4	Klasa 5	Klasa 6	Klasa 7	Klasa 8	Klasa 9	Gjithsej
		Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej	Gjithsej
Hajren Terpeza	Terpeza	14	21	15	15	20		21	26	21	24	202
Kenan Halimi	Gjithsej	16	35	27	18	21		18	29	23	35	246
Ahmet Hajdari	Beqirce	7	15	6	13	14		12	14	13	22	135
Dezhmoret e Lubichies	Lubichie	20	24	16	14	16		22	18	20	12	185
Dezhmoret e Lubichies i 1	Busovik	0	5	6	9	9		6	14	8	4	68
Dezhmoret e Lubichies i 2	Podgorje	0	3	2	7	2		0	0	0	0	14
Njazi Reshepi	Shkollja e re	30	20	15	21	20		32	24	23	33	253
Njazi Reshepi i 1		0	14	15	16	10		9	10	13	11	112
Njazi Reshepi i 2		19	13	10	17	9		16	12	16	18	147
Njazi Reshepi i 3		10	9	16	14	14		0	0	0	0	76
Njazi Reshepi i 4		10	4	12	8	8		23	10	19	19	130
Ndre Mjeda	Kabash	0	24	27	24	18		32	47	21	42	266
Ndre Mjeda i 1	Debuldeh	0	0	1	2	2		1	0	3	4	16
Ndre Mjeda i 2	Binj	0	2	3	3	0		0	0	0	0	8
Dezhmoret e 5 Prillit	Smire	26	38	31	37	43		44	43	36	62	365
Don Mikel Tarabulluzi	Stubbell	7	6	10	8	6		13	9	15	8	98
Don Mikel Tarabulluzi i 1	Letnice	0	5	0	0	3		0	0	0	0	13
Safet Reshepi	Zhuti	10	12	4	11	10		4	8	6	7	72
Safet Reshepi i 1	Ballanc	0	0	11	0	11		6	5	9	11	67
Skender Emerllahu	Ramjan	10	17	11	12	19		25	14	20	24	162
Skender Emerllahu i 1	Novoselle	10	14	10	9	0		0	0	0	0	43
Balti Haxhiu	Viti	45	74	49	53	70		66	70	80	72	686
Balti Haxhiu i 1	Ramniste	12	22	13	15	21		11	14	8	24	163
Nazmi Pajaziti	Radivoje	20	23	18	25	17		21	21	16	28	202
Nazmi Pajaziti i 1	Busrike	10	12	11	5	7		10	8	10	8	90
Nazmi Pajaziti i 2	Devaje	0	0	4	2	2		0	0	0	0	10
Hasan Alla	Remnik	22	16	25	22	10		10	22	16	12	175
Mirali Sejdu	Goshic	10	8	8	13	11		9	13	13	16	111
Mirali Sejdu i 1	Germova	10	10	5	16	16		6	9	8	10	103
Halit Aldema	Pozhoran	37	50	35	60	47		43	44	41	64	464
Dezhmoret e Vitis	Viti	33	59	56	48	48		101	103	73	79	646
Dezhmoret e Vitis i 1	Drobesh	18	27	30	20	22		0	0	0	0	156
28 Nentori	Verban	22	22	26	27	29		28	14	32	33	287
28 Nentori i 1	Sodovine e re	10	10	20	17	16		22	18	16	25	161
Gjithsej		453	614	548	611	530	617	611	619	530	633	5341

Tabela 1-Numri i nxënësve në SHMU-të në komunën e Vitisë sipas shkollave.

SHKOLLA	Drejtimi	Vendi	Numri i nxënësve			Gjithsej
			Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	
Kuvendi i Lezhës	Gjimnazi	Viti	315	309	326	950
“Jonuz Zejnullahu”	Profesionale	Viti	165	188	185	538
Kongresi i Manastirit	Mikse (Gjimnaz, Profesionale)	Pozhoran	75	61	91	227
			555	558	602	1715

Tabela 2- Numri i nxënësve në SHML –të e komunës së Vitisë sipas shkollave.

Maturantët iu nënshtruan testit të maturës edhe në komunën tonë nën masa të rrepta në mbrojtje kundër Covid-19. Afati i parë i testimit është mbajtur më 29.08.2020 ndërsa afati i dytë është mbajtur më 10.10.2020. Në afatin e parë iu janë nënshtruar 660 maturantë, prej tyre me sukses e kaluan 612 maturantë, apo 78% dhe në afatin e dytë iu janë nënshtruar 120 maturantë, prej tyre testin e kanë kaluar 88 maturantë, apo 68%. Në të dy afatet duke u bazuar se kemi pasur gjithsej 660 maturantë, kalueshmëria është 600 maturantë, apo 91% e tyre.

4. Udhëzimet për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021

Sipas manuali të dalë nga MASHT-i ne kushtet e pandemisë procesi mësimor mund të zhvillohet në tre skenar, gjithnjë sipas kushteve që ofrojnë shkollat në lidhje me hapësirat dhe në përputhje me kriteret e manualit:

- Skenari A (mësimi në objekte shkollare/ orar të shkurtuar me grupe deri 20 nxënës)
- Skenari B (Mësim i kombinuar dy ditë në shkollë dhe tri ditë mësim në distancë-Online)
- Skenari C (mësim në distancë-online)

Me datë 11.09.2020 Ministria e Arsimit shkencës dhe Teknologjisë ka nxjerr një vendim për fillimin e vitit ri shkollor 2020-2021. Pra vendimi me nr-01B-101 citon se: Fillimi i vitit të ri shkollor 2020/21 në kushte të pandemisë Covid-19, do të organizohet në dy faza:

- **Faza parë** fillon me 14 Shtator me profilet e klasave të mësimi të ciklit ulët:

Klasa I,II,III,VI

Mësimi në ciklin e lartë klasa X

- **Faza e dytë** fillon me 21 Shtator me profilet e klasave të ciklit të ulët:

Klasa e VII,VIII dhe IX

Mësimi në ciklin e lartë klasa XI dhe XII

5. Fillimi i vitit të ri shkollor

Drejtorja e Arsimit në Komunën e Viti-së gjatë periudhës së pushimit veror të shkollave ka bërë përgatitjen e objekteve shkollor duke intervenuar në infrastrukturë dhe renovime të tyre, ku ka pasur nevojë më qëllim të ofrimit të kushteve sa më të mira për fillimin e vitit të ri shkollor. Duke u bazuar në vendimin e MASHT-it DKA i ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e mësimi sipas vendimit dhe manualit të lartë cekur dhe kriterëve të IKSHPK-së. Që në fillim janë dezinfektuar të gjitha objektet shkollore, furnizimi me material higjienik, dezinfektues, maska mbrojtëse, aparate për matjen temperaturës për të gjitha shkollat.

Tabela 3-Paraqitja tabelore e fillimit të vitit shkollor 2020/21 sipas fazave dhe rrjedhshmëria e zhvillimeve të mësimi sipas skenarëve A,B dhe C dhe Mësimdhënësit e prekur me Covid -19.

	Emri i shkollës	Vendi	Fillimi i mësimi ne shkollë 14.11.2020	Fillimi i mësimi ne shkollë 21.11.2021	Mësimi online klasa	Komplet shkolla online	Mësimdh. që kanë qene te izoluar	Mësimdh. që kanë qene me covid-19	Numri i nxënësve të prekur me Covid 19.
1	"Dëshmorët e Vitisë"	Viti	Kl. 1 deri 9		1	Kl.6 deri 9 -2 javë	1	10	5
2	"Bafti Haxhiu"	Viti	Kl. 1 deri 6	7,8,9	6	Kl.1 deri 9 -2 javë	1	8	2
3	"Nijazi Rexhepi"		Kl. 1 deri9		1		4	7	2
4	"Halil Alidema"	Pozheran	Kl. 1 deri 6	7,8,9	0		0	11	
5	"28 Nëntori"	Vërban	Kl. 1 deri 6	7,8,9	0		0	2	

6	"Dëshmorët e 5 prillit"	Smirë	Kl. 1 deri 7	8,9	3	2	5	4
7	"Ndre Mjeda"	Kabash	Kl. 1 deri 9		0	0	0	
8	"Kenan Halimi"	Skifteraj	Kl. 1 deri 9		0	1	5	
9	"Nazmi Pajaziti"	Radivoje	Kl. 1 deri 9		2	0	5	
10	"Dëshmorët e Lubishtës"	Lubishtë	Kl. 1 deri 9		0	1	1	
11	"Hysen Terpeza"	Terpezë	Kl. 1 deri 6	7,8,9	0	0	3	
12	"Hasan Alia"	Remnik	Kl. 1 deri 9		0	0	2	
13	"Skender Emerllahu"	Ramjan	Kl. 1 deri 6	7,8,9	0	1	3	
14	"Mirali Sejdiu"	Goshicë	Kl. 1 deri 9		1	1	2	1
15	"Ahmet Hajdari"	Beguncë	Kl. 1 deri 6	7,8,9	0	0	1	
16	"Safet Rexhepi"	Zhiti	Kl. 1 deri 9		0	Kl. 1 deri 9 -2 javë	1	9
17	"Dom Mikel Tarabulluzi"	Stubëll	Kl. 1 deri 9		0	0	1	

6. Çerdhe

1	"Gëzimi Ynë"	Viti	01.09.2020		2 javë komplet çerdhja	1	9	
---	--------------	------	------------	--	------------------------	---	---	--

7. Shkollat e mesme të larta

1	"Kuvendi i Lezhës"	Viti	Kl 10	Kl. 11,12	6	1	12	10
2	"Januz Zejnullahu"	Viti	Kl. 10	Kl. 11,12	0	5	5	2
3	"Kongresi i Manastirit"	Pozheran	Kl. 10	Kl. 11,12	1	1	2	1

Gjithsej				21		21	103	27
----------	--	--	--	----	--	----	-----	----

Tabela 4. Suksesë e arritur gjatë periudhës së parë 2020/21 për çdo shkollë dhe paralele-Cikli i Ulet

	Emri i shkollës	Vendi	Parafillorë	KL. I	KL. II	K. L. III	KL. IV	KL. V	P	N	X	KL. VI	KL. VI I	KL. VII I	KL. IX	P	N	X
1	"Dëshmorët e Vitisë"	Viti	4.1	4.6	<u>4.7</u>	4.4	4.5	4.2	396	0	0	3.3	3.2	3.9	2.8	238	122	1
2	"Bafti Haxhiu"	Viti	4.3	4.5	<u>4.1</u>	4.2	4.1	3.7	437	4	1	3.7	3.9	3.9	3.8	301	42	0
3	"Njazi Rexhepi"	Sllatinë	4.2	4.5	<u>4.5</u>	4.3	4.2	4.1	347	0	0	3.7	3.8	3.6	3.7	239	49	1
4	"Halil Alidema"	Pozheran	4.5	4.7	<u>4.8</u>	4.3	4.5	4.3	236	0	0	4.7	3.8	3.9	3.8	195	5	0
5	"28 Nëntori"	Vërban	4.3	4.5	<u>4.1</u>	4.3	4.2	4.1	197	0	0	3.3	3.8	3.5	3.8	138	57	0
6	"Dëshmorët e 5 prillit"	Smirë	4.6	4.6	<u>4.4</u>	4.3	4.3	4.5	175	0	0	4.2	4.1	3.9	3.9	163	12	0
7	"Ndre Mjeda"	Kabash	4.8	4.6	<u>4.1</u>	4.4	4.4	4.3	128	0	0	3.5	3	3.4	3.4	103	43	0
8	"Kenan Halimi"	Skiftëraj	5	4.5	<u>4.6</u>	4.3	4.6	4.4	123	0	0	4.1	4	4.1	4.2	96	9	0
9	"Nazmi Pajaziti"	Radivoje	5	4.9	<u>4.7</u>	4.3	4.6	4.9	155	0	0	4	4.3	3.8	4	117	0	0
10	"Dëshmorët e Lubishtës"	Lubishtë	4.2	4.1	<u>3.9</u>	4.1	4.6	4.1	143	0	0	3.4	3.4	3.3	3.2	90	8	0
11	"Hysen Terpeza"	Terpezë	4.5	4.4	<u>4.5</u>	3.6	4.5	4.4	99	1	0	4	3.3	3.6	3.7	85	6	0
12	"Hasan Alia"	Remnik	4.4	4.6	<u>4.5</u>	4	4.5	4.4	89	0	1	3.6	4	3.5	4	56	2	0
13	"Skender Emerllahu"	Ramjan	4.7	4.9	<u>4.6</u>	4.1	4.3	4.8	117	0	0	4.13	3.7	3.3	4.1	68	2	0
14	"Mirali Sejdiu"	Goshicë	4.6	4.5	<u>4.6</u>	4.4	4.3	4.2	106	0	0	3.9	4	3.6	3.6	66	17	0
15	"Ahmet Hajdari"	Beguncë	4.8	4.2	<u>4</u>	4	4.4	3.4	48	3	0	3.7	3.5	3.3	3.6	50	14	0
16	"Safet Rexhepi"	Zhiti	4.3	4.5	<u>4.1</u>	4.3	4.2	4.1	197	0	0	3.3	3.8	3.5	3.8	138	58	0
17	"Dom Mikel Tarabulluzi"	Stubëll	4	4.2	<u>4.5</u>	4.1	4.2	4.5	55	0	1	2.7	4.2	4	4.5	42	3	0
	Gjithsej								3048	8	3					2185	449	
	Mesatarja		4.5	4.5	<u>4.4</u>	4.2	4.4	4.3				3.7	3.8	3.7	3.8			

Tabela 5. Suksesi i arritur gjatë periudhës së parë 2020/21 për çdo shkollë dhe paralele-Cikli i Lartë

	Shkollat e mesme të larta		Klasa 10	P	N	X	Klasa 11	P	N	X	Klasa 12	P	N	X
1	"Kuvendi i Lezhës"	Viti	3.4	203	107	1	3.4	215	89	0	3.4	218	103	0
2	"Januz Zejnullahu"	Viti	2.5	36	128	0	2.5	75	86	0	2.5	76	99	0
3	"Kongresi i Manastirit"	Pozheran	3.7	64	10	0	3.5	39	22	0	3.5	56	23	3

Aktivitetet në shkolla të ndryshme gjatë periudhës janar-dhjetor 2020

Tabela 6. Aktivitetet përmes garave dhe projekteve të ndryshme

	Lloji i aktivitetit	Shkolla	Vërejtje
1	Garë e diturisë për Ditën e Pavarësisë "17 shkurt"	SHFMU "Nijazi Rexhepi" Sllatinë	Garë brenda/shkollore
2	Projekti me i mire në fushën e kodimit-organizuar nga British Council/ Projekti "Shkollat e shekullit 21" Vendi i parë	SHFMU "Dëshmoret e Vitisë" -Viti	11 mars
3	ASSET dhe me partneritet IPKO-n organizuan "Sfidën e dizajnit 2020", ku 22 shkolla dorëzuan 55 projekte, dhe nxënësit e gjimnazit morën dy çmime.	Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës" Viti	21 prill
4	U realizua dhe u mbajt "Panairi Inovativ 2020" me punime të nxënësve në fushën e elektronikës. Më pas do të marrin pjesë në gara në nivel vendi.	Shkolla e Mesme Teknike Profesionale "Jonuz Zejnullahu" Viti	5 mars
5	U organizua finalja e futbollit të vogël për nder të ditës së mësuesit "7 Mars" ku fitues doli shkolla Sh.m.t.p."Jonuz Zejnullahu"	Shkolla e Mesme Teknike Profesionale "Jonuz Zejnullahu" Viti	6 mars
6	Pjesëmarrje ne gara të Esësë ne nivel Republikan. Tema "Përzgjedhja e karrierës-sfidat dhe mundësitë" Vendi i parë për esenë më të mirë.	Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës" Viti	Maj 2020.
7	Orë e madhe letrare- organizuar nga Shoqata e shkrimtarëve të Komunës së Vitisë me nxënësit e shkollës!	SHFMU "Skender Emërllahu" Ramjan	13 shkurt.
8	Dita e shkollës dhe përrurimi i bibliotekës së financuar nga Korpusi Amerikan i Paqes, në vlerë prej 3500 eurosh.	SHFMU "Skender Emërllahu" Ramjan	11 mars
9	U shënuar dita e mjedisit, ku mësimmhënësit me disa nxënës rregulluan dhe vendosën disa dizajne brenda ambientit shkollor si mesazh vetëdijesimi	SHFMU "Dëshmoret e Vitisë" Viti	5 qershor
10	Gara e diturisë për nder të ditës së mësuesit në lëndën e Kimisë, brenda klasëve në shkollë.	SHFMU "Dëshmoret e 5 prillit" Smirë.	7 mars
11	Vendi i tretë për nivelin 1-5 në nivel republikan në garat e Robotikës KML.	SHFMU "Dëshmoret e Vitisë" Viti	Qershor 2020

12	“Dhëmbët kërkojnë kujdës”, kontrollë e dhëmbëve me nxënësit e klasave të katërta, ofruar nga QKMF Viti.	SHFMU “Halil Alidema” Pozheran	26.Mars
13	Garë për esenë më të mirë shkollore për nderë të ditës së mësuesit	SHFMU “Halil Alidema” Pozheran	8 mars
14	U shënuar dita e tokës përmes punimeve të nxënësve dhe dita botërore e librit	SHFMU “Halil Alidema” Pozheran	22 prill dhe 23 prill
15	Orë e madhe letrare të organizuar nga shkolla dhe Unioni i Shkrimtarëve shqiptarëve me drejtor Reshat Sahitaj, ku 3 nxënës të kësaj shkolle u vlerësuan për esenë më të mirë për të vazhduar tutje në nivel vendi.	Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës” Viti	Mars
16	Më 7 mars DKA në bashkëpunim m sindikatën e arsimit organizuan mbrëmje festive dhe darkë për mësime të mësuesit e komunës së Vitisë, me ç’rast u shpërndanë edhe mirënjohje për mësime të dalluar për 2019/2020. Për të gjithë mësime të DKA ka dhuruar dhurata modeste për të gjithë mësime të/		7 mars
17	Ligjërata dhe debate virtuale përmes platformës ZOOM ndërmjet LMT-Trupave të KFOR it Amerikan në kampin Bondsteel me nxënës dhe klasa të ndryshme dhe me tema aktuale në shumë shkolla të Vitisë të organizuar nga DKA dhe disa mësime të gjuhës angleze në shkollat fillore të mesme të ulëta.	“Dëshmorët e Vitisë” “Skënder Emërllahu” “Dëshmorët e Lubishtës” dhe “Halil Alidema”	24 prill deri 24 qershor
18	Trajnimi i nxënësve (5 nx.nga SH.M.P”Januz Zejnullahu” dhe 5 nx.nga Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës”) organizuar nga organizata IOM në bashkëpunim me MPB dhe MASH, me temën “Parandalimi dhe Ri integrimi”		09.12.2020 deri 11.12.2020

8. Shërbimi psikologjik

- Është bërë evidentimi i rasteve (nxënësve), të cilët kanë nevojë për shërbim psikologjik
- Vazhdim i psikoedukimit me nxënës, duke përfshirë fusha të ndryshme
- Administrimi i testeve psikologjike, duke përfshirë ata të inteligjencës, personalitetit, organicitetit etj.(HTP test, Mini School test, Unit test, Bender Gestalt test 1, Bender Gestalt 2, Kohchs test, Raven test, Vineland scale, EPI test, MMPI 201 test etj.)
- Mbajtja e seancave psikoterapeutike. Nxënësit janë trajtuar me: Këshillim psikologjik, teknika biheviorale, psikoterapi pozitive, psikoterapi trupore, psikoterapi familjare pozitive
- Punë e vazhdueshme tek klasa e bashkëngjitur me nxënës me nevoja të veçanta
- Takime me ekipin për parandalimin dhe braktisjen e shkollës
- Takime me ekipin për vlerësim pedagogjik të nxënësve
- Bashkëpunim me QPS-në
- Vizita nëpër shkolla
- Prezantim në takime dhe punëtori

- Takime në MASHT
- Shpërndarja e certifikatave të kurrikulës për mësimdhënës

9. Zyra ligjore e DKA-së në Viti (Sekretaria)

- Në periudhën janar-dhjetor janë protokolluar 525 lëndë të natyrave të ndryshme: Vendime të çështjeve të ndryshme, kontrata, konkurse, përgjigje në Padi për Gjykatën, njoftime, përgjigje në kërkesa, ankesa, vërtetime, pëlqime si dhe shkresa tjera.
- Kemi përfaqësuar DKA-në, në Gjykatën Themelore Dega në Viti, në kërkesëpaditë të ushtruara nga personeli arsimor dhe palët.
- Me kohë kemi shpallur konkurset publike për kuadër arsimor për vendet e lira të punës dhe ndryshimet i kemi bërë me kohë në fillim të ç'do muaji.
- Kemi bërë një planifikim të mirë, pasi që të gjithë punëtorët arsimor janë të pajisur me kontrata të punës dhe të gjithë të punësuarit në Sektorin e arsimit janë të futur në Sistemin e pagave.
- Me rastin e rekrutimit- pranimi të personelit arsimor kemi zbatuar normativin në fuqi, duke filluar nga ligji i arsimit, udhëzimin administrativ të MPMS dhe aktet tjera nënligjore.
- Me rastin e pranimi të personelit arsimor, nuk kemi asnjë rast ku kemi bërë shkelje ligjore apo shkelje të drejtave të aplikuesve, sepse nuk kemi lejuar të anashkalohet kualifikimi, përvoja e punës apo rezultatet e testit me shkrim dhe me gojë, për këtë që po e themi ekzistojnë faktet dhe dokumentacioni në DKA.
- Po ashtu kemi edhe konfirmimin nga Inspektorati Regjional i Punës për rregullsinë e rekrutimit dhe pranimi të mësimdhënësve dhe të gjitha ankesat e palëve të pakënaqura janë refuzuar.
- Gjatë punës ky sektor gjithmonë ka parasysh parimin e efikasitetit në punë, me rastin e shqyrtimit të kërkesave, ankesave dhe veprimeve tjera procedurale duke respektuar afatet ligjore dhe zyrtare.
- Me kohë i kemi pajisur punëtorët arsimor me kontrata të punës (akt emërimi).
- Jemi duke i bërë parapërgatitjet për shpalljen e Konkursit të rregullt publik për mësimdhënës për vitin shkollor 2020/21, në planifikimin e pozitave të lira duke kërkuar nga drejtorët e shkollave informata për pozitat e lira.

10. Sektori i Administratës

- Për këtë periudhë kohore prej 01.01.2020 deri më 31.12.2020 kanë kryer këto punë dhe shërbime:
- Gjithsejtë janë të protokolluara 525 lëndë.
- -Konkurse-08
- -Vendime -92
- -Përgjigje në padi -88
- -Ankesa drejtuar DKA-së- 10
- -Ankesa për gjykatën e apelit -03
- -Kërkesa nga organet e tjera- 52
- -Përgjigje në kërkesa-182
- -Pëlqime-14
- -Njoftime të ndryshme -24
- -Vërtetime -29
- -Urdhëresa – 03

- -Autorizime -20
- Gjithsej 525 lëndë

11. Sektori i financave

- Pagesa e obligimeve nga viti 2020
- Ndryshime në listat e pagave ku përfshihen: largime nga listat ,punëtor të rinj ,ndryshime (ndërrim institucioni, ndalese mjekësorë dhe e lehonisë, ndalesë për mungesa etj),pagesa retroaktive, ndërrim të llogarisë bankare ku gjithsej kanë qenë 313.
- Përgatitja e para masës dhe furnizimi (nga kërkesat e shkollave) me dru zjarri për vitin shkollor 2020-21
- Furnizime me tonerë, letër dhe material hargjues.
- Përgatitja e kornizës afatmesme të shpenzimeve.
- Përgatitja e buxhetit për periudhen:2021;2022;2023
- Pranimi shpërndarja dhe kompletimi me nënshkrime i listave të pagave.
- Inicimi i kërkesave për shpallje të tenderëve për nevojat e shkollave.
- Organizimi i transportit të nxënësve për nxënësit e fshatrave Letnicë dhe Podgorc.
- Organizimi i transportit të nxënësve me nevoja të veçanta për në shkollën speciale në Prizren.
- Pagesat e shërbimeve komunale.
- Përgatitja e lëndëve për pagesa për furnizime.
- Përgatitja e tenderëve për furnizim me laptopë (88) dhe video projektorë (82).
- Furnizimi i shkollave me pajisje të imta, vlen të përmendet edhe blerja e makinave pastruese për dysheme për shkollat: Gjimnazi „Kuvendi i Lezhës, SHMP “Jonuz Zejnullahu”, SHFMU, “Dëshmorët e Vitisë” dhe SHML “Kongresi i Manastirit”
- Nen alokimi i mjeteve ne sistemin ‘Free Balance’.
- Zotimi i mjeteve pasi qe janë zotues alternativ në mungesë të zyrtarit zotues.

12.Donacionet

Tabela 7. Donacionet në shkolla

	Donacioni	Shkollat përfituese	Data
1	Një prind i dhuron shkollës për paralelen e ndarë në Terstenik një tavolinë pingpongu , raketa dhe topa.	SHFMU “Nijazi Rexhepi” Sllatinë e epërme	Shkurt 2020
2	Printer me ngjyra nga fondacioni BONEVET KML	SHFMU “Dëshmoret e Vitisë” Viti	Prishtine
3	Është fituar granti nga Banka Botërore në vlerë prej 13.300 Euro për modernizimin e shkollës me mjete konkretizuese.	SHFMU “Dëshmoret e Vitisë” Viti	28 prill
4	Organizata zvicerane “Helvetas” me participim të KK Viti në shumë prej 11.000 euro ndihmuan shkollën në funksionalizimin e qendrës së karrierës duke e mobiluar dhe ofruar mundësi pune.	Shkolla e mesme teknike profesionale “Jonuz Zejnullahu” Viti	26 maj 2020
5	Studentë francezë të shoqatës “ Help Kosova ” kanë ndihmuar shkollën me çanta dhe materiale të ndryshme shkollore.	SHFMU “Dëshmorët e Lubishtës”, paralelja në Buzovik	5 mars
6	Përfitues të projektit “FRED”/Këshilli Europës , kursi i gjuhës turke për 60 nxënës.	SHFMU “Halil Alidema” Pozheran	6 shkurt

7	U bë hapja e puseve si donacion nga HUMAN APPEAL INTERNATIONAL, shoqatë nga Emiratet e Bashkuara Arabe në katër shkolla të komunës së Vitisë.	Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës", SHFMU "Nijazi Rexhepi" Sllatine e epërme, SHFMU "Safet Rexhepi Zhiti/Ballancë, SHFMU "Nazmi Pajaziti" Radivoje, SHFMU "Halil Alidema" Pozheran, SHFMU "Hysen Terpeza" Terpezë	Qershor 2020
8	ELKOS grup, dhuroi 11 laptopë për nxënësit në nevojë gjatë mësimi në distancë	Viti	7 maj /Prishtinë
9	UNICEF ka dhuruar material higjienik, dezinfektues, maska dhe termometra për gjitha shkollat në masë të konsiderueshme.		11.09.2020 dhe 28.09.2020
10	MASH furnizim me maska mbrojtëse me sasi 9000 copë ,për të gjitha shkollat.		12.09.2020
11	"Ekologjia" nga Ferizaji ka dhuruar 1000 shishe nga 500 ml dezinfektues		30.09.2020
12	"Every Day Group" ka kryer dezinfektimin e disa shkollave.	"Ahmet Hajdari" Beguncë "Bafti Haxhiu" paralelja Ramnisht,"Dëshmorët e Lubishtës" Lubishte,"Mirali Sejdiu" paralelja Germove, Çerdhja "Gezimi Ynë",Zyret e DKA, "28 Nëntori" paralelja Sadovine e Jerlive,"Nijazi Rexhepi" Sllatine e Eperme,paralelja Sllatone e Ulët,"Kongresi i Manastirit" Pozheran.	29.04.2020

Investime kapitale

12.1 Renovimi i disa shkollave në nevojë, siç janë:

- ✓ Shkolla "Ndre Mjeda" -Kabash, rregullimi i tualeteve, ndriçimit elektrik, ngjyrosja. Paralelja e ndarë në Buzovik instalimi i nxehjes qendrore dhe vendosja e perdeve.
- ✓ Shkolla "Dëshmorët e 5 Prillit" -Smirë, rregullimi i tualeteve (rregullimi instalimit kanalizimit ,ujësjellësit, shtruarja me pllaka dhe ndërrimi i dyerve dhe lyerja e mureve me ngjyrë yndyrore në lartësi 1 m e 20 cm.)
- ✓ Shkolla "Mirali Sejdiu" Goshicë rregullimi i mbulojes para hyrjes .
- ✓ Shkolla "28 Nëntori" Sadovin e Jerlive ndërrimi i kaldajës së nxehjes qendrore.
- ✓ Shkolla "Nijazi Rexhepi" paralelja te lagjja e Gjinollve ,instalimi i nxehjes qendrore,dhe suvatimi i shkollës.
- ✓ Shkolla "Skender Emerllahu" paralelja Fshati i Ri ,instalimi i nxehjes qendrore.

- ✓ Shkolla "Kongresi i Manastirit" izolimi i murit nga themeli me lartësi 80 cm, rregullimi i pullazit me llamarine sîms.
- ✓ Shkolla "Hysen Terpeza" Terpezë, suvatimi i brendshëm i shkollës, rregullimi tualeteve, vendosja e perdeve.
- ✓ Shkolla "Dëshmorët e Vitisë" Rregullimi i pjesshëm i kulmit me llamarinë, suvatimi i pjesshëm brenda shkollës aty ku ka pas nevojë, riparimi i kaldajës të nxehtë qendrore pasi ka pasur avari, vendosja e gypave nga objekti i kaldajave me kyçjen e nxehtë në shkollë.
- ✓ Shkolla "Kuvendi i Lezhës" Viti, rregullimi i nyjave sanitare në tualete, zëvendësimi i disa radiatorëve, ngjyrosja e disa klasave ku ka pas nevojë, rregullimi i ndriçimit elektrik sipas nevojës për ndërhyrje.
- ✓ Shkolla "Nazmi Pajaziti" Radivojc, Izolimi i platesë para hyrjes në shkollë.

12.2 Përfundimi i punimeve si izolimi i shkollës, kulmi dhe instalimi i ngrohjes qendrore, ndriçimi elektrik në shkollat përkatëse për eficientë të energjisë siç janë:

- ✓ SHFMU "Safet Rexhepi" në Zhiti
- ✓ SHFMU "Nijazi Rexhepi" në Sllatinën e ulët dhe
- ✓ SHFMU "Mirali Sejdiu" Goshicë
- Nënshkrimi i marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit për re-vitalizimin e shkollës së Çifllakut me vendim të Kuvendit për shndërrim në çerdhe, i cili është investim i përbashkët Ministri-Komunë dhe punimet janë përfunduar.
- Përfundimi i punimeve në SHFMU "Dëshmorët e Vitisë", paralelja në Drobesh. Investim i MASHT-it dhe vazhdimi i punimeve edhe në SHFMU "Halil Alidema", investues Masht-i.
- Rrethojat e fushave sportive si në SHFMU "Dëshmorët e Lubishtës" Lubishtë, SHFMU "Nazmi Pajaziti" Radivojc, SHFMU "Mirali Sejdiu" Goshicë SHFMU "Nijazi Rexhepi" paralelja te lagja e Gjinollve, Sllatine e Epërme dhe SHFMU "28 Nëntori" Verban.
- Asfaltimi i fushave sportive në SHFMU "Nijazi Rexhepi" paralelja te Lagjja e Gjinollve, Sllatine e Epërme, SHFMU "28 Nëntori" Verban.
- Fushat me gomë në SHFMU "Dëshmoret e 5 Prillit" S mirë, dhe SHFMU "Nazmi Pajaziti" Radivojc.
- Furnizimi i gjitha shkollave me 88 Laptope dhe 82 projektor , ku kriter i ndarjes ka qenë numri i nxënësve.
- Furnizimi me inventarë për shkollat: Don Mikel Tarabolluzi, Bafti Haxhiu, Dëshmorët e 5 Prillit, Dëshmorët e Lubishtes, Nazmi Pajaziti, dhe Gjimnazi në Viti

13. Sfidat e paraqitura

- Sfidë kryesore ka qenë luftimi më pandeminë dhe organizimi i mësimi në distancë
- Kushtet e vështirësuar në punë nga vjetërsia dhe dëmtimi i objektit të DKA-së,
- Mungesa e hapësirës së mjaftueshme për punë

- Zvogëlimi i numrit të nxënësve
- mungesare pajisjeve teknologjike për zhvillimin e mësimi në distancë për një numër të nxënësve.
- Transferimi në zyre e reja në muajin qershor në zyrat e ish komunës së vjetër, ku hapësira për punëtorët është më e përshtatshme për zhvillimin normal të punës.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Ky raport është i bazuar në kërkesat dhe detyrave të cilat jemi të obliguar që në harmoni me planet që janë të dale nga: "Plani zhvillimor Komunal" nr.01-013/126 i datës 07.02.2011; "Plani zhvillimor Urban" me nr. 01-013/126 i datës 07. 02. 2011; Planet rregulluese: "Zona Qendrore dhe Jugore dhe Lumi" me nr.01-013/1275 i datës 21.02.2013 si dhe "Zona Veriore" me nr.01-013/869 i datës 08.10.2013.

Implementimin e kritereve ndërtimore të dalë nga: "Rregullorja për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve në Komunën e Vitisë" nr. 01-013/317 të datës 15.03.2011.

Kontrollimi i planeve rregulluese detale të miratuara në raport me kërkesat për ndërtim nga qytetaret.

Kërkesa për dhënien e informatave për parcelat të ndryshme se çfarë destinim kanë me plane zhvillimore komunale dhe urbane .

Gjatë vitit 2020, kjo drejtori ka kryer këto punë dhe aktivitete të përshkruara sipas planit të punës për vitin 2020

▪ **Spektori i Urbanizmi**

Gjithsej 40 kërkesa

❖ Kërkesa për pëlqime urbanistike.....	08
• Të shqyrtuara	08
• Të miratuara	08
• Të refuzuara	00
• Në proces	00
❖ Kërkesa për leje ndërtimore	10
• Të miratuara	08
• Të refuzuara	02
• Në proces	00
❖ Kërkesa për leje përdorimi	03
➤ Të miratuara	03
➤ Në proces	00
❖ Kërkesa për Legalizim	22
➤ Të miratuara	14
➤ Në proces	07
➤ Në pritje(Komision ndërministror)	01

▪ **Spektori i Planifikimit**

- ❖ Është punuar në ekip komunale për vlerësimin e zbatueshmërisë së Dokumenteve të Planifikimit PZHK dhe dhe PZHU-së, dhe përgatitjen për hartimin HZK;
- ❖ Janë përfunduar profili dhe analiza dy kaptinat për Planin Zhvillimor Komunal;

- ❖ Është përfunduar dhe aprovuar në Kuvendin Komunal hartimi i Planit për Menaxhimin të Mbeturinave;
- ❖ Është përfunduar hartimi i Rregullores për Mbeturina dhe është aprovuar në Kuvendin Komunal;
- ❖ Në sektorin e planifikimit janë shqyrtuar 29. kërkesa të ndryshme
Kërkesa për dhënie të informatave urbanistike.
- ❖ Gjithsejtë kërkesa:23
- të shqyrtuara :23
- Në proces 00
- ❖ vendime për kushte të ndërtimit 6
- ❖ Të shqyrtuara 06
- ❖ Të miratuara03
- ❖ Të refuzuara03
- ❖ Në proces.....00

▪ **Spektori i Mjedisit**

- Shpallja e vitit 2020 vit I ambientit në Komunën e Vitisë me vendim të Kryetarit të Komunës së Vitisë z.Sokol Haliti.
- Gjatë kësaj periudhe është shënuar “Dita Botërore e Mjedisit” më 05.qershor 2020 në aksion ku nën masat e parapara nga ISHPK kanë marrë pjesë mbi 200 pjesëmarrës dhe janë larguar mbi 100 thasë mbeturina janë mbjellë 300.fidane lulesh dhe 30.drunjë dekorativ ne parkun e qytetit dhe në shëtitoren rreth lumit “Morava e Binçës”.
- Aktivitete të pastrimit të ambientit në bashkëpunim me këshillat e fshatrave janë shënuar edhe në disa fshatra të Komunës.
- Në bashkëpunim me MMPH janë vizituar dhe listuar objektet dhe zonat e mbrojtura të natyrës;
- Në vazhdimësi është bërë vlerësimi i gjendjes mjedisore është bërë grumbullim i informatave nga terreni lidhur me çështjet mjedisore, të cilat janë në një Raport të Zgjeruar Mbi Gjendjen e Mjedisit në Komunën e Vitisë;
- Është lëshuar **1. Leje Mjedisore Komunale** për veprimtari;
- Në bashkëpunim me Institutin për Mbrojtje të Natyrës nga AMMK – MMPH, kemi përcaktuar shtatë zona me vlera të mbrojtura të natyrës për të cilat është marrë vendim në Kuvendin Komunal për mbrojtje.

Zyra e Adresave

- Janë bërë një marrëveshje bashkëpunimi në mes Zyrës së Adresave të komunës së Vitisë, Agjensionit Kadastral dhe shtetit Norvegjez .ku jemi përfitues të donacionit në vlerë mbi 15.000€ .i cili është i dedikuar për vendosjen e numrave nëpër objekte. Ndërsa tjetrën shumë do ta siguroj komuna në bazë të marrëveshjes së lartcekur.
Ky projekt do të realizohet në vitin 2021.pasi që për shkaqe të pandemisë COVID-19 në vitin 2020 nuk ka mund të realizohet.
- Rishikimi i tërësishëm i hyrjeve dhe objekteve në të gjitha rrugët e qytetit të Vitisë.
- Inspektimi dhe mirëmbajtja e tabelave në terren së paku një herë në muaj në vende rurale, kurse nëpër qytet kemi bërë inspektimin më shpesh. Aty ku kemi hasur në ndryshimin e tyre kemi intervenuar duke bërë rregullimin dhe tërheqjen e tyre.

- Janë futur në sistem shumë pika referuese në territorin e komunës sonë si p.sh.: shkolla, xhamia, kisha, fusha sportive, sheshe, lapidare etj.
- Janë futur të dhënat në Sistemin ARIS për një periudhë që e ka caktuar Agjësioni Kadastral.

Sfidat:

- Një ndër sfidat kryesore të kësaj drejtorie është pa mundësia e harmonizimit të kërkesave ndërtimore, sepse ekziston një dallim shumë i madhe në mes të PZHK-së, planeve rregulluese dhe kërkesave të qytetarëve për ndërtim.
- Numër i vogël i personelit profesional nga mungon një ndërtimtar, një aktikekt, një specialist i GIS-it dhe një jurist i specializuar për fushën e ndërtimit e që me ligjin mbi administrimin e pushtetit lokal nuk na lejohej rritja e punëtorve.
- Përfundimi i hartimit të PZHK-së, Hartës Zonale të Komunës dhe ndryshimi i planeve tjera hapsinore.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Punët dhe aktivitetet e kryera në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për periudhën Janar – Dhjetor 2020 janë zhvilluar në bazë të programit të punës dhe kërkesave të parashtruara nga qytetarët dhe fermerët në lëmin e prodhimtarisë bujqësore.

Në këtë periudhë raportuese, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i ka kryer të gjitha procedurat për fermerët që kanë të bëjnë më: plotësimin e aplikacioneve, dhënie të këshillave dhe dorëzimin e tyre në MBPZHR, në mënyrë që këta fermer të jenë përfitues të mundshëm të subvencioneve dhe granteve të ndarë nga niveli qendror dhe komuna.

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, gjatë vitit 2020 ka kryer këto aktivitete të punës, gjithmonë bazuar në planin vjetor të punës, të hartuar për vitin kalendarik Janar – Dhjetor 2020

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, aktivitetet e saja i kryen përmes 3 sektorëve: Sektori për Bujqësi dhe Blegtori, Sektori për Pylltari dhe Sektori për Zhvillim Rural.

1.1 Sektori për Bujqësi dhe Blegtori

- Gjatë këtij viti janë bërë vizita të shumta në teren për grumbullimin e shënimeve në ferma, (është bërë rifreskimi i të dhënave mbi gjendjen në përgjithësi të të gjithë sektorëve të bujqësisë me të dhëna të reja.
- Hartimi i planeve mujore të vizitave në teren për grumbullimin e shënimeve në ferma,
- Hartimi i planit të mbjelljeve pranverore për vitin 2020,
- Përcjellja e statistikave bujqësore 19 vizita për këtë qëllim,
- Kontrollimi i materialit fidanor gjithsej 8 kontrollime,
- Kontrollimi dhe vizita e bletarve 30 Kontrollime,
- Kontrollimi dhe vizita në ferma blegtorale gjithsej 20 vizita
- Kontrollim dhe vizita e pemëve të imta gjithsej 18 vizita

Pranimi dhe plotësimi i formularëve si dhe regjistrimi i pronave të fermerëve për subvencione si: grurë, miser, perime në fushë të hapur, pemë, lopë qumështore, dele, dhi.

derra, bletë, qumësht sipas cilësisë dhe pula vojse, ku janë pranuar gjithsej: 1080 aplikacione,

- Për Subvencione të Grurit kanë aplikuar: 624 Fermer.
- Për Subvencione të Misrit kanë aplikuar: 541 Fermer.
- Për Subvencione të Perimeve kanë aplikuar: 295 Fermer.
- Për Subvencione të Pemëve kanë aplikuar: 63 Fermer.
- Për Subvencione të Pemë të imeta kanë aplikua: 9 Fermer.
- Për Subvencione të Bletëve kanë aplikuar: 45 Fermer.
- Për Subvencione të Deleve kanë aplikuar: 62 Fermer.
- Për Subvencione të Dhive kanë aplikuar: 15 Fermer.
- Për Subvencione të Lopëve qumështore kanë aplikuar: 192 Fermer.
- Për Subvencione të Derrave kanë aplikuar: 2 Fermer.
- Për Subvencione të Qumështit sipas cilësisë kanë aplikuar: 30 Fermer.
- Për Subvencione të Pulve vojse kanë aplikuar: 5 Fermer.
- Vizitë,(inspektim), mullinjve për verifikimin e masave të marra për kryerjen e 3 DDD. Janë vizituar të gjitha depot e mullinjëve (2 mullinj), së bashku me inspektorin e bujqësisë
 - Sektori për bujqësi dhe blegtori ka përcjellur fushatën e korrije shirjes gjatë muajit korrik. Në komunën tonë kanë qenë të mbjellë 4850 ha me grurë, ndërsa numri i autokombajnervë të angazhuar në fushatë ka qenë 104 autokombajner. Fushata ka filluar më 07.08.2020 dhe ka përfunduar më 02.09.2020 Rendimenti mesatar në komunën e Vitisë ka qenë 5000kg/ha.

1.2 Sektori për Pylltari dhe Zhvillim Rural

- Përgatitja e planit të prerjes në bashkëpunim me APK-në 2020
- Kryetari i Komunës së Vitisë ka shpallur vitin 2020 vit të mbajtjes së pyjeve
- Në bazë të vendimit të kryetarit të Komunës së Vitisë DBPZHR-ja ka hartuar planin operativ për mbrojtjen e pyjeve.
- Vizita në paralelet e prerjes
- Shqyrtimi i kërkesave për prerje në pyjet private
- Takime të rregullta me stafin e pylltarisë, realizimi i detyrave të punës
- Konfiskimi i masave të druve të vëna në qarkullim pa dokumentacionin e nevojshme, ku janë konfiskuar 23.20 m³ dru edhe 6 automjete transportuese, siç janë: Kombit, Kamjonetat si dhe Kamjonat dhe është konfiskuar motorsharr për prerjen e drurëve.
- Gjatë vitit 2020 janë mbyllë me eskavator mbi 3 rrugë në pyje me qëllim të pengimit të prejeve ilegale të pyjeve, ku kanë ndikuar mjaftë në zvogëlimin e dëmeve
- Gjatë vitit 2020 janë mbajtur disa takime me Kryetarin e komunës, Komandantin e Stacionit Policor në Viti dhe Kryetarin e Gjykatës Themelore dega në Viti me qëllim të kordinimit të aktiviteteve për ndalimin e prerjeve ilegale

- Në bashkëpunim me policinë janë realizuar disa kontrolla rutine në tregje dhe rrugë kyqe që kanë rezultuar me konfiskim të masës drusore të prerë ilegalisht
- Gjatë periudhës një vjeçare nga ana e rojeve të pyllit janë bërë gjithsej 177 fletëparaqitje për dëme në pyje
- Gjatë vitit 2020 janë konfiskuar 23.20 m³ dru zjarri
- Kërkesa të parashtruara për pyje private gjithsej 24 kërkesa
Të shqyrtuara dhe miratuara 20 kërkesa
- Më datë 21.08.2020, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në bashkëpunim me organizatën IKC edhe sivjet ka bërë promovimin e kulturës bujqësore të shalqirit duke shënuar "Ditën e Shalqirit" në fshati Gjylekar të Vitisë. Ky vend është i njohur për kultivimin e kësaj kulture bujqësore dhe është një produkt shumë i kërkuar në tregun Kosovar.
- Në Viti u shënuar dita e Patatës, aktivitet i organizuar nga DBPZHR-ja dhe Organizata IKC. Ku për qëllim kishte promovimin e Patatës që prodhohet në Deblideh e cila është e njohur për cilësinë e sajë, në tërë Kosovën.

1.3 Aktivitete Rutinore

- Gjatë vitit 2020 komisionet komunale për vlerësimin e dëmeve në Bujqësi dhe Blegtori kanë bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga faktor të ndryshëm si klimatik, në fusha të ndryshme të bujqësisë dhe blegtorisë, ku vlera totale e dëmeve është: **37,942.61 €**. Ky komision është bërë në bashkëpunim me DBPZHR dhe përmes MBPZHR për dëmet e shkaktuar gjatë muajve Maj -Qershor .
- Organizimi i 1 trajnimeve në bashkëpunim me shërbimin këshillimorë të MBPZHR
- Menaxhimi i fermave bujqësore, mbajtja e kontabilitetit dhe librave në ferma (këshilla praktike)
- Grumbullimi i të dhënave statistikore,
- Vizitë të gjithë kombajnereve rreth përgatitjes teknike të kombajnave dhe verifikimi i numrit të tyre, gjithsej në komunën tonë janë 104 kombajna.
- Takime me organizata të ndryshme: si: IKC ,UNDP-ja, IADK Fondacioni Kosovë Luxemburg, Caritasi Zvicrran etj.

1.4 Të hyrat nga taksat komunale që i përkasin Drejtorisë së Bujqësisë

Duke u bazuar në të hyrat që krijohen nga grumbullimi i taksave komunale nga domeni i bujqësisë paraqitet kjo gjendje :

Të hyrat nga :

- Ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në atë ndërtimore : 3,621.5 € dhe
- Vërtetime për veprimtari bujqësore : 50 €
- Të hyrat nga shitja e masës drusore të konfiskuar: 3,602.50 €

Gjithsej të hyra : **7.274 €**

1.5 Shqyrtimi i kërkesave të drejtuara përmes arkivit të komunës

Gjatë këtij viti nga arkivi i komunës kanë arritur gjithsej 65 kërkesa, prej tyre :

Të bartura nga viti paraprak	Të pranuar në vitin 2020	Gjithsej të pranuar	Të miratuara	Të refuzuara	Gjithsej të shqyrtuara
/	65	65	64	1	65

Kurse, sa i përket kërkesave që i drejtohen drejtorisë pa procedurë të arkivit, numri i tyre është i madh dhe kryesisht kanë të bëjnë me shqyrtimin e mundësisë së subvencionimit të kulturave bujqësore që kultivohen nga ana e tyre.

1.6 INVESTIMET NGA KOMUNA DHE ORGANIZATAT (DONATORËT) NË FUSHËN E BUJQËSISË GJATË VITIT 2020

Komuna e Vitisë dhe Organizata IKC:

Komuna dhe IKC kanë shpërndarë mekanizëm për mbjelljen e fidanëve të lakrës dhe specave .

Përfitues 18 fermerë të Vitisë.

Komuna dhe IKC kanë shpërndarë 83 Serra me sipërfaqe 50m2 .

Komuna : 45,850.00 €

IKC : 50,000.00 €

Vlera e projektit: 95,850.00 €

Komuna e Vitisë me DBPZHR :

Ka shpërndarë serra me sipërfaqe 50m2 dhe mbulimi i tyre me foli plastike bashkëfinacim me fermerin .

Përfituesë 44 fermerë të Komunës së Vitisë:

Komuna : 75 % 11,880 €

Fermerët : 25% 3,960 €

Vlera e projektit: 15, 840.00 €

Komuna e Vitisë me Organizaten Caritasi Zvicrran :

DB në bashkëpunim me Caritasin Zvicrran ka bërë shpërndarjen e mjeteve për Bimë Mjekuese Aromatike dhe dredhëz.

Në kuadër të pakove, fermerët janë paisur me: Rezervuar të ujit, gypi për sistem pike -pikë, foli e zezë, telë për rrethojë, shtylla, pompa për spërkatje, plehra , kabinete metalike për ruajtjen e preparative, gajbe etj.

Gjithësej janë 13 fermerë, prej tyre 6 janë përfitues të BMA dhe 7 fermerë me fidane të dredhëzës.

Komuna :35 % 10,890.95 €

Fermerët : 15 % 4,667.55 €

Caritasi Zvicrran: 50 % 15,558.50 €

Vlera e Projektit : 31,117.00 €

Komuna e Vitisë dhe Organizata UNDP-ja :

Njëzet fermerë kanë përfituar systemin e ujitjes pikë-pikë dhe fidane të bimëve aromatike mjekuese për 5 ari. në kuadër të projektit " Promovimi i Sektorit të Bimëve Mjekësore

Aromatike në Viti" I cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe Implementohet nga Programi për Zhvillim I Kombeve të Bashkuara (UNDP), përmes Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perendimor ReLOaD.

Gjithsej Investimi 18,597.00 €

Organizata IADK

Organizata IADK ka ndihmuar një femër në hapjen e biznesit të ri në fsh.Lubishtë me mjete për ngritjen e njësisë për pëpunim të qumështit.

Fermeri : 8 % 1,200.00 €

Komuna : 20 % 3,120.00 €

IADK : 72 % 11,280.00 €

Vlera e projektit: 15,600.00 €

Investimet e Komunës së Vitisë ne infrastrukturën rrugore bujqësore dhe lumenjeve:

- Ruget e punuara:
 - Nr. Emri/Vendi gjatësia L(m')
 - Rruga. Goshice – Verban – 1228.00 m'
 - Rruga Verban – Begrace - 363.00 m'
 - Rruga. Verbani – Verban – 629.00 m'
 - Rruga Te Shavarint – Verban – 365.00 m'
 - Rruga Bujqesore I – Kabash – 293.00 m'
 - Rruga. Bujqesore II – Kabash – 224.00 m'
 - Rruga. Bujqesore Viti – Kabash – 453.00 m'
 - Rugë që janë duke u punuar -në vazhdim e sipër
 - Rruga. Arifajt – Delijajt – Begunce – 905.22 m'
 - Rruga. Cejava – Begunce - 611.79 m'
 - Rruga. Te Varrezat e Demirve – Begunce – 629.88 m'
 - Rruga. Bujqesore III – Kabash – 400.71 m'
- Shuma e kontratës për 3 vite kontratë kornizë është **450,000 €**

Pastrimi i prrockave gjatë vitit 2020:

- 1. Përrocka në pjesën Viti- Ramnishtë me gjatësi 1200 m' – është e përfunduar
- 2. Lumi Bucina Sllatinë e poshtme- Sllatinë e epërme 3747.0 m është e përfunduar.
- 3. Përrocka në Sllatinë e poshtme- Sllatinë e epërme 2000 m është e përfunduar 4.
- 4. Përrocka në Gërmovë me gjatësi 1450 m' është përfunduar.
- Vlera e punimeve të kryera është **40.074,80 €**

Totali i investimeve nga Komuna e Vitisë në rrugë bujqësore dhe lumenjë: 490,074.80 €

1.7 Investime nga MBPZHR

- Grandet
 - a. Nga Ministria e Bujqësisë ende nuk është publikuar lista e përfituesve.
Vlera te investimeve për grande ende nuk është publikuar.

- **Pyllëzimet**

b. Gjatë vitit 2020 janë ripyllëzuar 6/ha nga MBPZHR dhe është pyllëzuar 1/ha, gjegjësisht Agjensioni pyjor i Kosovës mbi fshatin Novosellë.

- **Subvencionet**

c. Gjatë vitit 2020 kanë përfituar subvencione 1080 fermer nga fusha të ndryshme të bujqësisë, vlera e subvencionve është ende në proces ku parashihet të jetë mbi 3,000,000 €
Vlera totale e përfituar nga ana e fermerëve vitias është: €

1.8 Shuma e përgjithshme e investimeve në bujqësi, nga Komuna, Ministria dhe donatorët gjatë vitit 2020

INVESTUESI	SHUMA
Komuna e Vitisë dhe donatorët	222,220.61 €
Ministria e Bujqësisë(subvencionet dhe grantet)	€
Investimet e Komunës së Vitisë ne infrastrukturën rrugore bujqësore	490,074.80 €
Totali i investimeve për vitin 2020	712,295.41€

Aktivitetet e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë Pandemisë- Covid 19

Siç dihet Komuna e Vitisë ishte e para në nivel vendi e cila u ballafaqua me Pandeminë, edhe gjatë kësaj kohe ka patur aktivitete të cilat janë kryer sipas Vendimeve të marra nga Komuna e Vitisë, Vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë, MBPZHR dhe duke iu përmbajtur Vendimeve të Qeverisë.

Aktivitetet janë kryer falë zhvillimit të teknologjisë siq janë: email adresave, facebook, viber etj. Përmes email adresës është punuar në Draft e Masën 303, lidhur me LIDERIN dhe Funkcionalizimi I GLV-ve.

Përmes rrjeteve sociale është bërë formimi i grupeve të grave dhe fermerët për informim dhe bashkëpunim lidhur me aktivitetet bujqësore.

Me datë: 14.04.2020- Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjegjësisht Ministri Besian Mustafa, përmes kërkesës në facebook bëri thirrje se -Puna e bujqve tonë nuk do të ndalet- Me këtë kërkesë do të vlejnjë masa lehtësuese dhe do t'iu krijohet mundësi pune për bujqit që tani janë në kulmin e punës në fushë., kjo do të arrihet përmes pajisjes me Numër Identifikues të Fermës (NIF)

Me datë: 15.04.2020- Zyrtarët e Drejtorisë së Bujqësisë menjëherë iu kanë përgjigjur thirrjes së Ministrit të Bujqësisë duke i pajisur fermerët me NIF, e që gjithsej janë pajisur 450 fermerë, kuptohet duke iu përmbajtur kritereve siq janë: distanca, maska dhe dorezat.

Me datë: 20.04.2020.-Viti- Ministri i Bujqësisë viziton Vitinë ku së bashku me Kryetarin e Komunës ata bëjnë vizitë direkt në fermat e fermerëve

Me datë: 28.04-20.05.2020- Viti- Thirrja për aplikim -makina për mbjelljen e fidaneve të perimeve dhe makinë tharëse

Me datë: 09.05.2020- Viti – Njëzet fermerë kanë përfituar sistemin e ujitjes pikë-pikë dhe fidane të bimëve aromatike mjekuese për 5 ari, në kuadër të projektit “ Promovimi i Sektorit të Bimëve Mjekësore Aromatike në Viti” I cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe Implementohet nga Programi për Zhvillim I Kombeve të Bashkuara (UNDP), përmes Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor ReLOaD.

Nga data: 08.05.-14.05.2020- Viti -është bërë vlerësimi i dëmeve të produkteve të mbetura – dëmtuara të fermerëve gjatë Pandemisë Covid 19.

Ky vlerësim është bërë në bazë të kërkesës nga MBPZHR – gjegjësisht nga zv. Ministri i Bujqësisë.

Me datë: 18.05.2020- Viti – Është bërë një shëndërrim i Tokës Bujqësore në atë ndërtimore.

Me datë: 18.05.2020.-Viti- Është bërë vlerësimi i dëmeve në serra të shkaktuar nga era me shpejtësi të madhe e datës: 15.05.2020 në Viti. Raportet janë dorëzuar në MBPZHR.

Me datë: 19.05.2020- Viti – DB në bashkëpunim me Caritasin Zvicerran ka bërë shpërndarjen e mjeteve për Bimë.Mjekuese Aromatike dhe dredhëz.

Në kuadër të pakove, fermerët janë pajisur me: Rezervuar të ujit, gypi për sistem pike-pikë, foli e zezë, telë për rrethojë, shtylla, pompa për spërkathe, plehra, kabinete metalike për ruajtjen e preparateve, gajbe etj.

Gjithsej janë 13 fermerë, prej tyre 6 janë përfitues të BMA dhe 7 fermerë me fidane të dredhëzës. Zyrtarët për çdo gjë i kanë informuar fermerët nga zyra dhe nga rrjetet sociale.

Aktivitetet e Drejtorisë së Bujqësisë në Viti –Maj-Tetor-2020

1. Me datë: 09.05.2020- Shpërndarja e bimëve mjekuese dhe sistemi i ujitjes për 20 fermerë me nga 5 ari. Bimët mjekuese janë: Cian, mullagë e zezë dhe kalendula., në bashkëpunim me Local Solution, pjesë e programit ReLOaD i cili financohet nga BE.

2. Me datë:19.05.2020-Shpërndarja për 13 fermerë, bimë mjekuese-6 fermerë, fidane të dredhëzës 7 fermerë, si dhe rezervuar për sistem të ujitjes, rrethoja me shtylla betoni, plehra artificial etj. Bahkëpunim me Caritasin e Zvicres.

3. Me datë:01.06.2020- Ftesë për aplikim të grave për trajnim e profesionale për përpunim të qumështit- Bashkëpunim me IADK-në. Kanë aplikuar 15 fermere dhe akoma nuk kanë filluar mbajtjen e trajnimeve dhe as nuk është bërë përzgjedhja e fermeres.

4. Me datë:12.06.2020- Dorëzimi i listave për Vlerësimin e dëmeve nga reshjet e shiut dhe breshëri në MBPZHR

Janë vlerësuar 45 fermerë, shuma totale është 102014,31 €, kjo shumë paguhet 25% e vlerës, ku gjithësej vlera totale është 25.503 €.

Datë: 24.09.2020- Janë 51 fermerë, shuma totale e 25% është 37.942.61 €.

5. Me datë: 22.06.2020- Shpërndarja e 4 makinave për mbjelljen e lakrës dhe specit – Bashkëpunim me IKC-në- përfitues tri grupe të fermerëve – gjithësej 18 fermerë.

6. Me datë:01.07.2020-Është bërë inaugurimi i 18 shtandeve për promovimin e produkteve bujqësore – bashkëpunim me GLV-Vitia.

7. Me datë: 07.07.2020- Fushata e korrije shirjes

8. Me datë:13-24.07.2020- Thirrja për aplikim për serrë me sipërfaqe 50m2 – bashkëpunim me IKC-në

9. Me datë:20.07-28.08- Thirrja për aplikim për subvencione nga MBPZHR – kanë aplikuar 1091 fermerë

10. Me datë: 21.08.2020- Dita e shalqirit në fshatin Gjylekar- bashkëpunim me IKC-në

11. Me datë:10-23.09.2020- Thirrja për aplikim për serrë me sipërfaqe 50m2 nga Drejtoria e Bujqësisë

12. Me datë:21.09-12.10.2020- Thirrja për aplikim për Trajnime Profesionale me Fondacionin Kosovo-Luxemburg-në këto drejtime:

- ☐ Elektro instalues
- ☐ Ngrohje qendrore dhe ujësjellës
- ☐ Kuzhinieri

Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi

Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, është e rregulluar me një sistemim dhe në bazë të organogramit të brendshëm dhe përshkrimit të detyrave dhe obligimeve të punës të secilit zyrtar, ku aktualisht në këtë drejtori punojnë 9 zyrtar të cilët janë me kualifikimet e nevojshme për ti plotësuar nevojat e punës dhe të funksionimit të secilit sektor në Drejtori.

Në kuadër të DKPGJ-se ekzistojnë tre sektorë:

- Sektori i Kadastrit

- Sektori i Pronës, dhe
- Sektori i Gjeodezisë

1. Sektorët e DKPGJ-së

Drejtoria për Kadastrë, Pronë dhe Gjeodezi, është e rregulluar me një sistemim dhe në bazë të organogramit të brendshëm dhe përshkrimit të detyrave dhe obligimeve të punës të secilit zyrtar, ku aktualisht në këtë drejtori punojnë 9 zyrtar, të cilët janë me kualifikimet e nevojshme për t'i plotësuar nevojat e punës dhe të funksionimit të secilit sektor në drejtori.

Në kuadër të DKPGJ-se ekzistojnë tre sektor:

- Sektori i Kadastrit,
- Sektori i Pronës, dhe
- Sektori i Gjeodezisë.

1.1 Sektori i Kadastrit

Puna në Sektorin e Kadastrit është e bazuar në dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë këtë sektor, i cili është përgjegjës për kujdesin dhe mirëmbajtje të gjitha regjistrave kadastral, ku përfshihet e gjithë paluajtshmeria komunale, si dhe regjistri i paluajtshmerive, hipotekave, servituteve digjitale dhe manual, si shërbim kryesor për qytetarët si shërbimi me lëshimin e fletave poseduese, certifikatave personale dhe sociale.

Gjatë kësaj periudhe në këtë sektor janë kryer këto shërbime kadastrale:

Muaji	Fleta poseduese Me/pa pagës	Certifikata për N. sociale	Hipoteka	Transaksione Pronësore
Janar	277 me/0pa	99 copë	3regj/4c'regj	70 lëndë
Shkurt	543 me/4pa	89 copë	3regj/4c'regj	65 lëndë
Mars	127 me/2 pa	60 copë	9 regj/1c'regj	55 lëndë
Prill	256 me/11 pa	55 copë	4regj/1c'regj	15 lëndë
Maj	450 me/24pa	65 copë	4regj/2c'regj	25 lëndë
Qershor	551 me/5pa	98 copë	5regj/2c'regj	75 lëndë
Korrik	401 me/21pa	120 copë	5regj/4c'regj	90 lëndë
Gusht	425 me/5 pa	111 copë	4regj/3c'regj	75 lëndë
Shtator	395 me/21 pa	129 copë	3regj/2c'regj	80 lëndë
Tetor	361 me/20pa	88 copë	4regj/1c'regj	89 lëndë
Nëntor	222 me/7pa	95 copë	9regj/4c'regj	74 lëndë
Dhjetor	394 me/15pa	92 copë	6regj/2c'regj	98 lëndë
Totali	4402 me/140 pa	1101 copë	95regj/33c'regj	801 lëndë

Tabela nr.1 Shërbimet kadastrale 2020

1.2 Sektori i Pronës

Sektori i pronës ka përgatitë propozim vendime për bordin e drejtoreshë dhe Kuvendin Komunal, në lidhje me natyrën e punëve në drejtori. Në vazhdimësi ka bërë interpretimin e normave ligjore që janë në fuqi, ka kryer punë administrative në drejtori: përpilimin e aktvendimeve, urdhëresave dhe akteve tjera, ka lëshuar vërtetime për pronat që komuna nuk ka

interes t'i blejë ato. I ka pranuar kërkesat e drejtuara drejtorisë, i ka shqyrtuar ato dhe ju është përgjigjur me shkrim. Ka zhvilluar procedurat për eksproprijim të tokave në pronësi private për interesa të përgjithshme publike. Po ashtu për herë të parë është bërë evidentimi i pronës komunale. Ky projekt është përkrahur dhe është realizuar me ndihmën e Demosit sipas zonave Kadastrale. Po ashtu i ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e palëve të cilat i janë drejtuar drejtorisë lidhur me dhënien e pronës në shfrytëzim.

Gjatë vitit 2020 për Kuvendin Komunal janë përgatitur 13 propozim-vendime nga ky sektor.

1.3 Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë, për gjatë vitit ka kryer këto shërbime për palët dhe Komunën, si: Mirëmbajtja e kadastrës digjitale në sistemin kosovare f01; ka përcjell vektorizimin e raster planeve; ka përgatitë dhe mbikëqyrë të dhënat për kompanitë dhe gjeodetët e licencuar; ka përgatitë raportet ditore për Agjencinë Kadastrale të Kosovës; ka pranuar lëndët e kryera nga kompanitë dhe gjeodetët e licencuar dhe të njëjtat i azhurnon në sistemin zyrtar (Geomedia profesional 5.2); ka bërë azhurnimin e ndarjeve fizike në librat e regjistrimeve të ndarjeve kadastrale; ka bërë hartimin e kopjeve të planit; kontroll të vazhdueshme kualitetit të të dhënave grafike kadastrale dhe atyre tekstuale; projektim të rrjeteve referente, të rendit të tretë të shtruar me GPS; mirëmbajtje për rrjetat referente të rendit të tretë për tërë zonat kadastrale në kuadër të Komunës së Vitisë; identifikim i parcelave në zyrë; futja e të dhënave grafike në datamodelin zyrtar; konsulta dhe këshilla profesionale në lëminë e Gjeodezisë dhe Kadastrës, për palët e interesuara në kuadër të shërbimeve kadastrale; Ekspertiza kadastrale për nevoja të Gjykatave.

Muaji	Kopjet planit Me pag/pa pag	Produkte për kompanitë e private	Ndarje/azhurnime	Bashkim i parcelave	Ndërrim kulture
Janar	125/2	17	43ndarje	3 bashkim	
Shkurt	112/0	15	48ndarje	3bashkime	
Mars	55/2	13	53ndarje	2bashkim/	3 ndërrime
Prill	25/2	15	12ndarje	2	3 ndërrime
Maj	106/1	17	73ndarje	6	1 ndërrime
Qershor	80/0	13	90 ndarje	5	
Korrik	132/0	18	53ndarje	1bashkim	
Gusht	108/2	22	114 ndarje	7bashkim	2ndërrime
Shtator	97/3	17	100 ndarje	2bashkime	
Tetor	87/0	31	91ndarje	10bashkim	1 ndërrime
Novator	85/0	26	96ndarje	10bashkim	
Dhjetor	126/0	21	94ndarje	5 bashkim	1 ndërrime
Total	1138/12	225	867 ndarje	56 bashkim	1 lndrrime

Tabela Nr.3 Shërbimet në sektorin e Gjeodezisë

2. Sfidat

2.1 Pengesat të cilat i përcjell këta Sektor janë:

- Mungesa e shënimeve prej vitit 1985 – 1999;
- Lidhjet e dobëta digjitale në bazën e të dhënave dhe shpeshherë ndërprerja e tyre kohë pas kohe me Agjensionin Kadastral të Republikës së Kosovës;
- Mungesa e shënimeve gjeodezike nga viti 1985 – 1999;
- Mungesa e planeve/skicave për zonat kadastrale, të cilat janë pjesë të komasacionit.

2.2 Propozim masat të cilat duhet të merren për efikasitet janë:

- Insistimi i faktorëve institucional, vendor dhe ndërkombëtar tek Institucionet e Serbisë për kthimin e shënimeve kadastrale dhe gjeodezike, respektivisht planeve gjeodezike;
- Insistimi i institucioneve vendore dhe i mekanizmave ndërkombëtar tek institucionet e Serbisë, për kthimin e dokumentacionit kadastral, të konfiskuar (grabitur gjatë luftës);
- Përpjekjet për përmirësimin e lidhjeve digjitale në bazën e të dhënave me Agjensionin Kadastral të Republikës së Kosovës.

3.0 Të hyrat financiare

Gjatë vitit 2020 Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e kanë përcjellë sfida të mëdha lidhur me pandeminë Covid 19 ku si rezultat i saj kemi ulje të mëdha të hyrave në raport me vitet paraprake.

Planifikimi për vitin 2020 80.000.00€

Realizimi për vitin 2020 58,431.50€

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport pas paraqitjes së pandemisë SARS “Covid 19” në mbar Botën, ndërpreu aktivitetet e saja nga 13 marsi 2020 deri me 8 qershor 2020 kur drejtoria u rikthye me kapacitetet e plota të punës.

Komisioni i emëruar nga Kryetari i Komunës me datën: 02.03.2020 me Nr. protokolli 02-035/02-211. Kryetari i Komisionit ka përgatitur dosjen e aplikimit për OJQ-të dhe Thirrjen publike të datës 05.02.2020 me Nr. Protokolli 02-060/01-97.

Pas thirrjes publike OJQ-të dorëzuan aplikacionin, pas skadimit të afatit nga thirrja publike kryetari i komisionit ka terjak dosjet e aplikimit nga zyra e protokollit dhe ka përgatitur dosjet për komisionin vlerësues. Në kohën kur duhej ftuar komisionin vlerësues u paraqit pandemia “Covid 19” dhe njëkohësisht u ndërpreu të gjitha veprimet e komisionit. Kryetari i komunës pas futjes së komunës në karantinë ka thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme të kuvendit komunal ku janë ndarë një buxhet prej 100.000 € për menaxhim të pandemisë “Covid 19”

Komisioni pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme i propozoj kryetarit të komunës ANULIMIN e thirrjes publike për mbështetjen financiare të entiteteve publike. Në bazë të konsultave me zyrtarë të financave, nga pandemia buxheti nga të hyrat vetanake është shumë i vogël nga dhe nuk mund të llogaritet mjetet e nevojshme për financimin e projekteve të OJQ-ve . Vendimi për ANULIMIN e thirrjes publike u publikua me 20 korrik 2020 në nr. protokolli 02-035/02-651

Komuna e Vitisë, Zyra e kryetarit në përputhje me Rregulloren mund të merr vendime për mbështetje financiare nga kodi buxhetor i subvencioneve deri në 5% e buxhetit të drejtorisë nga 38.000€.

Sipas Rrregulloresne Fuqi Memorandumet para Rregullores mund te mbështeten financiarisht deri në fund të periudhës së përfundimit të Memorandumit. Në këtë kuptim janë ndarë subvencione për 2 shenjëtarët bazuar në Marrëveshjen e Komunes së Vitisë me Komitetin Olimpik të Kosovës e cila janë mbështetur financiarisht deri në gushti 2020 me vlera prej 100€ për secilin garues në muaj.

Sektorët DKRS-së pas paraqitjes së pandemisë Covid-19 kanë anuluar agjendat e aktiviteteve sipas rekomandimeve të IKSHPK-se për masatë ndërmarrë antiepidemike. Në këtë kuptim drejtoria duke qenë në karantinë komunë e Vitisë, është ndërprerë puna për më tepër se dy muaj më pastaj është publikuar me staf esenciel me reduktim apo anulim total të aktiviteteve. Në përputhje me masatë dhe udhëtimet e IKSHPK janë mbajtur aktivitetet e poshtëshënuara në vijim:

a). Sektori për Kulturë, Rinë dhe Sport: Përmbledhja e shkurtër e aktiviteteve gjenerale

- 16 janar: Ekspozita e artit pamor me temë “Frymë Lirie”
- 20.01.2020 – Fillimi i renovimit të objektit për Muzeun e qytetit
- 31.01.2020 – Laureatet e vitit 2019
- 14.02.2020 - ekspozitë në kuadër të projektit “Iniciativa për shkëmbim kulturor ndërkufitar (MAKS FORUM)
- 14.02.2020 - Orë letrare në shënim të 12 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës
- 14.02.2020 – Ligjërat me të rinjtë, temë “Rinia dhe shtetndërtimi”
- 17.02.2020 - 17 shkurti - Dita e pavarësisë së Kosovës - Organizimi i garave ndërkombëtare në atletikë në bashkëpunim me Federatën e Atletikës të Kosovës.
Diploma në disiplinat: Fatosat (M) - 400m, Yllkat (F) – 400m, Pionier të rinj (F) – 800 m, Pioniere të reja (M)– 800m, Pionier (M) – 2 km, Pioniere (F) – 2 km, Junior (M) – 6 km, Juniorët (F) 3 km, Senior (M) 10 km, Seniore (F) 10 km, Veteran (M) – 6 km,, eterane (F) 6 km
- Homazhe të varrezat e dëshmorëve
- 27 shkurt 2020
- Salla e kinemasë - shfaqja filmike për fëmijë
- 13 shkurt shfaqja e “SARS COV 19”
- ANULIMI I GJITHA AKTIVITETEVE PUBLIKE dhe stafi pushon punën NGA 16.03.2020 – 01.06.2020
- 24 mars.2020 – Dita e bombardimeve të NATOS
- 26.03.- 14. 06. 2020 Homazhe për dëshmoret veç e veç, homazhe për epopën e UCK-së, Homazhe Dita e dëshmorëve, homazhe Dita e Çlirimit, etj,...
- 22.04.2020 – Dita e Tokës
- 03.05.2020 – Homazhe obeliskut “Kerim Laëton” klubit të gazetarëve “Kerem Laëton”,
- 05.03.2020 – vizitë e studentëve Francezë në Viti
- 05.05.2020 – Vitia shënoi 5 Qershorin- Ditën Botërore të Mjedisit
- 01.06.2020 – Dita Ndërkombëtare e fëmijëve
- 02.06.2020 – Komuna e Vitisë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për realizim të projektit “Up To Youth”
- 05.06.2020 – 5 Qershorin- Ditën Botërore të Mjedisit
- 14.06.2020 – 14 Qershorin- Ditën e Çlirimit

- 02. korrik.2020 - Manifestimi tradicional kulturorë dhe sportiv "2 korriku" Beguncë turneu i i futbollit i anuluar ndërsa është bërë organizimi simbolik i turneut me 6 ekipe pjesëmarrëse dhe performancë e Klubit të Gjimanstikë. Ekipet pjesëmarrëse 2 ekipe KFOR, 1 Komuna, 1 FKS 1 Policia. Loja e parë KFOR 1 - KOMUNA, FSK – Plicia e Kosvës, Veteranet – KFOR 2.
- 03. korrik 2020 - HIKING për nder të pavarësisë së ShBA-ve shtegu Zhiti-Ballancë-Tërpezë
- 17.07.2020 - Vizita e Ministers së MKRS-se Prishtine
- 12 gushti – Dita Botërore e Rinisë e shënuar nga KVRL
- 11 shtatori – Dita e sulmeve terroriste ne Amerikë HOMAZHE sheshi Richard Holbrooke
- 28 shtatopri – Dita e Rinisë "Gursel e Bajram Sylejmani", organizimi i garave sportive: Gara në KARAOKE, ndeshje miqësore në Futboll veteranet Kfv. Viti – Ffv. Ferizjaj, Hiking shtetgim ne malet e jezercit "20 vet pas shtigjheve te heronjve Gursel e Bajram Sylejmanit", Homazh
- 30.09.2020.– Java Evropiane e Sportit – aktivitete sportive me nxënës të shkollave fillore
- Takimet e Dom Mikel tarabolluzit - ONLINE
- 02.10.2020 - Ndeshje miqësore - KFOR/Britanik – Komuna & Policia – FSK-ja, KFOR - Veteranet
- 04.10.2020 – Dita ndërkombëtare e cjes – Klubi i Hikingut "Angros" – Viti
- 15.10.2020 – Përrurimi i fushës sportive në Ramijan si dhe zhvillimi i ndeshjeve miqësore në futboll të vogël KFOR - Komuna
- 30.10.2020 – Renovimi i muralit në Shtëpin e Kulturës nga ShAF "Gursel Sylejmani"
- 29.10.2020 - Dita e Kulturës Amerikane. Agjenda: Homazh bustit Richard Holbrook, Ngritja dhe Ulja e Flamurit Amerikan Kori i qytetit. Trumpet Art Ramadan, Ekspozitë me fotografi nga aktivitetet e Drejtoris me KFOR Amerikan 2017-2020, Ora e pictures për fëmijë, tema: Si duket Amerika nga perspektiva e fëmijëve kl,5-9, Muzik Instrumentale, Kori i qytetit, Karaoke - Kori i qytetit & KFOR-i Amerikan, Filma artistikë, mbrëmje muzikore, Kori i qytetit, Fast Food nga zgara, Ndezja e fishekzjarreve
- 26.11.2020 - Thanksgiving day – Dita e falemderimeve amerikane – Online, takim me KFOR-in
- 28 nëntori – Dita e Flamurit kombëtar, Homazhe te varrezat e dëshmoreve
- 28.11.2020 - Përrurimi i librave të Prof. Isak Shemës në këndin e Bibliotekës pët të rritur, dhurata e profesorit
- 05.12.2020 – Mbajtje e festivalit për fëmijë "Cover Fesst"

b) Sektori Bibliotekës Publike Komunale

Gjatë vitit 2019, Biblioteka Publike Komunale ka zhvilluar të gjitha aktivitetet e veta konform Ligjit dhe planit te punës për vitin 2019, duke kryer detyrat e veta dhe, duke qenë në shërbim të lexuesve, duke u angazhuar ne ngritjen e nivelit të shërbimeve, me qëllim që qytetarëve dhe lexuesve të rregullt të ju ofroj kushte dhe shërbime cilësore.

Aktivitetet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe, janë përfshirë në këtë raport, sipas rëndësisë së aktiviteteve. Është me rëndësi të përmendet angazhimi i stafit të bibliotekës ka qenë ne nivel. Kështu që performanca e tyre ne punë ka qenë e kënaqshme dhe angazhimi i tyre ka qenë në funksion të përmirimit të shërbimeve për lexuesit. që njëherit është edhe mision parësor i Bibliotekës, ofrimi cilësor i shërbimeve.

Autorët të cilët dhuruan bibliotekës botimet e tyre:

Esat Kamberi, dhuroi librin: KATALOGU I FONDIT ARKIVOR „ESAT KAMBERI” (një ekzemplarë)

Bardh Frangu, dhuroi dy tituj: UDHËT E ËNDRRAVE (pesë ekzemplarë) dhe ÇELËSI I ZONJËS MERI (tre ekzemplarë)

Besjana I. Rexhepi dhe Kastriot I. Vesalaj, dhuruan librin me titull : PRINDËRIMI DHE EFEKTET E TIJ NE MESIMDHËNIEN BASHKËKOHORE (libër Socio – Pedagogjik, dy ekzmp.)

Hamit F. Gërguri, dhuroi 13 tituj me nga një ekzemplarë

Zymrie Salihu, dhuroi librin me titull: GJENERATË E SFIDAVE TË KOHËS,(pesë ekzemplarë)

Jusuf Buxhovi – Prishtinë, dhuroi dy tituj:

DARDANIA: ANTIKA, MESJETA (dhjetë ekzemplarë)

MONA (pesë ekzemplarë)

Ramiz Misini – Devajë , dhuroi librin me titull: DEVAJA NEPER SHTJELLAT E KOHES, (nëntë kzemplarë)

Lah Jashari – Smirë, dhuroi katër tituj:

1. PERGAMENË E DJEGUR – Çun Lajçi, (dy ekzemplarë)

2. BASTARDËT - Çun Lajçi, (një ekzemplarë)

3. KUR FRYJNË ERNAT - Çun Lajçi, (një ekzemplarë)

4. BUBULINË, TI LETËR E PASHKRUEME, Çun Lajçi, (një ekzemplarë)

Lush Isufaj – Prishtinë, dhuroi librin me titull: TË JETOSH VERTIKALISHTË, (tre ekzemp.)

Prof. Dr. Isak Shema, i dhuroi Bibliotekën e tij personale Bibliotekës Komunale të Qytetit – Viti, ku me rastin e festave të nëntorit, kemi bërë promovimin e Këndit të Bibliotekës së Prof. Dr. Isak Shema.

Biblioteka Publike Komunale, është mirënjohëse për gjithë ata që dhurojnë botimet e tyre por edhe ata të cilët japin donacion

Ne këtë vit, fondi i Bibliotekës u pasurua nga MKRS dhe autoret nga MKRS, 61 tituj me 340 ekzemplarë, ndërsa nga autoret, 27 tituj me 61 ekzemplarë Gjithsejtë: 88 - TITUIJ me 401 – EKZEMPLARË

Regjistri i lexuesve sipas numrit për vitin 2020

<i>Bibliotekat</i>	<i>Amë për të vegjlit</i>	<i>Amë për të rritur</i>	<i>Dega Pozheran</i>	<i>Dega Sllatinë e Epërme</i>	<i>Gjithsej</i>
Numri i përgjithshëm i anëtarëve	203	132	168	162	665
Numri i përgjithshëm i librave të lexuara	1104	1759	1056	1163	5082

Verejtje : Sikurse e kemi cekur edhe më lartë, se në këtë vit nuk është punuar rregullisht dhe për këtë

arsye kemi një statistikë shumë më të vogël të lexuesve, se në vitet tjera.

c) Sektori i Arkivit Historik gjatë vitit 2020

Arkivi Historik Komunal ka për qëllim promovimin dhe avancimin e punës rreth mirëmbajtjes në përgjithësi të lëndës arkivore që gjendet nën menaxhimin e Arkivit , dhënies së këshillave për

INVESTIMENT KAPITALE

Pasqyra tabelare e aktiviteteve të mbajtura në Shtëpinë e Kulturës, në periudhën janar – dhjetor / 2019												
Nr. i aktiviteteve gjatë vitit 2020	Gjithsejt	Nr. i pjesëmarrësve	Nr. i kalendarik vitin aktiviteteve për janar-dhjetor	Nr. i aktiviteteve për vitin kalendarik janar-dhjetor	Instituci onet komunal e	OJQ- të	a Ekspozit	Shtaqje filmi -Dokumentar -Teatri -Baleti	Promovi me librare	Personat privat (Libri).	Partitë politike Gjiths ej	198
	800	1.303	80	800	150	80	0	3.213				

Statistika tabelare e aktivitetëve për periudhën janar - Dhjetor/2020

d) Aktivitetet në Shtëpinë e Kulturës "Gursel dhe Bajram Syljmani"

Hapësitë e Qendrës së Kulturës "Gursel dhe Bajram Syljmani" gjatë vitit 2020, janë shfrytëzuar nga Institucionet Komunale, Organizatat tjera qeveritare, Organizata Jo-Qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, Partitë Politike për aktivitetet e tyre përkatëse.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i aktivitetëve sipas muajve:

Page 10.

Kërkesat të shqyrtuara	75	Kërkesat të realizuara	57	Kërkesat të Refuzuara	18
------------------------	----	------------------------	----	-----------------------	----

fondkrijuesit në procesin e klasifikimit, ruajtjes, asgjësimit dhe dorëzimit-pranimit të lëndës e cila ka arfar të përhershëm të ruajtjes në Arkiv. Për keto veprimë të lartpërmendura Arkivi Historik funksionon dhe ka një mbështetje me bazë ligjore të qartë e të krijuar nga institucionet qendrore për veprimtarinë arkivore. Ndër të tjera Arkivi Historik zbaton ligjin nr.04/L-088 për-Arkiva Shqiptore të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe dy udhëzimet përçfjellëse, bazë për trajtimin e lëndës arkivore si: Udhëzimi Administrativ nr.08/2007 për Përzgjedhjen e Lëndës Arkivore dhe Asgjësimit e Materialit të pavlershëm Regjistraturik dhe Udhëzimin Administrativ nr.09/2007 për Dorëzim-Pranimin e Lëndës Arkivore. Arkivi Historik punon në planin e brendshëm duke u bazuar në funksionimin e tri referateve kryesore si: Shërbimi i brendshëm që ka për detyrë rregullimin e lëndës në Arkiv, shërbimi jashtëm që merret me kontrollimin lëndës tek fondkrijuesit dhe puna me palë apo dhënja në shfrytëzim e lëndës për nevoja private dhe zyrtare.

1. Palestre e sportit në Drobesh
2. Stadiumi në Vitisë
3. Stadiumi "Ibrahim Kurtishi" në Pozheran
4. Stadiumi ndimës i KF "Vllaznia" nga Pozheran
5. Stadiumi në Sodevin J.

Investimet kapitale në infrastrukturë fushat sportive

1. Fusha e futbollit në Skiftëraj e shtruar me gome
2. Fusha e futbollit në Smirë e shtruar me gome
3. Fusha e sportive multifunksionale në Radivojë e shtruar me gome
4. Fusha sportive multi funksionale në Ramijan e shtruar me gome
5. Fusha sportive multifunksionale me rrethoja metali dhe ndriqim në Kabash
6. Fusha sportive multifunksionale me rrethoja dhe ndriqim në Lubishitë
7. Fusha sportive multifunksionale me rrethoja dhe ndriqim në Drobesh

Investimet kapitale në infrastrukturë kulturore

1. Renovimi i shëpisë së kultures- projekt në vashdimësi nga 2019
2. Renovimi i objektit për muze komunal në Viti
3. Amfiteatri veror në hapsirat e Shkolles se pare shqipe në Stubël të Epërme

Projekte të bashkëpunimit me organizata dhe institucione vendore dhe ndërkombëtare për rini

1. Caritas Kosova projekti "Jour Job"
2. Projektiin Up to Youth të financuar nga USAID
3. Korpusi i Pages – vullnetarizmi dhe ndima komunitetit
4. Projekti: CeHB Kosovo (BE), restaurimi i objektit për Muzeun komunal

BASHKËPUNIMI ME FEDERATAT/ORGANIZATAT VENDORE DHE ORGANIZATA TJERA

- I. Bashkëpunimi me MKRS-ne
- II. Bashkëpunimi me Federatën e Atletikës së Kosovës per organizimin e manifestimit sportive "Vrapimi I pavarësisë.
- III. Bashkëpunimi me Federatën e Futbollit të Kosovës (FFK)
- IV. Bashkëpunimi me Komitetin Olimpikë të Kosovës për organizimin e panairit të klubeve sportive
- V. Bashkëpunimi me Federatën e Shahut të Kosovës për organizimin e turneve në Shahë
- VI. Bashkëpunimi me Federatën e Pingpongut të Kosovës për organizimin e turneve në pingpong
- VII. Bashkëpunimi me Shogatën e motoristëve "Veteranet e UÇK-së" nga Kosova
- VIII. Bashkëpunimi me Shogatën e motoristëve "Kastriotet" nga Ferizaj.
- IX. Bashkëpunimi me Caritas Kosova Jour Job
- X. Bashkëpunimi me USAID-in projekti Up to Youth
- XI. Komuna e Vitisë dhe UNDP – Projekti RelOaD faza -II-të
- XII. Bashkëpunimi me OJQ-te lokale

MIRËNJOHJE

FEDERATA E ATLETIKËS SË KOSOVËS PËR KOMUNËN/SPORTIN PER ORGANIZIMIN E MANIFESTIMIT SPORTIV KOMBËTAR --VRAPIMI I PAVARËSISË" ME 17 SHKURTME PJESËMARRJE TË ATLETVE NGA KOSOVA,SHQIPERIA, DHE MAQEDONIA

BASHKËPUNIMI ME KFOR-IN AMERIKAN DHE BRITANIK

- I. Bashkëpunimi me KFOR-in Amerikan në bashkëpunimin e aktivitetit dhe Sigurisë, mjedisit, shëndetësisë, sportit, rinisë, kulturës, etj.
- II. Bashkëpunimin me KFOR-in Britanik në ndeshjet miqësore të ndeshjeve të futbollit

BASHKËPUNIMI ME POLICIN E KOSOVËS DHE FSK-në

- I. Bashkëpunimi me POLICIN E KOSOVËS - pjesëmarrja në aktivitetet sportive, kulturore dhe rinore
- II. Bashkëpunimi me FSK-në – pjesëmarrja në aktivitetet sportive (turne të futbollit dhe hiking)

MENAXHIMI I KONTRATAVE KOMUNALE PËR SHËRBIME DHE MALLARA

Përshkrimi i kontratave:


1. Kontrata për shërbime të transportit publik
2. Kontrata për shërbimet e zërit
3. Shërbimet e furnizimit me rekuizite sportive
4. Shërbimet për ndriçim profesional

FINANCAT E DKRS-së

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport pasanulimit të Thirjes publike për mbështetje finaciale të OJQ-ve, dhe shfaqes së pandemisë Covid-19 dhe anulimit të thirjes publike, ka kryer obligimet kontraktuale sipas Memorandumit me KOK për bursa per 2 garues të reprezentacionit të Kosovës në Shenjari (Drilon Ibrahim dhe Uratë Rama). Rrjedhimisht është shpenzuar buxheti i drejtorisë nga kodi buxhetor i Shërbimeve dhe Mallrave.

Në dy gratifikat janë paraqitur shpenzimet e DKRS-së sipas raporteve të drejtorisë së financave me shumën totale të dy kategorive buxhetore si dhe tabela e dyte me postë janë paraqitur përqindjet e

Shpenzimet e DKRS-së 2020




PËRGATITJA E PARAMASAVE DHE PROCEDURAVE TENDERIMI PËR SHËRBIME DHE MALLRA

Nr.	Përshkrimi i paramasave	Procedurat tenderuese
1	Paramasa e shërbimeve grafike	Në procedurë
2	Paramasa e shërbimeve të zërit	Në shërbim
3	Paramasa e shërbimit rekorizita sportive	Në procedurë
4	Paramasa e shërbimeve të transportit	Në procedurë
5	Paramasa e pajisje të zërit për kino sallë	Në procedurë
6	Paramasa e shërbimeve për ndërtimin profesional	Në shërbim
7	Paramasa për transmetime publike të aktiviteteve dhe kuëndit	Në procedurë
8	Paramasa për YPS për kino aparat	Në procedurë
9	Paramasa për kamera të sigurisë për shtëpi të kulturës	Në procedurë
10	Paramasa për mini muzen dhe konservim të pajisjeve të dëshmoreve dhe aparatura e vjetër e kinemas	Planifikime
11	Riparimi i rjetit elektrikë kino kabine dhe aktivizimin e elektromotorëve me perde të kinemasë dhe teatrit	Planifikime

PUBLICITETI MULTI MEDIAL

- Transmetimi dhe publikimi të aktiviteteve në televizionin lokal "Plus TV" si dhe televizionet tjere qendrore ma frekuenca nacionale në platformat e ndryshme
- Përgatitja teknike e Vjetarit: Dizajni, faqosja, fotografat përmbajtja nga aktivitetet, dhe publikime virtual
- Faqja zyrtare në rjetën sociale Facebook: <https://www.facebook.com/profile.php?id=100008715822123>



Viti, shkurt 2021

